



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

(Dokument Parlamentar)

Tiranë, më 02. 11.2023

RAPORT

NË PARIM

PËR PROJEKTLIGJIN

“PËR BUXHETIN E VITIT 2023”

- *Hyrje*

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, në disa seanca të mbledhjeve të tij të datave 27,28,31,01 nëntor 2022, mori në shqyrtim në parim projektligjin “Për Buxhetin e Vitit 2023”. Kjo nismë është propozim i Këshillit të Ministrave. Relatore të projektligjit janë znj. Enslemvera Zake, znj. Dasantila Tahiraj dhe znj. Merita Bakiu. Në diskutimin në parim të projektligjit ishin të pranishme dhe dhanë shpjegime rreth tij Znj. Evis Kushi, Ministre e Arsimit, Sportit; znj. Elva Margariti, Ministre e Kulturës; znj. Bora Muzhaqi Ministre e Shtetit për Rininë përfaqësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si dhe ekspertë të ministrive përkatëse. Gjithashtu u organizuan seanca dëgjimore me institucione që financohen edhe nga Buxheti i Shtetit.

I. BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 81-83, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës, sipas nenit 80 të Rregullores së Kuvendit.

II. QËLLIMI, PËRMBAJTJA DHE RISITË E PROJEKTLIGJIT

2.1. Qëllimi i projektligjit:

Në projektbuxhetin e vitit 2023, programimi i të ardhurave buxhetore mbështet synimet e Qeverisë për mbajtjen nën kontroll të defiçitit buxhetor dhe borxhit publik.

Në përputhje të plotë edhe me rregullat fiskale, në ligjin organik të buxhetit, politika fiskale do të vijojë të orientohet drejt konsolidimit fiskal në periudhën afatmesme dhe afatgjatë etj...

Buxheti i MAS 2023

Tavanet buxhetore të propozuara nga Këshilli i Ministrave me projektligjin “Për buxhetin e vitit 2023” kanë pësuar ndryshime krahasuar me tavanet e miratuara me VKM nr. 535, date 29.7.2022 “Për miratimin e tavanëve përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2023-2025” për buxhetin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Referuar projektligjit të paraqitur në Kuvend në Tetor 2022, fondet për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit kanë reflektuar kërkesat kryesore të ministrisë së arsimit dhe sportit, duke u shtuar tavanëve të miratuara në Korrik 2022 edhe shumën **2 miliard e 190 milion lekë** ose 5% më shumë krahasuar me fondet e planifikuara në tavanet e miratuara me VKM nr. 535 të muajit Korrik 2022.

- Shpenzimet e personelit, janë shtuar me 1 miliard e 940 milion lek;
- Shpenzimet operative, përfshirë fondet grant të IAL-ve publike, janë shtuar me 450 milion lek;
- Shpenzimet kapitale me financim të huaj janë shtuar 200 milion lekë ndërsa shpenzimet kapitale me financim të brendshëm, janë ulur 400 milion lekë;

Buxheti i planifikuar në projektligjin “Për buxhetin e vitit 2023” arrin të përmbushë objektivat dhe prioritetet kryesore të MAS për periudhën 2023-2025

Arsimi parauniversitar:

(arsimi parashkollor, arsimi bazë dhe arsimi i mesëm i përgjithshëm).

Fondet për Arsimin parauniversitar, miratohen në dy programe të veçanta buxhetore, përkatësisht arsimi bazë dhe arsimi i mesëm i lartë.

Në vitin 2023 fondet në arsimin parauniversitar janë planifikuar në total 33 miliardë e 321 milion lek, nga të cilat:

- 28,15 miliardë lek- shpenzime personeli/paga+sigurime shoqërore/shëndetësore (600, 601)
- 2 miliard e 571 milion lek- shpenzime korrente/operative (602-606)
- 2 miliard e 599 milion lek- shpenzime kapitale/investime (230-231)

Fondet e MAS për vitin 2023 për arsimin parauniversitar, zënë;

- 70,6% të buxhetit të MAS;
- 1,53% të PBB-së;
- 4,85% të shpenzimeve publike.

Krahasuar me buxhetin e vitit 2022, buxheti për arsimin parauniversitar ka një rritje nominale me 650 milion lek ose 2%. Rritje kanë shënuar shpenzimet kapitale me 279 milion lekë dhe shpenzimet korrente me 371 milion lekë.

Në vitin 2024 janë planifikuar fonde në total 33 miliard e 613 milion lekë ose

- 1,47% e PBB-së dhe
- 4,82% e shpenzimeve publike.

Në vitin 2025 janë planifikuar fonde 33 miliard e 872 milion lekë ose

- 1,41% e PBB-së dhe
- 4,64% e shpenzimeve publike.

- Fondeve për arsimin parauniversitar, përveç fondeve të parashikuara në buxhetin e MAS për vitin 2023, i shtohen edhe fondet e buxhetit të shtetit që akordohen nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë për arsimin profesional, nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për shërbime në funksion të arsimit parauniversitar si dhe shërbimet për arsimin parashkollor dhe fondet për nxënësit që akomodohen në konviktet e arsimit profesional apo atij të mesëm të përgjithshëm, si dhe fondi i rritjes së pagave për punonjësit arsimorë.

Fondet totale të buxhetit të shtetit të destinuar për “Arsimin parauniversitar” për vitin 2023 arrijnë shumën 51,4 miliardë lekë, dhe përfaqesojnë;

- **2,4% të PBB-së;**
- **7,5% të shpenzimeve publike.**

Tabela 1. Fondet e miratuara për vitin 2020-2021 si dhe tavanet e propozuara për periudhën 2023-2025 për Arsimin Parauniversitar

ARSIMI PARAUNIVERSITAR (Arsimi Bazë+Arsimi i Mesëm)									
	Buxheti rishikuar 2020	Fondet miratuara "Për Buxhetin e vitit 2021"	Tavanet miratuar ligji nr.115/2021 "Per buxhetin e vitit 2022 "	Tavanet e propozuar në P/ligjin, Tetor 2022					
Artikujt				2023	2024	2025	2023/2022	2024/2023	2025/2024
Paga (600-601)	25,752,705	28,059,363	27,979,666	28,150,670	28,033,367	27,723,767	1%	0%	-1%
Korrente të Tjera (602-606)	2,121,558	2,010,320	2,371,451	2,571,451	2,680,767	3,049,734	8%	4%	14%
Kapitale (230-232) Të Brendshme	1,913,487	446,003	2,320,000	2,599,000	2,899,000	3,099,000	12%	12%	7%
Kapitale (230-232) Të Huaja	2,000	-	-	-	-	-			
Totali nr.1	29,789,750	30,515,686	32,671,117	33,321,121	33,613,134	33,872,501	2%	0,9%	0,8%
Strukt ndaj totalit buxh MAS	71.9%	71.0%	71.9%	70.6%	69.9%	69.4%			4%
Ne % ndaj GDP sipas p.ligjit treguesit fiskale	1.8%	1.6%	1.6%	1.53%	1.47%	1.41%			
Ne % ndaj shpenzimeve publike, sipas pligjit treguesit fiskale	5.6%	5.1%	4.9%	4.85%	4.82%	4.64%	92%	84%	83%
Numri I Nxenesve AB+AM	347,495	338,628	327,906	327,906	324,000	321,000	7%	8%	8%

Numri Nxenesve AB+AML + femijeve kopshte publike.	422,705	400,581	380,066	380,066	374,000	370,000			
Kosto mesatar vjetore parashikuar / nxenes ne leke	70,474	76,179	85,962	87,672	89,875	91,547			

ARSIMI PROFESIONAL DHE PUNËSIMI.

Buxheti i planifikuar për Programin e Arsimit të mesëm profesional, për vitin 2022 është 3 miliard e 63 milion lekë.

Politika e këtij programi: synon të përmbushë qëllimin e Strategjisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi e 2019-2022 dhe planit të saj të veprimit, të identifikojë dhe hartojë politikat e duhura për punësimin, arsimin dhe formimin profesional, në mënyrë që të krijojë vende pune dhe mundësi cilësore për punësim dhe aftësi përgjatë gjithë ciklit të jetës

Programi synon zhvillimin e një sistemi të arsimit dhe formimit profesional, i cili garanton arsim dhe formim profesional cilësor dhe gjithëpërfshirës nëpërmjet:

- Sigurimit të një procesi mësimor cilësor e me kushte optimale të të nxënës, teorik e praktik për t'i pajisur nxënësit me kompetencat e duhura;
- Ndërtimit, rikostruksionit dhe paisjes me laboratorë/makineri, të shkollave dhe repartëve të praktikave profesionale si një nga prioritetet dhe në programin e qeverisë Shqipëria 2030 për arsimin profesional;
- Rishikimit të programeve ekzistuese dhe hartimit të programeve të reja në përputhje me parimet e barazisë gjinore dhe të gjithëpërfshirjes, në zbatim të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve;
- Hartimit dhe miratimit të standarteve të profesioneve dhe kualifikimeve sipas niveleve të KSHK;
- Zhvillimit të vazhdueshëm profesional të mësuesve, si një nga shtyllat kryesore të sigurimit të cilësisë në arsimin profesional;
- Fillimit të implementimit të akreditimit të ofruesve të AFP-së;
- Funkcionimit të komitetit sektorial të TIK;
- Ngritjes dhe funksionimit të strukturës së Inspeksionit të Arsimit Profesional;
- Modernizimit të kuadrit ligjor të AFP ekzistues, që rregullojnë sistemin e AFP-së, si dhe aspektet që kanë të bëjnë me AFP-në (hartimi i skeletkurrikulave, materialeve mësimore, trajnimi i mësuesve, etj.) në zbatim të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve

Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor

Për financimin e veprimtarisë në IAL-të publike “Arsimi i Lartë” dhe të “Kërkimit Shkencor” për periudhën 2023-2025, janë planifikuar fonde me burim financimi buxhetin e shtetit, në shumën totale 39,1 miliardë lekë, ose rreth 13 miliard lek në vit.

Për vitin 2023 financimi është planifikuar në shumën totale **12,6 miliard lek**, nga të cilat 10,8 miliardë lek janë *janë në grupin e shpenzimeve korrente dhe 1.73 miliard lekë janë në grupin e shpenzimeve kapitale*).

Buxheti i “Arsimit të lartë” dhe “Kërkimit Shkencor” (pa përfshirë fondet jashtë buxhetore) për vitin 2023, kompozohet si më poshtë:

- 20,1 milion leke janë shpenzime personeli për Agjensitë e Arsimit të lartë & Kërkimit shkencor;
- 10 miliard e 860 milion lek janë shpenzime korrente/operative (602-606);

- 1 miliard e 730 milion lekë janë shpenzime kapitale, nga të cilat 1 miliard e 130 milion me financim të brendshëm dhe 600 milion me financim të huaj.

Për vitin 2023, Fondet e planifikuara për “Arsimin e Lartë” dhe “Kërkimin Shkencor” zënë:

- **26,7% e fondeve totale të MAS;**
- **0,6% ndaj PBB-së;**
- **1,84% ndaj shpenzimeve publike.**

Buxheti 2023 për programet “Arsimi i Lartë” dhe “Kërkimi shkencor” ka shënuar një rritje totale prej 9,2% ose 1 miliard e 58 milion lekë krahasuar me buxhetin 2022, rritje e cila është orientuar kryesisht në shpenzimet korrente (fondet grand me financim të brendshëm në shumën 884 milion lekë dhe 300 milion lekë shpenzime kapitale/financimi i huaj). Konkretisht,

- Programi i “Arsimit të Lartë” është rritur në total në masën 774 milion lek ose 7,2% krahasuar me vitin 2022, nga të cilat 100 milion lekë është shtesë financimi i huaj;
- Programi i “Kërkimit Shkencor” është rritur me 284,74 milion lek ose 38,2% krahasuar me vitin 2022, nga të cilat 200 milion lekë është shtuar financimi i huaj;

Rritja e buxhetit 2023 do të orientohet për të financuar shtesën e pagave me 7% të personelit akademik të IAL-ve publike, financimin e projekteve të ndërkombëtarizimit dhe studentëve në degët prioritare dhe ekselente të arsimit të lartë në Shqipëri si dhe të projekteve të kërkimit shkencor.

Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm janë ulur me 126 milion lek.

Për vitin 2024 fondet arrijnë

- 27,3% e fondeve totale të MAS;
- 0,6% ndaj PBB-së;
- 1,9% ndaj shpenzimeve publike.

Për vitin 2025 fondet arrijnë

- 27,5% e fondeve totale të MAS;
- 0,6% ndaj PBB-së;
- 1,8% ndaj shpenzimeve publike.

Tabela 5. Fondet e buxhetit të miratuara për vitin 2020-2022 dhe tavanet për periudhën 2023-2025, në 000/lekë e në %, Arsimi i Larte (09450) dhe Kerkim Shkencor 09770

Emri i Programit	ARSIMI I LARTE + KERKIM SHKENCOR dhe EKSELENCE								
	Buxheti rishikuar 2020	Fondet miratuara "Për Buxhetin e vitit 2021"	Tavanet miratuar ligji nr.115/2021	Tavanet miratuar projektligjin tetor 2022					
Artikujt	.			2023	2024	2025	2023/2022	2022/2021	2025/2024
Paga (600-601)	20,160	20,160	20,160	20,160	20,160	20,160	0.0%	0.0%	0.0%
Korente të Tjera (602-606)	9,899,264	9,359,840	9,976,080	10,860,840	10,961,840	11,211,840	8.9%	0.9%	2.3%
Kapitale (230-232) Të Brendshme	485,672	1,021,600	1,256,000	1,130,000	1,530,000	1,580,000	-10.0%	35.4%	3.3%
Kapitale (230-232) Të Huaja	300,000	200,000	300,000	600,000	600,000	600,000			
Jashtë-buxhetore									
Totali	10,705,096	10,601,600	11,552,240	12,611,000	13,112,000	13,412,000	9.2%	4.0%	2.3%
Strukt ndaj totalit buxh MAS	25.8%	24.7%	25.4%	26.7%	27.3%	27.5%			0
Ne % ndaj GDP, Sipas sipas VKM Treguesit Fiskale 2018-2025	0.7%	0.6%	0.6%	0.6%	0.6%	0.6%			
Ne % ndaj shpenzimeve publike, Sipas sipas VKM Treguesit Fiskale 2018-2026	2.0%	1.8%	1.7%	1.8%	1.9%	1.8%			
TOTALI Jashtë-buxhetore _Kap 06	3,050,000	3,350,000	2,700,000	3,100,000	3,330,000	3,450,000			

TOTALI Buxheti +Te Ardhura e IAL	13,755,096	13,951,600	14,252,240	15,711,000	16,442,000	16,862,000	1,759,400		
Kosto mesatar vjetor/ student ne lekë	131,248	143,258	148,461	163,656	174,915	179,383	0	0	0
Numri Total I studenteve në tre ciklet të studimeve në IAL publike	104,802	97,388	96,000	96,000	94,000	94,000			
Strukt ndaj totalit buxh MAS	24.0%	21.6%	21.8%	22.9%	22.7%	22.2%			
Ne % ndaj GDP, Sipas sipas p.ligjit treguedit fiskale	0.8%	0.7%	0.7%	0.7%	0.7%	0.7%			
Ne % ndaj shpenzimeve publike, Sipas sipas VKM Treguesit Fiskale 2018-2026	2.6%	2.3%	2.2%	2.3%	2.4%	2.3%			

Programi për sportin

Ky program siguron dhe mbron të drejtat e shtetasve që merren me edukim fizik dhe sport, në përputhje me Kartën Evropiane të Sportit dhe me rekomandimet e organizatave ndërkombëtare në këtë fushë. Ridimensionimi i edukimit fizik dhe sportiv si pjesë përbërëse e programit të edukimit të nxënësve dhe studentëve në institucionet arsimore dhe rishikimi dhe zbatimi i politikave në fushën e sportit, synon sigurimin e një shërbimi cilësor nëpërmjet sportit elitare dhe sportit në institucionet arsimore dhe forcimin e statusit të rinjve shqiptarë në të gjitha fushat e jetës si; edukim, punësim, familje, shëndetësi, mjedis, mbrojtje sociale, drejtësi.

Edukimi nëpërmjet sportit si një faktor efikas në përmirësimin e shëndetit e të mirëqenies për qytetaret dhe mbrojtja, stimulimi dhe promovimi i arritjeve sportive, ka si synim masivizimin dhe përmirësimin cilësor të sportit, krijimin e shanseve të barabarta dhe kushteve për pjesëmarrjen në aktivitete sportive të të gjithë shtetasve shqiptarë mbështetur në të drejtat e njeriut për të ushtruar aktivitete fizik e sportiv, duke krijuar infrastrukturën e duhur ligjore, financiare dhe fizike si dhe rregullimin e marrëdhënieve shtet-institucione sportive.

Objektivat e programit:

- **Objektiv 1.** Sigurimi i mbështetjes financiare për federatat Olimpikë në aktivitete, Evropiane, Botërore, Ballkanike në funksion të kualifikimeve për Lojërat Olimpikë Paris 2024, realizimi i 30-35 analizave antidoping për sportistët elitare si dhe ato kandidat për Lojërat Olimpikë Pekin 2022, si dhe Paris 2024.
- **Objekti 2.** Mbështetja financiare për Ekipin Kombëtar Olimpik pjesëmarrës në Lojërat e Olimpikë si dhe aktivitetet kombëtare dhe ndërkombëtare për Federatat Sportive, në të gjithat disiplinat sportive, sipas kalendarëve të aktiviteteve në 42 Kampionate Kombëtare, 42 Kupa Shqipërisë, 42 Kampionate Evropiane, si dhe 42 Kampionate Botërore, në përputhje me parimet e barazisë gjinore.
- **Objekti 3.** Mbështetja financiare me investime në sport, për ndërtimin/rindërtimin e objekteve sportive, pajisjes me bazë materiale të tyre në funksion të ekipeve kombëtare.
- **Objekti 4.** Zhvillimi i programeve trajnuese në sistemin sportiv kombëtar në funksion të rritjes së kapaciteteve në fushën e sportit, trajnime çdo vit për 20-25% e stafet teknike të sistemit sportiv kombëtar (732 teknike-trajnerë, specialistë, instruktorë, mjekë etj, ku përparësi kanë sportistët dhe trajnerët femra).
- **Objekti 5.** Rritja e mbështetjes financiare për shpërblimin e sportistëve elitare, fitues në aktivitete ndërkombëtare, mbështetje financiare për 25-30 sportistë elitare në vit si dhe trajnerët e tyre, si dhe mbështetje financiare për aktivitete sportive promovuese dhe garuese në institucionet arsimore të arsimit parauniversitar dhe universitar.

Fondet e planifikuara në programin e sportit për periudhën 2023-2025 janë në shumën 1.739 miliard lekë nga të cilat;

- Për vitin 2023, janë parashikuar fondet në shumën prej 446 milion lekë, pra një shtesë prej 33 milion, ose 7.8% më shumë ndaj vitit 2022; fondet e miratuara për vitin 2023 arrijnë 0.95% e fondeve të parashikuara për MAS, në masën 0.07% ndaj shpenzimeve publike, si dhe ndaj PBB në masën 0.02%.

- Për vitin 2024, janë parashikuar në shumën prej 596 milion lekë, pra një shtesë prej 150 milion, ose 33,7% më shumë ndaj vitit 2023; fondet e miratuara për vitin 2024 arrijnë 1,24% e fondeve të parashikuara për MAS, në masën 0.03% ndaj shpenzimeve publike, si dhe në masën 0.09% ndaj PBB.
- *Për vitin 2025*, janë parashikuar në shumën prej 696.5 milion lekë, pra një shtesë prej 100 milion, ose 16.8% më shumë ndaj vitit 2024; fondet e miratuara për vitin 2025 arrijnë 1.43% e fondeve të parashikuara për MAS, në masën 0.1% ndaj shpenzimeve publike, si dhe ndaj PBB në masën 0.03%.

Tab nr. 6 Fondet të Programit Buxhetor “Zhvillimin e Sportit 08140”, për vitin 2020-2021, tavanet për periudhën 2023-2025 në 000 lekë si dhe në %.

Programi i SPORTIT dhe RINISE										
Emri i Programit	Programi i SPORTIT dhe RINISE									
	Buxheti faktik 2019	Buxheti rishikuar 2020	Fondet e Buxhetin e vitit 2021	Fondete buxhetit e vitit 2022			Tavanet miratuar VKM nr.535, date 29.7.2022			
Artikujt					2023	2024	2025	2023/2022	2024/2023	2025/2024
Paga (600-601)	41,792	42,590	52,600	28,930	28,930	28,930	28,930	0.0%	0.0%	0.0%
Korente të Tjera (602-606)	156,070	177,510	768,400	94,740	247,070	247,570	347,570	160.8%	0.2%	40.4%
Kapitale (230-232) Të Brendshme	249,764	14,200	300,000	270,000	150,000	300,000	300,000	-44.4%	100.0%	0.0%
Kapitale (230-232) Të Huaja	0	14,000	0	20,000	20,000	20,000	20,000	0.0%	0.0%	0.0%
Jashtë-buxhetore	1,156.7	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0			
Totali	448,782	248,300	1,121,000	413,670	446,000	596,500	696,500	7.8%	33.7%	16.8%
Strukt ndaj totalit buxh MAS	1.12%	0.60%	2.61%	0.91%	0.95%	1.24%	1.43%	2025/2022		68%
Ne % ndaj GDP	0.03%	0.02%	0.06%	0.02%	0.02%	0.03%	0.03%	55%	42%	50%
Ne % ndaj shpenz publike	0.09%	0.05%	0.18%	0.06%	0.06%	0.09%	0.10%	34%	50%	43%

Për periudhën 2023-2025, me fondet e planifikuara sigurohet mbështetja financiare/ndihmë shtetërore me fonde grant për 246-347 milion lekë në vit, për rreth 25 federatave sportive olimpike dhe jo-olimpike, shpërblimin e sportistëve me rezultate kombëtare dhe ndërkombëtare, shpërblime dhe çmime për sportistët elitar, ku për vitin 2023, janë parashikuar në formën e transfertës së pakushtëzuar 246 milion lekë, të detajuara sipas aktiviteteve sa vijon:

- Sigurimi i mbështetjes financiare për federatat Olimpikë në aktivitete, Evropiane, Botërore , Ballkanike në funksion të kualifikimeve për Lojërat Olimpikë Pekin 2022, si dhe Paris 2024, realizimi i 30-35 analizave antidoping për sportistët elitar si dhe ato kandidat për Lojërat Olimpikë me rreth 160 milion lekë
- Mbështetja financiare për Ekipin Kombëtar Olimpik pjesëmarrës në Lojërat e Olimpikë Japoni 2021 si dhe aktivitetet kombëtare dhe ndërkombëtare për Federatat Sportive, në të gjithat disiplinat sportive, sipas kalendarëve të aktiviteteve në 42 Kampionate Kombëtare, 42 Kupa Shqipërisë, 42 Kampionate Evropiane, si dhe 42 Kampionate Botërore, në përputhje me parimet e barazisë gjinore 20 milion lekë
- Zhvillimi i programeve trajnuese në sistemin sportiv kombëtar në funksion të rritjes së kapaciteteve në fushën e sportit, trajnime çdo vit për 20-25% e stafet teknike të sistemit sportiv kombëtar (732 teknike-trainerë, specialistë, instruktorë, mjekë etj, ku përparësi kanë sportistët dhe trajnerët femra) 1 milion lekë
- Mbështetje financiare për shpërblimin e sportistëve elitar, fitues në aktivitete ndërkombëtare, mbështetje financiare për 20-25 sportistë elitarë në vit, si dhe mbështetje financiare për aktivitete sportive promovuese dhe garuese në institucionet arsimore të arsimit parauniversitar dhe universitar 35 milion lekë.
- Mbështetje financiare, për veprimtarinë e Agjencinë e Sporti “Sigurimi i mbështetjes financiare për organizimin e aktiviteteve kombëtare dhe ndërkombëtare”, me 30 milion lekë në vit.
- Mbështetja financiare me investime në sport, për ndërtimin/rindërtimin e objekteve sportive, pajisje me bazë materiale të tyre në funksion të ekipeve kombëtare, ku vetëm për vitin 2023-2025, janë parashikuar në formën e investimeve direkte 150 milion lekë.
- Financim i huaj për projekte në sport projekti “Be Active +” projekte të tjera në sport dhe projekte rinore, me 20 milion lekë.
- Sigurimi i mbështetjes financiare të aktiviteteve sportive promovuese me shkollat e arsimit prauniversitar dhe të IAL në kuadër të nismës së Komisionit Evropian BE-Activ (si rishikim politikash)
- Në zbatim të Vendimit nr. 523, datë 22.09.2021 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit”, si dhe parashikimi “Rritja e numrit të Analizave antidoping në kuadër të plotësimit të standardeve të Kodit WADA, Agjencia Botërore Antidoping, si dhe dispozitave ligjore të përcaktuara në Konventat Ndërkombëtare kundër dopingut në sport, të ratifikuara nga Kuvendi i Shqipërisë si dhe angazhimet e MAS në mbledhjen e online të organizuar nga Ministri i Arsimit dhe Sportit me aktorët kombëtar dhe ndërkombëtar në datën 07 Maj 2021, për përmbushjen e standardeve do të realizohen 50 analiza nga 30 analiza që janë kryer deri tani.
- Edhe në vitin 2023 do të vijojë projekti Ekipet Sportive 2022, i cili është mbështetur nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave me 500 milion lekë financim, projekt icili do të fillojë të

implementohet në shkollat publike, për disiplinat volejboll e basketboll me synim për tu zgjeruar edhe në disiplina të tjera.

Buxheti për Ministrinë e Shtetit për Rininë dhe Fëmijet

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, bazuar mbi VKM nr. 524 dt 22.09.2021 “Për Përcaktimin e Fushës së Përgjegjësisë Shtetërore të Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët” harton dhe zbaton politika që synojnë mbrojtjen e të drejtave të të rinjve, garantimin e pjesëmarrjes së të rinjve në jetën sociale dhe koordinimin e çështjeve që kanë të bëjnë me mbrojtjen, perkujdesjen, shëndetin, mirërritjen dhe mirëedukimin e fëmijëve.

I. MBËSHTETJA PËR RININË-AGJENCIA KOMBËTARE E RINISË

Në projekt buxhetin e vitit 2023 janë planifikuar **162, 960, 000 lekë si mbështetje për rininë**, përkatësisht në zërin 08610 të “Buxhetit 2023” sipas Ministrive të linjës dhe Institucioneve buxhetore, me një rritje krahasuar me buxhetin e vitit 2022, 161,370,000.

Më poshtë gjeni analizën e shpenzimeve korrente dhe kapitale, të ndara sipas aktivitetit:

Shpenzime korrente në shumën 112,960,000 lekë sipas kategorive në vijim:

- a) Mbështetje financiare, për veprimtarinë e Agjencisë Kombëtare të Rinisë dhe të programit kombëtar të praktikave të të rinjve.
- b) Realizimi i aktiviteteve mbi leadershipin rinor, pjesëmarrjen në vendimmarrje, punësimin, kreativitetin dhe edukimin joformal, informimin e të rinjve, shkëmbimin e informacionit dhe pjesëmarrjen në zbatim të planit kombëtar të Veprimit për Rininë, përfshirë thirrjen e tretë për projektpropozime për rininë.
- c) Pagesë për kuotën e anëtarësimit në Organizatën Rinore të Ballkanit Perëndimor (RYCO)1, me synim rritja e pjesëmarrjes së të rinjve në aktivitete me karakter social-kulturor dhe edukativ, rritja e pjesëmarrjes/ mbështetjes financiare të organizatave rinore në projekteve rajonale dhe të BE (RYCO, ERAZMUS +, etj).
- d) Grante për projektpropozime nga organizatat rinore dhe ose për të rinjtë në kuadër të thirrjes së tretë për projektpropozime për rininë.

Shpenzime kapitale: 50,000,000 lekë

Mbështetja me investime për ristrukturimin/ ndërtimin dhe pajisjen e objekteve për rininë, si qendra rinore, biblioteka apo hapësira për të rinjtë në shumën 50 milion lekë të financuara nga buxheti i shtetit, ku parashikohet të mbështeten disa bashki.

Zërat specifikë

Kodi buxhetor /Ministri i linjës	Institucioni	Emri i Institucionit	Llogaria Ekonomike	Shuma 2023
86	1087039	Agjencia Kombëtare e Rinisë	600	21,100,000

86	1087039	Agjencia Kombëtare e Rinisë	601	3,530,000
86	1087039	Agjencia Kombëtare e Rinisë	602	7,230,000
86	1087039	Agjencia Kombëtare e Rinisë	604	60,700,000
86	1087039	Agjencia Kombëtare e Rinisë	605	20,400,000
86	1087039	Agjencia Kombëtare e Rinisë	231	50,000,000

TOTAL	162,960,000
TOTAL	
Shpenzime.	
Korrente	112,960,000

Nga thirrja e parë për rininë janë financuar 12 projekte të organiztave rinore/për të rinjtë dhe 4 projekte të infrastrukturës rinore në 4 bashki në vlerën totale 48 milionë lekë (buxheti 2021).

Nga thirrja e dytë për rininë pritet të financohen mbi 20 projekt propozime rinore të organiztave rinore/për të rinjtë dhe 5 projekte të infrastrukturës rinore në 5 bashki në vlerën totale 108 milionë lekë (buxheti 2022) dhe do të vijohet në po të njejtat linja edhe për vitin 2023.

Buxheti për Ministrinë e Kulturës

Grupi i Menaxhimit Strategjik i Ministrisë së Kulturës pas diskutimeve ka miratuar shpërndarjen e fondeve buxhetore sipas programeve duke mbajtur parasysh politikat dhe objektivat e çdo programi buxhetor. Si pjesë e Programit Buxhetor Afatmesëm, në kuadër të negociatave me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë kërkesat buxhetore sipas zërave të projektbuxhetit të vitit 2023, krahasuar me buxhetin e vitit 2022 paraqiten si më poshtë:

Në lekë

Buxheti sipas zërave	Viti 2022	Viti 2023	Diferenca	%
Paga+Sigurime Shoqerore (600 -601)	962,347,000	1,116,328,000	153,981,000	16.00%
Shpenzime Korente (602-606)	927,413,000	1,044,153,000	116,740,000	12.60%
Mallra dhe Shërbime (602)	241,912,000	250,892,000	8,980,000	3.71%
Shpenzime nga te Ardhurat (602/5)	68,910,000	68,910,000	0	0.00%

Korrente Brendshme (604)	505,800,000	611,786,000	105,986,000	20.95%
Korrente te Huaja (605)	10,611,000	10,641,000	30,000	0.28%
Transferta per Buxhetet Familjare dhe Individet (606)	100,180,000	101,924,000	1,744,000	1.74%
Financim me investim të brendshme (230-231)	2,262,500,000	1,700,000,000	-562,500,000	-24.86%
Financim Huaj	160,000,000	100,000,000	-60,000,000	-37.50%
Shuma	4,312,260,000	3,960,481,000	351,779,000	8.16%

Nisur nga treguesit e mësipërm, projektbuxheti i vitit 2023 krahasuar me buxhetin e vitit 2022 ka një rënie prej 8,16 % ose 351,8 milion lekë.

Gjithashtu sipas tabelës më poshtë prezantojmë tavanet e projekt buxhetit të vitit 2023 krahasuar me buxhetin e vitit 2022 edhe në nivel programi.

në lekë

Buxheti sipas Programeve	Viti 2022	Viti 2023	Diferenca	%
Planifikim, Manaxhim	172,400,000	176,408,000	4,008,000	+2.3
Art & Kulturë	3,424,020,000	3,019,438,000	-404,582,000	-11.8
Trashëgimia Kulturore e Muzetë	715,840,000	764,635,000	48,795,000	+6.8
Shuma	4,312,260,000	3,960,481,000	-351,779,000	-8.16

- Referuar tavanëve të projekt buxhetit për vitin 2023, Ministria e Kulturës paraqet në mënyrë të detajuar planifikimin e shpenzimeve sipas artikujve buxhetor:

-Planifikimi i Shpenzimeve për Paga e Sigurime Shoqërore (llog. 600+601)

Emërtimi	Buxheti-Pagat dhe Sigurimet (600+601)			%
	Buxheti 2022	Buxheti 2023	Diferenca	
Planifikim, Manaxhim	115,200,000	119,108,000	3,908,000	3.4
Trashegimi Kulturore dhe Muzete	300,347,000	318,982,000	18,635,000	6.2
Art & Kulture	546,800,000	678,238,000	131,438,000	24.0
Shuma	962,347,000	1,116,328,000	153,981,000	16.0

Përlllogaritjet për zërin paga e sigurime shoqërore, janë kryer mbështetur në numrin e punonjësve sipas organikes së Ministrisë Kulturës. Për vitin 2023 fondi i pagave është i ndryshëm nga viti 2022, në

zbatim të Vendimit nr.475, date 13.07.2022 "Per disa shtesa dhe ndryshime ne Vendimin nr.187,date 08.03.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e strukturës dhe te niveleve të pagave të nëpunësve civile/nëpunësve, Zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në disa institucione te Administrates Publike " të ndryshuar"; Vendimit nr.604, date 14.09.2022 "Per percaktimin e pages minimale ne shkalle vendi"; Vendimit nr.621, date 28.09.2022 "Per disa shtesa dhe ndryshime ne Vendimin nr.187,date 08.03.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e strukturës dhe te niveleve të pagave të nëpunësve civile/nëpunësve, Zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në disa institucione te Administrates Publike " të ndryshuar". Në projekt buxhetin 2023, vihet re se fondi i pagave dhe sigurimeve në programin Arti dhe Kultura paraqitet i rritur në masën 24% ose 131 milion lekë krahasuar me vitin 2022.

-Planifikimi i Shpenzimeve korrente nga të ardhurat (Ilog.602/5)

Programet	Zeri Shpenzime Administrative (art.602)			%
	Viti 2022	Viti 2023	Diferenca	%
Aparati,planifikim,manaxhim.	1,370,000	1,370,000	0	0.00%
Art & Kultura	14,940,000	16,440,000	1,500,000	10.04%
Trashegimia Kulture e Muzete	52,600,000	51,100,000	-1,500,000	-2.85%
Shuma	68,910,000	68,910,000	0	0.00%

Shpenzimet korrente nga të ardhurat për vitin 2023 krahasuar me vitin 2022, ruajnë të njëjtat nivele për Programin Planifikim, Menaxhim, Administrim dhe Programin Art dhe Kulturë dhe Trashegimia Kulture dhe Muzetë.

-Planifikimi i Shpenzimeve korrente (602)

Programet	Shpenzime nga te Ardhurat (602/5)			%
	Viti 2022	Viti 2023	diferenca	%
Aparati,planifikim,manaxhim.	55,650,000	54,750,000	-900,000	-1.62%
Art & Kultura	64,550,000	128,430,000	63,880,000	98.96%
Trashegimia Kulture e Muzete	121,712,000	67,712,000	-54,000,000	-44.37%
Shuma	241,912,000	250,892,000	8,980,000	3.71%

Shpenzimet korrente për vitin 2023 krahasuar me vitin 2022 janë rritur në masën 3.71% ose në vlerën 8.9 milion lekë të cilat ndahen sipas programeve më sipër. Këto shpenzime janë parashikuar të përdoren kryesisht për mbulimin e shpenzimeve administrative të domosdoshme për funksionimin e veprimtarisë së Aparatit të Ministrisë së Kulturës dhe institucioneve të varësisë. Gjithashtu, ky zë do

të përdoret pjesërisht për mbulimin e shërbimit të sigurimit dhe ruajtjes të Monumenteve të Kulturës dhe Parqeve.

-Planifikimi i Shpenzimeve për projekte (Ilog.604)

Shpenzimet për transferta korrente të brëndshme, zëri Projekte për vitin 2023 kanë pësuar rritje në masën prej 20.95 % ose 106 milion lekë përkatësisht si më poshtë:

Programet	Korrente Brendshme (604)			%
	Viti 2022	Viti 2023	diferenca	%
Aparati,planifikim,manaxhim.				
Art & Kultura	450,100,000	554,110,000	104,010,000	23.11%
Trashegimia Kulturore e Muzete	55,700,000	57,676,000	1,976,000	3.55%
Shuma	505,800,000	611,786,000	105,986,000	20.95%

-Këto shpenzime në Programin e Trashëgimisë Kulturore, krahasuar me vitin 2022, janë rritur me 1.97 milion, fonde të cilat janë parashikuar të përdoren për mbulimin e gjithë aktiviteteve në fushën e trashëgimisë materiale dhe jo material.

-Planifikimi i Shpenzimeve për kuotizacione, antarësime (Ilog.605)

Programet	Korrente te Huaja (605)	%	diferenca	%
	Viti 2022	Viti 2023		
Aparati,planifikim,manaxhim.	0	0	0	0.00%
Art & Kultura	10,130,000	10,150,000	20,000	0.20%
Trashegimia Kulturore e Muzete	481,000	491,000	10,000	2.08%
Shuma	10,611,000	10,641,000	30,000	0.28%

Shpenzimet për transferta korrente të jashtme, zëri kuotizacione për vitin 2023 ruajnë afërsisht të njëjtat nivele si ato të vitit 2022. Këto shpenzime janë parashikuar referuar marrëveshjeve të nënshkuara aktualisht për mbulimin e shpenzimeve të angazhimeve të Ministrisë së Kulturës në përfaqësimet jashtë vendit.

-Planifikimi i Shpenzimeve Transferta për individ dhe familje (llog.606)

Programet	Transferta per Buxhetet Familjare dhe Individet (606)			%
	Viti 2022	Viti 2023	diferenca	%
Aparati,planifikim,manaxhim.	180,000	1,180,000	1,000,000	555.56%
Art & Kultura		288,000	288,000	
Trashegimia Kulturore e Muzete	100,000,000	100,456,000	456,000	0.46%
Shuma	100,180,000	101,924,000	1,744,000	1.74%

Edhe këto shpenzime për transferta të Brëndshme, ruajnë të njëjtat nivele si ato të vitit 2022 dhe ofrojnë mbështetje financiare për programin e ri **Bonusi i Rijetëzimit**, nëpërmjet të cilit zbatohen politikat e programit qeverisës, në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga programi i Qeverisë Shqiptare për reformën ligjore në trashëgiminë kulturore, e cila nisi me miratimin e ligjit nr.27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”. “Bonusi i Rijetëzimit” është një financim për restaurimin dhe rijetëzimin e objekteve në qendra historike, në modele të qëndrueshme biznesi, që gjenerojnë të ardhura dhe punësim për komunitetin.

-Planifikimi Shpenzimeve Kapitale të Brëndshme (llog.230-231)

Shpenzimet Kapitale për Programin e Artit dhe Kulturës paraqesin një rënie në masën prej 26.76% ndërsa Programi i Trashëgimisë Kulturore paraqitet me një rritje në masën prej 187.5% krahasuar me vitin 2022.

Shpenzimet për Investimet Publike (230-231)	Viti 2022	Viti 2023	Diferenca	%
Aparati,planifikim,manaxhim.	0	0	0	0
Art & Kultura	2,242,500,000	1,642,500,000	-600,000,000	-26.76%
Trashegimia Kulturore e Muzete	20,000,000	57,500,000	37,500,000	187.50%
Shuma	2,262,500,000	1,700,000,000	-562,500,000	-24.86%

Referuar tavaneve të projekt buxhetit për vitin 2023, përsa i përket zërit të investimeve të brëndshme, Ministria e Kulturës do të përqëndrohet në:

Emërtimi institucionit	Emërtimi i Projektit	Statusi projektit	Vitit Fillimit	Viti I përfundimit	Vlera Totale e projektit	Financimi deri në 31.12.2021	Detajimi I Buxhetit v.2022 Plan	Parashikimi për v.2023	Parashikimi për v.2024	Parashikimi për v.2025	Vlera e mbetur per tu financuar pas v.2025
Ministria e Kultures					11,264,653	359,865	2,083,022	1,700,000	2,150,000	1,750,000	2,296,179
Arti dhe Kultura					11,072,175	359,865	2,042,500	1,642,500	2,142,500	1,742,500	2,296,179
Bashkia Tirane	Rijetesimi I Piramides Tirane	vazhdim	2020	2024	1,190,000	168,957	447,597	110,000	57,653		
Aparati MK	Restaurimi, Rikonstruksioni dhe Rehabilitimi I hapësirave ne Muzeun e Arteve te Bukura (GKA)	vazhdim	2021	2024	1,079,404	17,354	121,926	409,392	300,000		
Aparati MK	Projektim dhe Implementim I Mozaikut Tirane	vazhdim	2022	2023	179,259	0	36,000	100,000	43,259		
Aparati MK	Mbikqyrje per projektin, Projektim dhe Implementim I Mozaikut Tirane	vazhdim	2022	2023	2,046	0	409	1,000	637		
Aparati MK	Parku i artit, rivitalizimi dhe rikualifikimi i territorit te ish-Kinostudios "Shqipëria e Re", Tiranë	vazhdim	2022	2023	186,010	69,078	100,000	86,010			
Aparati MK	Ndertim I Qendres Kombetare per Femije dhe TK	vazhdim	2022	2024	1,242,435	0	250,272	442,163	550,000		
Bashkia Tirane	Godina e Teatrit Tirane	vazhdim	2022	2025	3,034,951	0	607,000	493,935	915,951	471,771	546,294
Bashkia Tirane	Godina e Teatrit Tirane (pajisje,mobilim)	vazhdim	2024	2026	1,371,690	0	0	0	275,000	1,020,730	75,960
Trashegimia Kulturore dhe Muzete					192,478	0	40,522	57,500	7,500	7,500	0
Instituti Kombëtar I Trashëgimise Kulturore	Restaurimi I "Kisha Shen Kollit", Krujtje e Siperme, Lushnje	I RI	2022	2025	18,690			4,975	7,500	6,215	
Instituti Kombëtar I Trashëgimise Kulturore	Projekt "Restaurimi i Kishës Fjetja e Shën Mërise", fshati Bishqethem, Lushnje	I ri	2023	2023	10,463			10,463			
Instituti Kombëtar I Trashëgimise Kulturore	Projekt restaurimi "Shen Kolli Shelcan"	I ri	2023	2023	10,500			10,500			
Instituti Kombëtar I Trashëgimise Kulturore	Projekti i plotë: "Restaurimi i kishës së Shën Gjergji," dhe "Ndërrhyrje konsoliduese në pikturën murale dhe ikonostasin", Libofsh, Fier.	I ri	2023	2023	13,823			13,823			
Instituti Kombëtar I Trashëgimise Kulturore	Projekt restaurimi I Ures se Kamares	I ri	2023	2023	3,400			3,400			
Instituti Kombëtar I Trashëgimise Kulturore	Projekt Restaurimi "Ura ne fshtatin Postenan"	I ri	2023	2023	2,400			2,400			
Instituti Kombëtar I Trashëgimise Kulturore	Projekt I plote "Restaurimi I Kishes se Shen Kollit dhe Nderhyrje konsoliduese ne pikturën murale dhe ikonostasin, Vanaj, Fier	I ri	2023	2023	9,814			9,814			
Instituti Kombëtar I Trashëgimise Kulturore	Projekt "Restaurim i kishës Shën e Premte", në fshatin Sop, Fier.	I ri	2023	2023	2,125			2,125			

-Në programin e Trashëgimisë Kulturore dhe Muzetë

Në këtë program, synohet restaurimi i disa monumenteve kulturore në të gjithë Shqipërinë si:

1. Restaurimi i "Kisha Shen Kollit", Krujtje e Siperme, Lushnje
2. Projekt "Restaurimi i Kishës Fjetja e Shën Mërise", fshati Bishqethem, Lushnje
3. Projekt restaurimi "Shen Kolli Shelcan"
4. Projekti i plotë: "Restaurimi i kishës së Shën Gjergji," dhe "Ndërhyrje konsoliduese në pikturën murale dhe ikonostasin", Libofsh, Fier.
5. Projekt restaurimi i Ures se Kamares
6. Projekt Restaurimi "Ura ne fshtatin Postenan"
7. Projekt I plote "Restaurimi I Kishes se Shen Kollit dhe Nderhyrje konsoliduese ne pikturën murale dhe ikonostasin, Vanaj, Fier
8. Projekt "Restaurim i kishës Shën e Premte", në fshatin Sop, Fier.

-Planifikimi Shpenzimeve për Financimin e Huaj (limite buxhetore)

Programet	Financimi I huaj (Grante)			%
	Viti 2022	Viti 2023	diferenca	%
Aparati,planifikim,manaxhim.				
Art & Kultura	95,000,000	50,000,000	-45,000,000	-47.37%
Trashëgimia Kulturore e Muzete	65,000,000	50,000,000	-15,000,000	-23.08%
Shuma	160,000,000	100,000,000	-60,000,000	-37.50%

Me qëllim për të vijuar me projektet IPA në vazhdim nga viti 2022, Ministria e Kulturës referuar disbursimeve të pritshme për financimin e huaj ka planifikuar për vitin 2022 vijimin e projekteve IPA si më poshtë:

- Milestone III- Projekti bashkë financohet nga Bashkimi Europian. D.R.T.K - Vlore është në cilësinë e partnerit në këtë projekt. Projekti i përfituar nga D.R.T.K - Vlore, konsistonte në ndryshimet e restaurimit në murin jugor në Kalanë e Kaninës si dhe në Teqenë dhe Tyrbën në Fshatin Kaninë. Punimet e restaurimit kanë përfunduar dhe aktualisht është duke vijuar vetëm me procedurat e likuidimit të plotë të zerave të projektit, ku është likuiduar rreth 90% e gjithë projektit.
- CREATURES - Adria. Projekti bashkë financohet nga Bashkimi Europian. D.R.T.K - Vlore është në cilësinë e partnerit në këtë projekt. Projekti i përfituar nga D.R.T.K - Vlore, konsiston veç të tjerave, në krijimin e tur guidave kulturore (2), ku aktualisht është në përfundim procesi i vendosjes së gjithë infrastruktures në shërbim të ketyre tureve, kioskave dhe infokioskave që do jenë në funksion të vizitoreve. Kjo është faza e fundit e projektit, për të cilin ka përfunduar rreth 70% e zbatimit të të gjithë zerave të projektit.
- Projekti Smart4You2 është një projekt i cili ka prioritet nxitjen dhe inkurajimin e turizmit, kulturës dhe trashëgimisë kulturore dhe natyrore duke zhvilluar në mënyrë të vazhdueshme dhe

të qëndrueshme potencialin e turizmit si dhe duke promovuar trashëgiminë kulturore dhe vlerat e saj, mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore, zhvillimin e turizmit dhe bashkëjetesës, duke mundësuar kështu një zhvillim të qëndrueshëm social-ekonomik të rajonit ndërkufitar të Pellagonisë.

- Projekti 3 C - Programit INTERREG IPA CBC Itali-Shqipëri- Mali i Zi 2014-2020 po zbaton Projekti Tematik “3C - Cross-border exchange for the development of Cultural and Creative Industries”, nën programin Interreg IPA CBC Itali-Shqipëri-Mali Zi, nr. 354. Forcimi i bashkëpunimi ndërmjet aktorëve të CCI në zonën e projektit, nëpërmjet krijimit të qendrave inovative me programe rezidenciale të artit dhe rrjete të përbashkëta bashkëpunimi ndërkufitar; Rilidhja e kulturës dhe territorit, dhe të ndarja e njohurive, përvojës dhe potencialin krijues, duke rigjallëruar trashëgiminë përmes artit bashkëkohor; Krijimi dhe promovimi i nje platforme rrjetëzimi midis aktorëve kryesorë rajonalë në sektorin e kulturës dhe krijimtarisë, me qëllim përcaktimin e strategjive dhe zbatimin e veprimeve për përmirësimin e sektorit, duke mbështetur shkëmbimin e përvojave, njohurive dhe ideve përmes zhvillimit të produkteve transnacionale, marketingut, brendimin dhe përdorimin e tij për të vlerësuar siç duhet dhe në mënyrë të qëndrueshme asetet kulturore të rajonit.

III. KONSULTIMI PUBLIK I PROJEKLIJIT

Komisioni mbështetur në nenin 36, pika 1 dhe nenin 80, pika 2 të Rregullores së Kuvendit, në kuadër të gjithëpërfshirjes, transparencës dhe konsultimit publik, ka realizuar seanca dëgjimore me aktorë të interesit, si: Akademinë e Shkencave, Akademinë e Studimeve Albanologjike, RTSH-në, ATSH-në, QKK-në, Agjencia për Media dhe Informin, universitetet publike, si në Tiranë dhe në rrethe, Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave etj..

Agjencia për Media dhe Informin

Në hartimin e kërkesave buxhetore janë respektuar tavanet e përcaktuara sipas VKM nr. 130, datë 02.03.2022 “Për miratimin e tavanëve përgatitore të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025”.

Referuar faktit se MIA është institucion i ri i krijuar me VKM nr. 512, datë 18.09.2021 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Media dhe Informin”, për vitin buxhetor 2023, është parashikuar të ketë vetëm 1 (një) produkt me Kod respektivisht 1087040 i cili përfshin *Komunikimin dhe Informimin Mediatik të Këshillit të Ministrave*.

PËRSHKRIMI I PROGRAMIT

- Te sigurojë transparencën në lidhje me politikat, aktivitetet, projektet, eventet, si dhe qëllimin, objektivat, risitë apo problematikat që zgjidhen nëpërmjet akteve të Këshillit të Ministrave dhe të akteve të tjera të Ministrave dhe cdo Institucioni të administratës shtetërore.
-

Tabela 1. Fondet sipas tavanëve buxhetore.

(000 lekë)

Artikujt	Buxheti	PBA 2023 - 2025
----------	---------	-----------------

	2022	2023	2024	2025
Paga (600-601)	94,300	94,300	94,300	94,300
Korente të Tjera (602-606)	50,000	52,000	52,000	52,000
Kapitale (230-232) Të Brendshme	62,000	30,000	5,000	5,000
Kapitale (230-232) Të Huaja	0	0	0	0
Jashtë-buxhetore	0	0	0	0
Totali	206,300	176,300	151,300	151,300

Tabela 2. Fondet sipas kerkesave buxhetore.

(000 lekë)

Artikujt	Buxheti	PBA 2023		
	2022	2023	Pakesim Buxheti ne vlere	Pakesim Buxheti ne %
Paga (600-601)	94,300	87,300	7,000	7.4%
Korente të Tjera (602-606)	50,000	30,000	20,000	40%
Kapitale (230-232) Të Brendshme	62,000	0	62,000	100%
Kapitale (230-232) Të Huaja	0	0	0	
Jashtë-buxhetore	0	0	0	
Totali	206,300	117,300	87,000	43%

Në bazë të analizës të të gjithë faktorëve po shpjegojmë nevojat buxhetore të vitit 2023 si më poshtë:

- **Parashikimi i Pagave dhe Sigurimeve Shoqërore për vitin 2023 është 87,300,000 leke.**

Llogaritja e fondit të pagave dhe sigurimeve (600+601) është bërë sipas organikës të miratuar me Urdhër nr. 136 dt. 23.11.2021 “Per miratimin e strukturës dhe organikes së Agjencisë për Media dhe Informim (MIA)”, dhe Urdhër nr. 20 dt. 08.02.2022 për disa ndryshime dhe shtesa të Urdhërit nr. 136 dt. 23.11.2021 të Kryeministrit “ Për miratimin e strukturës dhe organikes së Agjencia për Media dhe Informim (MIA)”. Numri i miratuar i punonjësve definitive është 69. Gjithashtu llogaritjet janë bazuar në nivelet e pagave të miratuara me Vendim nr.187 datë 08.03.2017 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nënpunësve civilë/nënpunësit në të gjitha institucionet pjesë e fushës së veprimit të këtij vendimi” (ndryshuar me VKM nr.696 datë 22.11.2017, nr.1 datë 04.01.2018, nr. 116 datë

23.02.2018)(i përditësuar).Fondi i pagës (600) për punonjësit definitivë sipas organikës dhe niveleve të pagave parashikohet në vlerën 75.000.000 (shtatëdhjet e pesë milion) lekë, ku kemi nje pakesim nga viti i kaluar ne vleren 7,000,000 (shtate milion) lekë dhe fondi i sigurimeve (601) parashikohet në vlerën 12.300.000 (dymbëdhjetë milion e treqind mijë) lekë.

➤ **Parashikimi i Shpenzimeve operative për vitin 2023 është 30.000.000 leke.**

Llogaritja e fondit për shpenzimet operative (602) eshte bere sipas struktures së MIA dhe analizës së shpenzimeve operative për vitin 2022. Gjithashtu në përlllogaritjen e shpenzimeve operative për vitin e ardhshëm janë marrë në konsideratë vendimi i Kryeministrit Nr. 160, dt. 14.03.2022 “Për reduktimin e shpenzimeve të transportit për funksionarët, nëpunësit, punonjësit e institucioneve të administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave” dhe akti normativ i Këshillit të Ministrave Nr 14, dt 05.10.2022 “Për marrjen e masave të veçanta gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike”.

Agjencia për Media dhe Informim ka kërkuar një fond total prej 30,000,000 (tridhjetë milionë) lekësh për shenzimet operative për vitin 2023.

➤ **Investimet për vitin 2023.**

Në zërin 231 tavanet e vendosura janë 30,000,000 (tridhjetë milionë) lekë por institucioni nuk ka kërkesa të parashikuara për këtë zë.

- **Për realizimin dhe funksionimin në kushte të nevojave reale kërkohet një fond total për buxhetit 2023 në vlerën 117,300,000 lekë.**

Tabela 3. PBA për vitin 2023

(000 lekë)

VITI 2023							
Shpenzime korente				Shpenzime kapitale			TOTAL
600	601	602	Totali Shpenzime Korente	Financim i brendshem	Financim i huaj	Total Shpenzime kapitale	
75,000	12,300	30,000	117,300	0	0	0	117,300

Akademia e Shkencave

Projekt-buxheti afatmesëm (PBA) 2023-2025 i Akademisë së Shkencave, i cili është hartuar bazuar në Udhëzimin nr.7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm”, të Udhëzimeve Plotësuese nr. 9, datë 28.02.2022 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025” (Faza strategjike) dhe nr. 22, datë 08.07.2022 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025” (Faza II, Teknike) të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, duke iu përmbajtur tavaneve përfundimtare të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2023 – 2025 të miratuara me VKM nr. 535, datë 29.07.2022 “Për miratimin e tavaneve përfundimtare të shpenzimeve

të Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025”, si dhe buxhetit të miratuar për vitin 2022, është paraqitur në tabelën e mëposhtme:

I. Buxheti bazë vjetor

a. Sipas artikujve buxhetorë

Në 000 lekë

Nr. Llog	Emërtimi	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024	Viti 2025
600	Paga	30,000	30,000	30,000	30,000
601	Sigur. shoq. / shëndetësore	4,500	4,500	4,500	4,500
602	Mallra dhe shërbime	86,700	122,900	44,400	44,400
605	Transferta korrente të huaja	600	600	600	600
606	Transferta për individët	30,300	30,000	30,000	30,000
231	Investime	1,000	1,000	1,000	1,000
TOTALI		153,100	189,000	110,500	110,500

Buxheti i parashikuar për vitin 2023 ka një rritje prej 36,000 në mijë lekë ose rreth 23% krahasuar me buxhetin fillestar të vitit 2022,

- Buxheti i parashikuar për vitin 2024 ka një rënie prej 78,000 në mijë lekë ose rreth 42% krahasuar me vitin 2023.
- Buxheti i parashikuar për vitin 2025 është i njëjtë me atë të vitit 2024.

b. Sipas produkteve

Buxheti i Akademisë së Shkencave për vitin 2023 përbëhet nga 4 produkte.

•Produkti 1 “92201AA”: në vlerën 74 500 mijë lekë

“Veprimtaria e Asamblesë së ASH-së, seksioneve shkencore, Kryesisë, administratës dhe personaliteteve në fushat e shkencës, në përputhje me misionin e saj, pagat dhe pagesat për tituj”.

Ky produkt përfshin:

1. Pagat	30 000 000 lekë
2. Sigurimet shoqërore e shëndetësore	4 500 000 lekë
3. Titulli akademik	30 000 000 lekë
4. Shpenzime administrative	10 000 000 lekë

Totali

74 500 000 lekë

- **Produkti 2: “92201AB”** në vlerën 41 000 mijë lekë

“Veprimtaria e seksioneve, njësisë kërkimore, komisioneve, veprimtaria promovuese (Veprimtari kërkimore – studimore, projekte, konferenca, seminare, ligjërata, kongrese) etj.”.

Ky produkt përfshin:

- | | |
|--|------------|
| 1. Veprimtari kërkimore-studimore, projekte, konkurset e çmimeve | 40 400 000 |
| 2. Transferta me jashtë (kuota anëtarësimi) | 600 000 |

Totali **41 000 000** lekë

- **Produkti 3: “92201AC”** në vlerën 12 000 mijë lekë

“Publikime shkencore: Botime, monografi dhe revista periodike (Albanian Journal of Natural and Technical Sciences dhe Studia Albanica), të përzgjedhura kombëtare/ndërkombëtare; Raporte të veprimtarisë së ASHSH-së dhe buletine për veprimtaritë e saj”.

Ky produkt përfshin:

- | | |
|-----------|-----------------|
| 1. Botime | 12 000 000 lekë |
|-----------|-----------------|

Totali **12 000 000** lekë

- **Produkti 4: “92201AE” - Projektet madhore në Albanologji, në vlerën 60 500 mijë lekë.**

Prej më se 2 vitesh, pjesë përbërëse e buxhetit të ASH-së është bërë **Produkti “92201AE”** që përfaqëson projektin për hartimin e tri veprave madhore në albanologji: **1. Hartimi i enciklopedisë shqiptare, 2. Fjalori i madh i shqipes, 3. Historia e shqiptarëve**”, financimi i të cilave për vitin aktual 2022 është 30,000 mijë lekë, ndërsa në PBA 2023-2025 për vitin 2023 është parashikuar 60,000 mijë lekë.

Viti 2023 përkon me fillimin e punës për vënien në jetë të marrëveshjes së lidhur ndërmjet Qeverisë Shqiptare dhe asaj të Kosovës sipas Vendimit nr. 421, datë 17.06.2022 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin në parim të marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës për bashkëfinancimin e projektit madhor në Albanologji *Enciklopedia Shqiptare* si dhe me përfundimin e dy projekteve *Fjalori i madh i Gjuhës Shqipe* dhe *Historia e Shqiptarëve*”.

Theksojmë se:

Botimi i *Fjalorit të madh të shqipes*, përveç rëndësisë që ka për të konfirmuar fuqinë shprehëse të shqipes, mbi të gjitha është me rëndësi për të stabilizuar në një shkallë shumë më të lartë normën leksikore të shqipes së shkruar, me zgjerime të një rëndësie themelore.

Historia e shqiptarëve do të jetë një histori sintetike e popullit shqiptar, që do të ketë si lexues pritës kryesisht të huajt, studiuesit e albanologjisë dhe ekspertë të institucioneve evropiane që kanë nevojë për një njohje të thelluar të historisë së popullit shqiptar. Teksti do të promovojë vlerat e identitetit, qytetërimin dhe trashëgimisë shqiptare dhe do të çmjegullojë paqartësitë lidhur me origjinën, vendin e formimit, veçanësinë dhe vijimësinë e popullit shqiptar në trojet e veta.

Enciklopedia shqiptare është vepra e tretë madhore në albanologji, më e vështira dhe më e domosdoshmja. Enciklopedia do të jetë mediumi më i rëndësishëm shkencor për njohjen e shqiptarëve, të historisë, kulturës, trashëgimisë, identitetit dhe vlerave etnotipike të tyre. Do të jetë vepra më e rëndësishme e promovimit të shqiptarëve brenda dhe jashtë vendit.

Duke qenë se për vitin 2023 u buxhetua shuma e kërkuar nga ana jonë prej 60 000 mijë lekë për këto projekte, kërkojmë që **për vitet 2024-2025 të na shtohen respektivisht nga 100 000 mijë lekë për çdo vit**, pasi projekti *Enciklopedia Shqiptare* shtrihet në një afat prej 5 vitesh duke filluar nga viti 2023 dhe vlera e plotë e projektit është 447 000 mijë lekë. Kjo do të garantonte marrëveshjen e bërë ndërmjet dy qeverive dhe sigurinë e vijimit të këtij projekti madhor në albanologji.

KËRKESA BUXHETORE 2023-2025 PËR PROJEKTET ALBANOLOGJIKE

Nr.	ZËRAT E SHPENZIMEVE	Vlera e plotë e projektit	Shtrirja në vite			
			2022	2023	2024	2025
1	Tri projektet albanologjike	447,225	30.000	60,000	100,000	100,000

Të katër këto produkte së bashku, duke shtuar këtu dhe 1 000 000 lekë investime, kapin vlerën **189,000** mijë lekë, që përbën buxhetin bazë vjetor për vitin 2023 të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Me këtë buxhet është parashikuar të përballohen të gjitha shpenzimet vjetore bazë të ASHSH dhe i tërë aktiviteti kërkimor-shkencor që pa dyshim përbën përqendrimin dhe prioritetin e shpenzimeve. Gjatë vitit 2022 janë në realizim e sipër gjithsej 17 projekte kërkimore-shkencore. Nga këto, 14 projekte, ku shumica prej tyre vijnë edhe për vitin 2023, përballohen nga buxheti bazë që sapo e përmendëm më lart. Ndërsa tri projektet e tjera i përkasin fushës së albanologjisë ku përfshihet hartimi dhe botimi i tri veprave madhore, të cilat do të përballohen nga buxheti shtesë i kërkuar nga ana jonë dhe i propozuar nga Këshilli i Ministrave për miratim në vitin 2023.

Për vitin 2023 kërkohet buxhetim në vlerën 24,900 në mijë lekë për blerje të pajisjeve për:

1. Laboratori Epidemiologjik (**8,200** në mijë lekë nga **20,000** në mijë në total kostoja);
2. Qendra Kërkimore e Bioteknologjisë dhe Gjenetikës (**12,500** në mijë lekë nga **28,000** në mijë në total kostoja)
3. Ngritja e Laboratorit të Bioteknologjisë bimore *in vitro* (**4,200** në mijë lekë, aq sa është edhe kostoja totale e projektit).

në 000/lekë

Nr	Kërkesa shtesë per investime 2023 -2025 (pajisje laboratorike)	2023	2024	2025	
1	Blerjen e pajisjeve për Laboratorin Epidemiologjik	8,200	10,000	10,000	28,200
2	Përmirësimi dhe optimizimi i infrastrukturës së QKBGJ	12,500	9,500	6,000	28,000
3	Regjistrimi kombëtar i dhuruesve të qelizave staminale		1,000		1,000
4	Studimi gjenetik dhe funksional i semundjeve të rralla		10,000		10,000
5	Implementimi i qelizave (T CAR) mjekimin e sëmundjeve malinje			15,000	15,000
6	Implementimi i teknologjisë NGS			5,000	5,000
7	Ngritja e laboratorit të Bioteknologjisë bimore <i>in vitro</i>	4,200			4,200
8	Ngritja e Kriobankës		6,800		6,800
9	Ngritja e laboratorit të Bioteknologjisë bimore dhe bioteknologjisë molekulare		9,000		9,000
	Totali kërkesat shtesë për Bioteknologjia dhe Nanoshkenca (blerje pajisje)	24,900	46,300	36,000	107,200
1	Investim - ndërtim godine e re (Zyra për akademikët, profesorët, administratën) në ambientet e ASHSH	40,000	30,000		70,000
	Totali kërkesat shtesë për investime (2023 -2025)	64,900	76,300	36,000	177,200

Kërkesat e mësipërme konsistojnë në funksionimin e njësisë së kërkim-studimit të Bioteknologjisë dhe Gjenetikës që i ka fillimet në vitin 2020, si hapi i parë i rëndësishëm në fillimin e organizimit të punës në këtë drejtim.

Nga sa më sipër, kërkojmë buxhetimin e kërkesave për këto pajisje laboratorike bazë për funksionimin e laboratorëve të njësisë e qendrave kërkimore-shkencore pranë ASHSH.

Komisioni mbështetet kërkesën e Akademisë së Shkencave për realizimin me efektivitet të veprimtarisë së saj.

RTSH

Në Programin Buxhetor Afatmesëm 2023-2025 të miratuar dhe publikuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, tavanet buxhetore të RTSH për vitet 2023-2025 janë rishikuar krahasuar me fazën e

parë dhe të dytë të PBA 2023-2025, me një rritje në total prej rreth 40 mln lekësh (rreth 7 %), përkatësisht 20 mln ne zërin e programit për orkestrën Simfonikë të RTSH dhe 20 mln leke ne programin e projekteve teknike për futjen e teknologjive të reja, si më poshtë:

Tavanet e shpenzimeve të RTSH sipas Programeve Buxhetore		Viti 2023		Viti 2024		Viti 2025	
1	Shërbimi për shqiptarët jashtë kufirit dhe shërbimi për publikun në gjuhë të huaj	ALL	240,000,000	ALL	240,000,000	ALL	240,000,000
2	Prodhime Filmike ose veprimtari Artistike të mëdha mbarëkombëtare	ALL	68,000,000	ALL	68,000,000	ALL	68,000,000
3	Orkestra Simfonike RTSH dhe Kinematografisë	ALL	82,000,000	ALL	82,000,000	ALL	62,000,000
4	Projekte Teknike për Futjen e Teknologjive të Reja	ALL	220,000,000	ALL	200,000,000	ALL	200,000,000
TOTALI		ALL	610,000,000	ALL	590,000,000	ALL	570,000,000

Financimi buxhetor sipas programeve përkatëse, gjatë viteve të fundit paraqitet si më poshtë:

Tavanet e shpenzimeve të RTSH sipas Programeve Buxhetore		Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022
1	Shërbimi për shqiptarët jashtë kufirit dhe shërbimi për publikun në gjuhë të huaj	ALL 240,000,000	ALL 240,000,000	ALL 270,000,000	ALL 220,000,000	ALL 240,000,000
2	Prodhime Filmike ose veprimtari Artistike të mëdha mbarëkombëtare	ALL 65,000,000	ALL 74,000,000	ALL 60,000,000	ALL 60,000,000	ALL 67,600,000
3	Orkestra Simfonike RTSH dhe Kinematografisë	ALL 60,000,000	ALL 60,000,000	ALL 54,000,000	ALL 60,000,000	ALL 62,400,000
4	Projekte Teknike për Futjen e Teknologjive të Reja	ALL 400,000,000	ALL 300,000,000	ALL 250,000,000	ALL 266,000,000	ALL 197,600,000
TOTALI		ALL 765,000,000	ALL 674,000,000	ALL 634,000,000	ALL 606,000,000	ALL 567,600,000

Theksojmë se hartimi i Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025, është bazuar në të dhënat e aktivitetit të viteve të fundit, Programin Buxhetor Afatmesëm 2022-2024 dhe në vlerësimin me përgjegjësi të kërkesave nga të gjitha njësitë e drejtoritë, bazuar në nevojat dhe në informacionet mbi strukturën programore, planet zhvillimore të RTSH, sipas zërave të detajuara të buxhetit.

Radio Televizioni Shqiptar gjatë fazës së II të PBA 2023-2025 ka qene i detyruar ti përmbahet tavaneve buxhetore në zbatim të udhëzimit plotësues, por në relacionin e dërguar pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, kemi riparqitur kërkesat shtesë si domosdoshmëri për funksionimin e RTSH në realizimin e misionit të saj.

Ne projekt buxhetin e paraqitur rezulton që Buxheti i përgjithshëm i RTSH për vitin 2023 parashikohet të jete në vlerën e 2.265.000.000 ALL.

- 610.000.000 ALL nga financimi buxhetor
- 1.655.000.000 ALL nga të ardhurat e vete RTSH (1.4 mld nga tarifa e aparatit, 130 mln nga shfrytëzimi i infrastrukturës transmetuese, 100 mln nga reklamat dhe 25 mln nga të ardhurat e tjera)

Me poshtë po ju paraqesim kërkesat e RTSH, sipas programeve të shpenzimeve:

Më poshtë janë paraqitur në mënyrë të përmblendhur shpenzimet për programin e “Shërbimi për shqiptarët jashtë kufirit dhe shërbimi i publikut në gjuhë të huaj”

1	Programi Buxhetor: "Shërbimi për shqiptarët jashtë kufirit dhe shërbimi për publikun në gjuhë të huaj"	Viti 2023	Viti 2024	Viti 2025
	Shpenzimet për Paga e Sigurime Shoqërore e Shëndetësore (Njesia lajmeve)	ALL 45,495,677	ALL 45,495,677	ALL 45,495,677
	Shpenzime të tjera (Njesia e Lajmeve)	ALL 2,916,000	ALL 2,916,000	ALL 2,916,000
	Shpenzimet për Paga e Sigurime Shoqërore e Shëndetësore (Njesia teknike)	ALL 33,299,160	ALL 33,370,000	ALL 33,370,000
	Shpenzime të tjera (Njesia Teknike)	ALL 34,670,000	ALL 34,670,000	ALL 34,670,000
	Shpenzime për Tarifa Satelitore	ALL 30,000,000	ALL 30,000,000	ALL 30,000,000
	Shpenzimet për Paga e Sigurime Shoqërore e Shëndetësore (Njesia Programeve)	ALL 9,351,876	ALL 9,351,876	ALL 9,351,876
	Shpenzime të tjera (Njesia Programeve)	ALL 4,799,000	ALL 4,799,000	ALL 4,799,000
	Shpenzime direkte dhe indirekte për prodhime filmike dhe artistike	ALL 80,000,000	ALL 80,000,000	ALL 80,000,000
TOTALI		ALL 240,531,713	ALL 240,602,553	ALL 240,602,553

Bazuar në projekt buxhetin e paraqitur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, buxheti i shtetit pritet të financojë 240 mln lekë për çdo vit duke mbuluar nevojat e RTSH për këtë zë për vitet 2023-2025.

Më poshtë janë paraqitur në mënyrë të përmbledhur shpenzimet për programin e “*Prodhime filmike e artistike me rëndësi mbarëkombëtare*”

2	Programi Buxhetore: "Prodhime Filmike ose veprimtari Artistike të mëdha mbarëkombëtare"	Viti 2023	Viti 2024	Viti 2025
	Festivali i Këngës në RTSH	ALL 55,000,000	ALL 55,000,000	ALL 55,000,000
	Pjesëmarrja e RTSH evente nderkombetare	ALL 15,000,000	ALL 15,000,000	ALL 15,000,000
	Programi Festiv i FundVitet	ALL 10,000,000	ALL 10,000,000	ALL 10,000,000
	Prodhime Filmike	ALL 15,000,000	ALL 15,000,000	ALL 15,000,000
	TOTALI	ALL 95,000,000	ALL 95,000,000	ALL 95,000,000

Bazuar në projekt buxhetin e paraqitur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, buxheti i shtetit pritet të financojë 68 mln lekë për çdo vit 2023-2025.

Kërkesat shtesë për këtë program qëndrojnë në nivelin 27 milion lekë në vitin 2023, dhe vitet 2024 dhe 2025.

Shpenzimet e parashikuara për vitin 2023 dhe i parashikuar i njëjtë për 2 vitet në vazhdim (2024-2025), bazuar në strukturën aktuale dhe në nivelin aktual të pagave, është si më poshtë:

3	Programi Buxhetore: "Orkestra Simfonike RTSH dhe Kinematografisë"	Viti 2023	Viti 2024	Viti 2025
	Shpenzimet për Paga e Sigurime Shoqërore e Shëndetësore	ALL 74,324,830	ALL 74,324,830	ALL 74,324,830
	Shpenzime per Aktivitet e Orkestres Simfonike per Stinen koncertore	ALL 15,000,000	ALL 15,000,000	ALL 15,000,000
	Shpenzime te Tjera Indirekte	ALL 1,100,000	ALL 1,100,000	ALL 1,100,000
	TOTALI	ALL 90,424,830	ALL 90,424,830	ALL 90,424,830

Bazuar në projekt buxhetin e paraqitur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, buxheti i shtetit pritet të financojë 82 mln lekë për vitet 2023 dhe 2024 dhe në vlerën 62 mln lekë në 2025.

Bazuar në ligjin Nr. 97/2013 “Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë” neni 116, buxheti e shtetit duhet të financojë 100% Orkestrën Simfonike të RTSH, por shpenzimet faktike për paga e sigurime shoqërore për Orkestrën e RTSH-së, shpenzime të stinës koncertore janë në nivele më të larta se financimi nga buxheti i shtetit për vitin korrent 2022 dhe gjithashtu, bazuar në tavanet buxhetore 2023 dhe 2024, financimi i parashikuar nuk arrin të mbulojë këto shpenzime në vlerën 8.4 milion lekë ndërsa në vitin 2025 vlerën prej 28.4 mln lekë.

Shtesa nga Buxheti i Shtetit paraqitet si domosdoshmëri, pasi edhe në dy vitet e fundit diferenca për pagat e sigurimet shoqërore, dhe për shpenzimet e stinës koncertore të orkestrës, është përballuar nga të ardhurat e veta të RTSH.

Financimi do të sjellë rritje të cilësisë së punës së Orkestrës, si edhe aktivitetet e organizuara do të përbëjnë bazën edhe të pasurimit të arkivës së RTSH me programe, të cilat do të pasurojnë edhe

strukturën programore të kanaleve në radio e televizion, duke çuar në rritjen e audiencës, e për rrjedhojë rritjen e të ardhurave të RTSH.

Kërkesat shtesë për këtë program qëndrojnë në nivelin 8.4 milion lekë në vitin 2023 dhe 2024, dhe 28.4 milion lekë në vitin 2025.

Bazuar në kontratat aktuale të mirëmbajtjes dhe shpenzimeve të tjera kontraktuale dhe në funksion të funksionimit të rrjetit DVB-T2 shpenzimet e parashikuara për vitin 2023 dhe vitet 2024-2025 janë si më poshtë:

4	Programi Buxhetore: "Projekte Teknike për Futjen e Teknologjive të Reja"	Viti 2023		Viti 2024		Viti 2025	
	Shpenzimet e mirëmbajtjes së rrjetit DVB-T2	ALL	270,000,000	ALL	270,000,000	ALL	270,000,000
	Shpenzime të Tjera Indirekte të lidhura me DVB-T2	ALL	8,000,000	ALL	8,000,000	ALL	8,000,000
	TOTALI	ALL	278,000,000	ALL	278,000,000	ALL	278,000,000

Gjatë pesë viteve të fundit, përfshirë edhe vitin aktual 2022, RTSH është financuar nga buxheti i shtetit në rreth 70%-75% të vlerës së shërbimit të mirëmbajtjes të rrjetit DVB-T2.

Kjo është një vlerë e konsiderueshme kundrejt shpenzimeve që RTSH është e detyruar të kryej për mirëmbajtjen MUX-it të dytë që shërben vetëm për të transmetuar operatorët lokalë dhe vendorë privatë dhe jo për programet e RTSH-së. Gjysma e shpenzimeve për mirëmbajtjen shkojnë për MUX 2, ndërkohë që nga këta operatorë lokalë dhe vendorë nuk mblidhet tarifa as për të përballuar as gjysmën e këtij shpenzimi.

Referuar kontratës aktuale të shërbimit të mirëmbajtjes dhe shpenzimeve të tjera të lidhura me funksionimin e rrjetit të digjitalizimit ka një kosto vjetore prej rreth 278 mln ALL (22,5 mln ALL/muaj ose 183.249 €uro/muaj mirëmbajtja dhe 8 mln/vit shpenzime të tjera si qira, energji, lëndë djegëse, shërbime të tjera).

Sa më lart, kërkesat shtesë të RTSH për programin “Projekte Teknike për Futjen e Teknologjive të Reja” për mirëmbajtjen e rrjetit DVB-T2, është 58 mln ALL për vitin 2023 dhe nga 78 mln ALL për vitet 2024 dhe 2025.

Më poshtë paraqitja në mënyrë të përmbledhur i kërkesave shtesë për investime për “Projekte Teknike për futjen e Teknologjive të reja” për vitet 2023-2025:

4	Programi Buxhetore: "Projekte Teknike për Futjen e Teknologjive të Reja"	Viti 2023		Viti 2024		Viti 2025	
	Mbështetje e teknologjisë së re DVB-S2	ALL	17,080,000				
	Rinovimi i regjive	ALL	241,274,000				
	Rinovimi i Ateliese	ALL	129,100,000				
	Digjitalizimi i arkives së filmit	ALL	150,000,000	ALL	70,200,000	ALL	70,200,000
	Hartimi i projektit të RTSH-se	ALL	33,500,000				
	Mikrofona dhe aksesore për regjistrimin e orkestrës	ALL	7,200,000				
	OB - VAN			ALL	305,000,000		
	Përmirësimi i cilësisë së transmetimeve në FM të Radio Tiranës			ALL	17,100,000		
	Sistemi i Transmetimeve në FM			ALL	15,552,800		
	TOTALI	ALL	578,154,000	ALL	407,852,800	ALL	70,200,000

Sa më lart, kërkesat shtesë për investime të RTSH për programin “Projekte Teknike për Futjen e Teknologjive të Reja” paraqiten përkatësisht sipas viteve:

- në vitin 2023 në vlerën => 578.1 mln ALL
- në vitin 2024 në vlerën => 407.9 mln ALL

➤ në vitin 2025 në vlerën => 70.2 mln ALL

1. Përmbledhje e kërkesave buxhetore sipas politikave

Bazuar ne kërkesat e paraqitura për te 4 programet e financimit buxhetor duke përfshire edhe kërkesat shtese të RTSH sipas viteve 2023-2025, theksojmë domosdoshmërinë e miratimit te tyre në kushtet aktuale.

Domosdoshmëria e financimit ka ardhur si pasoje e mungesës së plotësimit të kërkesave shtesë paraqitur gjatë viteve te fundit, e cila ka ndikuar edhe në pamundësinë nga ana e RTSH të likuidimit të kësteve, gofte edhe te pjesshëm të kredisë së financimit te investimit për ngritjen e rrjetit te digjitalizimit.

VITI 2023				
Programi	Tavani Indikativ	Kerkesa Buxhetore	Kerkesa per Financim shtese	
1 Shërbimi për shqiptarët jashtë kufirit dhe shërbimi për publikun në gjuhë të huaj	ALL 240,000,000	ALL 240,000,000	ALL	0
2 Prodhime Filmike ose veprimtari Artistike mbarëkombëtare	ALL 68,000,000	ALL 95,000,000	ALL	27,000,000
3 Orkestra Simfonike RTSH dhe Kinematografisë	ALL 82,000,000	ALL 90,424,830	ALL	8,424,830
4 Projekte Teknike për Futjen e Teknologjive të Reja	ALL 220,000,000	ALL 856,154,000	ALL	636,154,000
TOTALI	ALL 610,000,000	ALL 1,281,578,830	ALL	671,578,830
VITI 2024				
Programi	Tavani Indikativ	Kerkesa Buxhetore	Kerkesa per Financim shtese	
1 Shërbimi për shqiptarët jashtë kufirit dhe shërbimi për publikun në gjuhë të huaj	ALL 240,000,000	ALL 240,000,000	ALL	0
2 Prodhime Filmike ose veprimtari Artistike mbarëkombëtare	ALL 68,000,000	ALL 95,000,000	ALL	27,000,000
3 Orkestra Simfonike RTSH dhe Kinematografisë	ALL 82,000,000	ALL 90,424,830	ALL	8,424,830
4 Projekte Teknike për Futjen e Teknologjive të Reja	ALL 200,000,000	ALL 685,852,800	ALL	485,852,800
TOTALI	ALL 590,000,000	ALL 1,111,277,630	ALL	521,277,630
VITI 2025				
Programi	Tavani Indikativ	Kerkesa Buxhetore	Kerkesa per Financim shtese	
1 Shërbimi për shqiptarët jashtë kufirit dhe shërbimi për publikun në gjuhë të huaj	ALL 240,000,000	ALL 240,000,000	ALL	0
2 Prodhime Filmike ose veprimtari Artistike mbarëkombëtare	ALL 68,000,000	ALL 95,000,000	ALL	27,000,000
3 Orkestra Simfonike RTSH dhe Kinematografisë	ALL 62,000,000	ALL 90,424,830	ALL	28,424,830
4 Projekte Teknike për Futjen e Teknologjive të Reja	ALL 200,000,000	ALL 348,200,000	ALL	148,200,000
TOTALI	ALL 570,000,000	ALL 773,624,830	ALL	203,624,830

Komisioni mbështetet kërkesën e RTSH për realizimin me efektivitet të veprimtarisë së saj.

ATSH

Për vitin 2023, fondi i akorduar për buxhetin e ATSH-së është parashikuar të jetë 59,500 mijë lekë; fondi i pagave 37 200 mijë lekë; fondi i sigurimeve shoqërore 6,450 mijë lekë; fondi për shpenzime operative 11,350 mijë lekë; fondi për transfertat me jashtë 3500 mijë lekë dhe fondi për investimet e trupëzuara 1000 mijë lekë.

Sikurse e dini, Agjencia Telegrafike Shqiptare, e themeluar që në 1913 dhe zyrtarisht me Dekret të vitit 1954, vazhdon të jetë agjencia e vetme shtetërore e lajmeve në Shqipëri.

ATSH prodhon dhe shpërndan në botë lajmin zyrtar institucional, përveçse në gjuhën shqipe edhe në anglisht dhe frëngjisht, duke u referuar të gjitha burimeve serioze, jo vetëm të informacionit, por edhe prej agjencive të specializuara që përpunojnë të dhëna, informacione mbi zhvillimet politike, ekonomike, klimën e biznesit, interesin për investime etj.

Lajmi zyrtar, shpërndahet nëpërmjet rrjetit të agjencive partnere në të gjithë botën duke shërbyer si referim real për zhvillimet në vend, duke kryer kështu një komunikim lehtësisht të aksesueshëm nga rrjetet apo tregjet globale të informacionit.

Duke ndjekur edhe modelin e agjencive më të rëndësishme botërore, syonojmë që nëpërmjet lajmit të jemi kontribues në sektorë të rëndësishëm dhe jetik të vendit, në ekonomi, bujqësi dhe turizëm. ATSH ka një rrjet të gjerë partnerësh seriozë dhe homologë ndërkombëtarë, në rajon dhe Europë, që përbëjnë shtyllën informative të vendeve të tyre me të cilat kemi marrëdhënie të ngushtë dhe të vazhdueshëm bashkëpunimi në shkëmbimin e informacioneve.

Nisur nga kjo, ATSH ka potencialin dhe mundësitë që të jetë burimi i vetëm i informacionit zyrtar mbi zhvillimet në vendin tonë. ATSH ka arritur të prodhojë në ditë të zakonshme deri në 200 tituj lajmesh në ditë në gjuhën shqipe, të përkthyer në dy gjuhë, anglisht dhe frëngjisht.

Konkretisht, deri tani që flasim janë botuar në gjuhën shqipe 23 980 tituj lajmesh, 7527 tituj lajmesh të përkthyer në anglisht dhe 4360 tituj lajmesh në frëngjisht.

Gjithashtu ekipi i Agjencisë Telegrafike Shqiptare ka vijuar edhe gjatë këtij 6-mujorit botimin e përjavshëm të “Newsletter” në anglisht për të gjithë klientët e agjencisë, përfshirë dhe ambasadat e huaja në vend. Përmes këtij buletini përcillen në mënyrë të përmbledhur zhvillimet më kryesore të ditës. Një fokus i veçantë në “Newsletter” i është dhënë sektorit të turizmit duke promovuar nëpërmjet botimeve speciale, destinacionet dhe resurset e njohura dhe të panjohura turistike, traditën dhe kulinarinë e pasur shqiptare.

Komisioni mbështetet kërkesën e ATSH për realizimin me efektivitet të veprimitarisë së saj.

Qendra Kombëtare e Kinematografisë (QKK)

Shqipëria ka buxhetin më të vogël krahasuar me vendet e Ballkanit dhe Evropës (përfshi këtu dhe Kosovën). Kjo ka ndikuar për keq, në potencialin e bashkëprodhimeve shqiptare, të cilat nuk kanë fuqi ekonomike për të krijuar një kusht të barazvlefshëm financiar me prodhimet e vendeve të tjera.

Buxheti dy vitet e fundit ka pësuar ulje, ndërkohë që kërkesat për mbështetje financiare të projekteve kinematografike është në rritje, nga autorët dhe producentët vendas dhe të huaj.

Si pjesë e Programit Buxhetor Afatmesëm kërkesat buxhetore sipas zërave të projekt buxhetit të vitit 2023, krahasuar me buxhetin e vitit 2022 paraqiten si më poshtë:

	<u>Viti 2022</u>	<u>Viti</u>	<u>2023</u>
	<u>Ndryshimi</u>	<u>Në lekë dhe %</u>	
- Shpenzime për paga e sig.shoq	9,390	9,390	0
- Shpenzime korrente	148,050	147,610	-440
- Investime të brendshme	1,000	1,000	0
- Investime të huaja			
TOTALI	158,440	158,000	-0.01 %

Tavanet e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025 nuk i përmbushin nevojat më të domosdoshme të funksionimit të Qendrës Kombëtare të Kinematografisë.

Të ardhurat direkte nga investimet për xhirimet janë njëra anë e medaljes ndërkohë që ana tjetër, aspak për t’u neglizhuar është benefiti në aspektin e punesimit të specialisteve në fushën e prodhimit kinematografik si dhe të promocionit në territorin me konsekuencë të

pashmangshme në rritjen e turizmit kulturor dhe jo vetëm.

Për këtë incentivë kemi kërkuar buxhetin në masën 100,000 milionë Lekë.

Komisioni mbështetet kërkesën e QKK për realizimin me efektivitet të veprimtarisë së saj.

Akademia e Studimeve Albanologjike

Hartimi i projektbuxhetit të Akademisë së Studimeve Albanologjike (ASA) për periudhën 2023-2025 është bërë duke marrë në konsideratë:

- a) Realizimin e detyrave që i dalin në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, dheme Statutin e ASA-s.
- b) Planin e Zhvillimit të ASA-s, të miratuar nga Senati Akademik i ASA-s, si dhe vendimet e propozimet e Këshillave Shkencorë të Instituteve të ASA-s.
- c) Përvojën e deritanishme të institucionit, me qëllim që të bëhet i mundur një funksionim normal dhe rezultativ i Instituteve dhe i njëjësive kërkimore-shkencore e atyre ndihmëse për sa i përket kërkimit shkencor, veprimtarisë pedagogjike dhe hulumtuese, si dhe nevojave urgjentepër mirëmbajtjen, përmirësimin dhe pasurimin e bazës materiale, për shërbimet e investimet në ambiente e në paisje etj.
- ç) Gjithashtu, në hartimin e këtij projektbuxheti është synuar që të paraqiten kërkesa sa më reale dhe të domosdoshme për funksionimin e ASA-s, në përputhje me misionin dhe me statusin e këtij institucioni elitë kombëtar në fushën e kërkimit shkencor dhe të albanologjisë.

Në hartimin e projektbuxhetit për periudhën 2023-2025 jemi mbështetur në zbatimin të Ligjit Nr. 9936, dt. 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar të Ligjit Nr.10 296, dt. 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar të Ligjit Nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar, si dhe të Udhëzimit Plotësues Nr.1, dt. 10.01.2022 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022”.

Për vitin 2022 fondi i akorduar institucionit tonë në formën e grantit është: **235,000,000 lekë**

Artikull	Përshkrimi	Shuma
600	Shpenzime Paga	158,640,000
601	Shpenzime Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore	26,492,880
602	Shpenzime operative	49,363,120
606	Shpenzime për transfera të tjera tek personeli	504,000
Totali		235,000,000

Për vitin 2023 ASA-ia kërkon nie fond në total prej 400,196,560 lekë. Në vijim do të keni të detajuar sipas Artikuleve të Shpenzimeve 600, 601, 602, 604, ei dhe Artikulli 231 Investime.

Për vitin 2023 kërkojmë për zërin SHPENZIME PËR BOTIMIN E VEPRAVE SHKENCORE TË ALBANOLOGJISË shumën prej 12,000,000 lekë.

Për vitin 2023 ASA për zërin Shpenzime Opezeative kërkon një buxhet prej 127,630,000 lekë sipas tabelës së mëposhtme:

		Në Lekë	
Përshkrimi nga Art.602		I pritshmi 2022	Kërkesa 2023
602.0	Materiale zyre dhe të përgjithshme	2,960,000	4,800,000
1	Kancelari	700.000	1,000,000
2	Materiale për pastrim dhe dezinfektim	1,660,000	2,500.000
3	Materiale për funksionimin e paisjeve të zyrës, Tonera	600,000	1,000.000
4	Materiale të tjera zyre dhe të përgjithshme	0	300.000
602.1	Materiale dhe sbërbime speciale	9,600,000	12,800,000
1	Vepra shkencore të albanologjisë	9,000,000	12,000,000
2	Materiale laboratorike	0	0
3	Të tjera materiale	600.000	800,000
602.2	Shërbime nga të tretë	18,498,000	23,880,000
1	Elektricitet	1,500.000	2.000,000
2	Ujë	400,000	400,000
3	Internet	480,000	500,000
4	Telefoni Fikse	278.000	300,000
5	Posta	20,000	30,000
6	Shërbime të sigurimit dhe ruajtje	15,300,000	20,000,000
7	Shërbime të printimit dhe publikimit (fotokopje)	520,000	650,000
602.3	Shpenzime transporti	1,240,000	2,380,000
1	Carburant dhe vaj	1,000,000	2.000,000
2	Pjesë këmbimi, gonna dhe bateri	120,000	250,000
3	Shpenzime siguracioni mjete transporti	120,000	130,000
602.4	Shpenzime udhëtimi	4,303,000	24,000,000
1	Udhëtim i brendshëm	2,303,000	12,000,000
2	Udhëtim jashtë shtetit	2,000.000	12,000,000
602.5	Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme	2,290,000	3,000,000
1	Shpenzime mirëmbajtje të objekteve ndërtimore	1,600,000	2,000,000

2	Shpenzime për mirëmbajtje të injeteve të transportit	120,000	200,000
3	Shpenzime për mirëmbajtje të pajisjeve të zyrave	570,000	800,000
602.6	Shpenzime për qiramarrje	400,000	750,000
1	Shpenzime për qiramarrje ambientesh	400,000	750,000
2	Shpenzime për qiramarrje mjete transporti	0	
602.9	Shpenzime të tjera operative	20,876,000	56,020,000
1	Shpenzime për pritje dhe përcjellje	870,000	500,000
2	Shpenzime për Honorare nga shkolla doktorale, Këshillat, Redaksia, e Drejta e Autorit.	15,618,000	40,000,000
3	Shpenzime për organizimin e konferencave dhe “Ditët e Albanologjisë”	4,000,000	1 5,000,000
4	Shpenzime për tarifa vendore	1 8,000	20,000
5	Shpenzime për të tjera materiale dhe shërbime operative	370,000	500,000
	Shuma:	60,167,000	127,630,000

Në Artikullin 602 për vitin 2022 kemi U trashëguar dhe shumën prej 10,800.000 lekë, fond i akumuluar gjatë periudhës së pandemisë, i cili nuk u bë i mundur të realizohej. Është në plan për t’u realizuar brenda këtij viti.

Për vitin 2023 për zërin Investime ASA-ja kërkon një buxhet prej 71,000,000 lekë.

Në Lekë		
	Përshkrimi nga artikulli 231	Kërkesë 2023
1	Rikonstruksion i Muzeut Arkeologjik - Tiranë	36,000,000
2	Rikonstruksion i “Shtëpisë së arkeologëve” në Apolloni	4,000.000
3	Rikonstruksion i çatisë së IAKSA	10,000,000
4	Blerje programi kompjuterik për Fondet, Arkivat, Bibliotekën	5,000,000
5	Blerje rafte metalike (stelazhe) për Bibliotekën	6,000.000
6	Blerje pajisje për laboratorin e IAKSA	10,000,000
	Shuma:	71,000,000

Për vitin 2023 ASA-ja kërkon një rritje buxheti si më poshtë:

		Në Lekë
Artikull	Përshkrimi	Shuma
600	Shpenzime Paga	172.680,000
601	Shpenzime Sigurime Shoqërore dhe Shëndetsore	28,837,560
602	Shpenzime operative	127.630,000
604	Shpenzime të tjera për personelin	49,000
231	Investime	71.000.000
Totali		400,196,560

Komisioni mbështetet kërkesën e ASA për realizimin me efektivitet të veprimtarisë së saj.

Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave

Në përgatitjen e projekt buxhetit afatmesëm 2023-2025 janë parashikuar disa nga projektet kryesore duke respektuar tavanet e miratuar nga Këshilli i Ministrave. Duke shqyrtuar nevojat dhe kërkesat e Institucionit tonë konstatojmë se gjatë viteve të ardhshme nevojiten të ndërmeren disa projekte për të garantuar funksionim normal të aktivitetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, por që nuk mund të financohen duke konsideruar tavanet e përcaktuara për PBA-në e viteve 2023-2025.

Për këtë arsye, në PBA 2023-2025, “Kërkesë për Fond 231 “Investime”, janë parashikuar disa financime të cilat janë shumë të nevojshme për Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave, për realizimin e të cilave nevojiten shtesë në fondet e ardhshme.

Sa më sipër, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, pas rikonstruksionit dhe përshtatjes së godinës për muze, për të cilin është lidhur kontrata dhe përfundon brenda vitit 2022, ka të domosdoshme fondet për “Strukturim i brendshëm i Muzeut të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave” në shumën e 100 milionë lekë për vitin 2023.

Kërkesa shtesë për PBA-në e viteve 2023 jepet në tabelën e mëposhtme.

Nr.	Emërtimi i Projektit	Llogaria	2023 000/lekë	2024 000/lekë	2025 000/lekë
1	“Strukturim i brendshëm i Muzeut të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave”	231	100,000		
	Shuma		1 00,000		

Komisioni mbështetet kërkesën e DPA për realizimin me efektivitet të veprimtarisë së saj.

Universitetet publike

Në seancat dëgjimore të organizuara me universitetet publike të Tiranës dhe të rretheve, drejtuesit e tyre kërkuan mbështetje në buxhet për vitin 2023.

Universiteti i Mjekësisë

Në përputhje me misionin dhe strategjinë e tij, UMT hartoi Projekt Buxhetin Afatëmesëm 2023- 2025, të cilin e shoqëroi me një proces gjithëpërfshirës të stafit akademik, jo akademik dhe këshillave studentore, miratuar: **në Rektorat me Vendimin nr.12, date 02.09.2022** “Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025 dhe treguesit e vitit 2023, për Universitetin Mjekësisë, Tiranë”, **në GMS me Vendimin nr.03, date 26.09.2022** “Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025 dhe treguesit e vitit 2023, për Universitetin e Mjekësisë, Tiranë” dhe **në Senatit Akademik me Vendimin nr.67, datë 30.09.2022** “Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025 dhe treguesit e vitit 2023, për Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”.

Hartimi i projekt-buxhetit 2023-2025, ka si synim, plotësimin sa më mirë të treguesve ekonomik dhe financiarë, në mbështetje të veprimtarisë themelore të UMT-së, që është formimi dhe edukimi i profesionistëve të shëndetit në të tria ciklet e studimit sipas standardeve më të larta profesionale, realizimin dhe nxitjen e kërkimit shkencor, frymëzimin dhe promovimin e risive në fushën e shkencave mjekësore, si dhe për të edukuar dhe frymëzuar liderët e së ardhmes në fushën mjekësore.

Aktualisht ka përfunduar projekt-preventivi për rindërtim dhe vlera totale e parashikuar është 353,528,249 lekë, për rindërtimin e godinave si më poshtë:

- 1- Godina e Anatomisë - 91,569,144 lekë
- 2- Godina e Farmacisë dhe Shëndetit Publik - 225,248,193 lekë
- 3- Godina e Leksioneve të Godina e Paraklinikut - 36,710,912 lekë

Sa më sipër, është parashikuar që **Godina e Anatomisë dhe Godina e Leksioneve të Godina e Paraklinikut, në vlerë totale 128,280,056 lekë (36% e vlerës totale të projekt preventivit), të rindërtohen nga të ardhurat e universitetit.**

Godina e Farmacisë dhe Shëndetit Publik në vlerën 225,248,193 lekë (64% e vlerës totale të projekt preventivit), është kërkuar në Buxhetin e vitit 2023, të rindërtohet nga fondet grantë buxhetit të shtetit.

Në MAS është dërguar projekt-preventivi final së bashku me fishat e investimit për të përfutur fonde buxhetore.

Universiteti Bujqësor i Tiranës kërkon:

Bazuar në eksperiencën e deritanishme (15-vjeçare), në nevojën për realizimin e aktiviteteve të mësipërme për zhvillimin normal të funksionimit të këtyre njësive, , si dhe bazuar në buxhetin e çdo viti që Universiteti Bujqësor i ka akorduar këtyre njësive, kërkojmë që buxheti për këto njësi të llogaritet jashtë përcaktimeve (*formules*) të përcaktuara nga **VKM nr. 75** datë 12.2.2018 “Për miratimin e modelit të financimit të Institucioneve Publike të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor”, duke dedikuar posaçërisht një buxhet të përcaktuar në vlerën e një minimumi të domosdoshëm prej **55 000 000 Lekësh** për aktivitetin e këtyre tre njësive (Banka Gjenetike Shqiptare, Laboratori i Peshkimit dhe Ferma Didaktike Eksperimentale).

Ne propozojmë ndryshime në formulën e financimit të IAL-ve publike të përcaktuara **në VKM nr.**

75 datë 12.2.2018 “Për miratimin e modelit të financimit të Institucioneve Publike të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor”, ku financimi për këto tre njësi që relatuam, të realizohet me kritere të rëndësishë së veçantë, jashtë formulës së llogaritjes së “**grantit për mësimdhënie**”, grant i cili bazohet në numrin e studentëve që ndjekin ciklin e parë të studimeve, programin apo drejtimin e studimeve, në të ardhurat e siguruar nga tarifat e shkollimit si dhe në koeficientin e financimit për drejtimet e studimeve. Për veprimtarinë e Universitetit Bujqësor të Tiranës do të ishte jetike dhe një zgjidhje përfundimtare për sigurimin e aktivitetit normal të këtyre njësive të cilat janë të një rëndësie kombëtare pasi i shërbejnë ekonomisë së vendit.

Spektori i bujqësisë luan një rol të rëndësishëm në Ekonominë e vendit, dhe **roli i Universitetit Bujqësor** si Institucioni i vetëm arsimor i lartë i këtij lloji në Shqipëri që siguron kompetenca profesionale në këto fusha, është jetik dhe i pazëvendësueshëm dhe si i tillë duhet që të shikohet me përparësi edhe në mbështetje financiare.

Universiteti i Tiranës

Sipas ligjit 80/2015 "Per arsimin e larte dhe kerkimin shkencor ne institucionet e arsimit te larte ne RSH", autonomia financiare e IAL-ve, nder te tjera garantohet nepermjet se drejtes per te perfiturar fonde shtetore. Duke pare buxhetet e miratuara per arsimin e larte ne vitet e fundit megjithe ndonje rritje te here pas hershme konstatojme se ka qene i pamjaftueshem per te lehtesuar institucionet publike te arsimit te larte ne permbushjen e misionit qe ata kane sipas ligjit te arsimit te larte.

Persa i perket projektbuxhetit te vitit 2023 ai ka nje rritje me pak se 1 mld lek por qe krahasuar me kerkesat e institucioneve publike te arsimit te larte lidhur me kete buxhet eshte rreth 2 mld lek me pak.

Keshtu qe do te vleresonim qe minimalisht granti qe duhet miratura per IAL publike duhet te perfshije shumen e kerkuar prej tyre me nje rritje jo me pak se 10% qe vjen dhe si rezultat i rritjes se pagave sipas VKM-se nr.647, date 05.10.2022.

Persa i perket Universitetit te Tiranës, **per vitin 2023** kerkesat sipas PBA per funksionimin e UT-se jane **2,342,679 mije leke**, nga te cilat: **1,778,355 mije leke** per pagat dhe sigurimet shoqerore, **200.000 mije leke** shpenzime operative per projekte te kerkimit shkencor, **364.234 mije leke** per bursat e studenteve. Në këto nevoja per grant nuk eshte perfshire efekti financiar i rritjes se pagave ne UT ne **masen 7%**, **ne shumen 124.485 ne mije Ieke** miratuar me VKM nr 647, date 5.10.2022.

Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan kërkon rritjen e investimeve, mbështetjen e projekteve kërkimore shkencore

Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë kërkon të mbështetet me fonde per pagat ku shprehet se buxheti I tije vjene ne renie nga viti ne vite.

Universiteti i Arteve kërkon mbështetjen dhe miratimin per buxhetin e kerkuar 2023

IV. DISKUTIMI NË KOMISION

Karakteristikat kryesore të projekt buxhetit të vitit 2023 dhe projekt buxhetit afatmesëm 2023-2025

Treguesit kryesorë makroekonomik e fiskalë të projekt buxhetit 2023 jane si më poshtë:

- Rritja reale e PBB 2.6%
- Inflacioni 3.6%
- Të ardhurat 29 e PBB
- Shpenzimet 31.6 PBB
- Dificiti buxhetor 2.6 PBB
- Borxhi publik 7.5% PBB
- Investimet publike 5.5% PBB
- Norma e papunësisë 10.2% PBB

Në diskutimin në parim për projektligjin “Për Buxhetin e Vitit 2023”, gjatë seancave me ministrinë e linjës dhe institucionet e tjera, u fol gjerësisht për projektligjin, qëndrueshmërinë e tij, përmbushjen e Programit të Qeverisë Shqiptare, prioritetet e saj, ku arsimit, kultura, shkenca e sporti kanë vëmendje të veçantë, gjë që shprehet, në mes të tjerash, në rritjen e buxhetit në disa drejtime. Gjatë gjithë takimeve komisioni është në mbështetje të nismave ligjore, administrative e mbi të gjitha mbështetjes me sa më shumë fonde për ruajtjen, konservimin, restaurimin, mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë sonë kulturore. Po aq mbëhstesin çdo nismë ndër të rinjtë e madje duke e shtrirë që në arsimin fillor për promovimin dhe edukimin e brezit të ri me vlerat e trashëgimisë sonë kulturore, nxitejn për të lexuar, për të marë pjesë në aktivitete social-kulturore etj. Por thënë opzita, shohim se relacioni i projekt buxhetit na jep shumë pak të dhëna, duke u ndalur më shumë tek ide, prioritetet që duken më shumë si propagandë apo premtime elektorale, por nuk na tregon, qoftë edhe në vija të trasha, sesi mund të arrihen objektivat e dhëna. Arrijmë në përfundimin se shumë nga prioritetet sikundër e sqaruam, nuk janë të matshem, kanë një shtritje kohore 2 apo tri vite dhe ne e kemi të pamundur të kontrollojmë rezultatet e tyre, duke qenë se ne po diskutojmë për vitin 2023 dhe jo për 2024 apo për 2025.

Në investimet e parashikuara në vitin 2023, duket se ato janë kufizuar në 7 projekte në Bashkitë Fier Lushnjë dhe në Tiranë, që kanë shtrirje kohore më shumë se 1 vit buxhetor

Janë të paqarta sesi do të arrihen rezultatet e pritshme, ndërkohë që siç theksuam nuk kemi mekanizma si të matim shifrat e dhëna nga MK në këtë relacion. Është e paqartë për ne sesi do të forcohet partneriteti publik-privat në rijetëzimin e objekteve të trashëgimisë kulturore Duhet të njehmi se cilat janë projekte,

shumat që do të shpenzohen për këto projekte dhe së fundmi roli i shtetit dhe privatit në këto projekte. Me thellimin e bashkëpunimit me PPP, mund të rrezikojmë të përsërisim precedentin e Butrinti dhe kjo do të ishte shumë e rëndë dhe krejtësoht e papranueshme nga ana jonë. Mes këtyre dilemave e dyshimeve të mëdha që ngre ky buxhet dhe me një relacion të varfër që nuk jep të dhëna të qenësishme, për të krijuar një panoramë të qartë të sektorit të Kulturës si në prioritetet që janë shkruar edhe në rezultatet e pritshme, nuk mund të japim votën pro për buxhetin që na paraqitet ng MK. Deputetët e opozitës sygjerojnë që Ministrinë e linjës t'i kenë në konsideratë verejtjet e tyre konstruktive ne draftin përfundimtar te Buxhetit, sa kohë ato janë për përmirësimin e punës së institucioneve, si edhe pse përmirësimin e jetës se shqiptarëve. Nga mazhoranca propozohen shtesa buxhetore për institucionet e pavarura për përmirësimin e e performances së tyre sic esht përcaktuar më lart. Deputetët e Opozitës dhanë mbështetje e tyre për fondet shtesë ne buxhetet e disa institucioneve të pavarura arsimore e kulturore. Në mbështetje të projektligjit “Për Buxhetin e Vitit 2023”, ishin deputetët e mazhorancës: Petro Koci, Besion Ajazi, Eduard Ndreca, Luljeta Bozo, Teuta Ramaj, Lindita Buxheli, Desantila Tahiraj, Ismet Beqiri. Gjithashtu ishin në mbështetje të projektligjit “Për Buxhetin e Vitit 2023” Deputetet e opozitës: Flutura Aça, Merita Bakiu, Eralda Bano, Andia Ulliri, Kastriot Piroli, si dhe deputetja e pavarur Meri Markiçi. Ishin kundër projektligjit “ Për Buxhetin e Vitit 2023” deputetja opozitës Ina Zhupa.

V. PËRFUNDIM.

Në përfundim, Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, duke vlerësuar projektligjin “Për Buxhetin e Vitit 2022” në tërë komponentët e tij, me shumicë votash miratoi në parim projektligjin dhe i paraqet Raportin e tij Komisionit për Ekonominë dhe Financat.

RELATORE

Dasantila Tahiraj

Enslemvera Zake

Merita Bakiu

KRYETAR

Flutura Aça



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

(Dokument Parlamentar)

Tiranë, më 16. 11.2023

RAPORT
PËR PROJEKTLIGJIN
“PËR BUXHETIN E VITIT 2023”
PËR DISKUTIMIN NEN PËR NEN DHE NË TËRËSI

- *Hyrje*

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, në disa seanca të mbledhjeve të tij të datave 27,28,31,01 nëntor 2022, mori në shqyrtim nen për nen dhe në tërësi projektligjin “Për Buxhetin e Vitit 2023”. Kjo nismë është propozim i Këshillit të Ministrave.

Relatore të projektligjit janë znj. Enslemvera Zake, znj. Dasantila Tahiraj dhe znj. Merita Bakiu. Në diskutimin nen për nen dhe në tërësi ishin të pranishëm Gentian Opre – drejtor i Drejtorisë së Analizës dhe Programimit Buxhetor, në Drejtoria Përgjithshme të Buxhetit, në Ministrinë e Financave **MSA**: Albana Tole- Zv.ministre e Arsimit dhe Sportit, Mirela Bimo- drejtore e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, Voltisa Koci- drejtore e Kuadrit Rregullator. Gjithashtu u organizuan seanca dëgjimore me institucione që financohen edhe nga Buxheti i Shtetit.

III. BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 81-83, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës, sipas nenit 80 të Rregullores së Kuvendit.

IV. QËLLIMI, PËRMBAJTJA DHE RISITË E PROJEKTLIGJIT

2.1. Qëllimi i projektligjit:

Në projektbuxhetin e vitit 2023, **programimi i të ardhurave buxhetore** mbështet synimet e Qeverisë për rimëkëmbjen ekonomike, si dhe mbajtjen nën kontroll të defiçitit buxhetor dhe borxhit publik.

Në përputhje të plotë edhe me rregullat fiskalë, në ligjin organik të buxhetit, politika fiskale do të vijojë të orientohet drejt konsolidimit fiskal në periudhën afatmesme dhe afatgjatë etj...

Buxheti i MAS 2023

Tavanet buxhetore të propozuara nga Këshilli i Ministrave me projektligjin “Për buxhetin e vitit 2023” kanë pësuar ndryshime krahasuar me tavanet e miratuara me VKM nr. 535, date 29.7.2022 “Për miratimin e taveve përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2023-2025” për buxhetin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Referuar projektligjit të paraqitur në Kuvend në Tetor 2022, fondet për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit kanë reflektuar kërkesat kryesore të ministrisë së arsimit dhe sportit, duke u shtuar tavanet e miratuara në Korrik 2022 edhe shumën **2 miliard e 190 milion lekë** ose 5% më shumë krahasuar me fondet e planifikuara në tavanet e miratuara me VKM nr. 535 të muajit Korrik 2022.

- Shpenzimet e personelit, janë shtuar me 1 miliard e 940 milion lek;
- Shpenzimet operative, përfshirë fondet grant të IAL-ve publike, janë shtuar me 450 milion lek;
- Shpenzimet kapitale me financim të huaj janë shtuar 200 milion lekë ndërsa shpenzimet kapitale me financim të brendshëm, janë ulur 400 milion lekë;

Buxheti i planifikuar në projektligjin “Për buxhetin e vitit 2023” arrin të përmbushë objektivat dhe prioritetet kryesore të MAS për periudhën 2023-2025

Arsimi parauniversitar:

(arsimi parashkollor, arsimi bazë dhe arsimi i mesëm i përgjithshëm).

Fondet për Arsimin parauniversitar, miratohen në dy programe të veçanta buxhetore, përkatësisht arsimi bazë dhe arsimi i mesëm i lartë.

Në vitin 2023 fondet në arsimin parauniversitar janë planifikuar në total 33 miliardë e 321 milion lek, nga të cilat:

- 28,15 miliardë lek- shpenzime personeli/paga+sigurime shoqërore/shëndetësore (600, 601)
- 2 miliard e 571 milion lek- shpenzime korrente/operative (602-606)
- 2 miliard e 599 milion lek- shpenzime kapitale/investime (230-231)

Fondet e MAS për vitin 2023 për arsimin parauniversitar, zënë;

- 70,6% të buxhetit të MAS;
- 1,53% të PBB-së;
- 4,85% të shpenzimeve publike.

Krahasuar me buxhetin e vitit 2022, buxheti për arsimin parauniversitar ka një rritje nominale me 650 milion lek ose 2%. Rritje kanë shënuar shpenzimet kapitale me 279 milion lekë dhe shpenzimet korrente me 371 milion lekë.

Në vitin 2024 janë planifikuar fonde në total 33 miliard e 613 milion lekë ose

- 1.47% e PBB-së dhe
- 4,82% e shpenzimeve publike.

Në vitin 2025 janë planifikuar fonde 33 miliard e 872 milion lekë ose

- 1.41% e PBB-së dhe
- 4,64% e shpenzimeve publike.
- Fondeve për arsimin parauniversitar, përveç fondeve të parashikuara në buxhetin e MAS për vitin 2023, i shtohen edhe fondet e buxhetit të shtetit që akordohen nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë për arsimin profesional, nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për shërbime në funksion të arsimit parauniversitar si dhe shërbimet për arsimin parashkollor dhe fondet për nxënësit që akomodohen në konviktet e arsimit profesional apo atij të mesëm të përgjithshëm, si dhe fondi i rritjes së pagave për punonjësit arsimorë.

Fondet totale të buxhetit të shtetit të destinuara për “Arsimin parauniversitar” për vitin 2023 arrijnë shumën 51,4 miliardë lekë, dhe përfaqesojnë;

- **2,4% të PBB-së;**
- **7,5% të shpenzimeve publike.**

Tabela 1. Fondet e miratuara për vitin 2020-2021 si dhe tavanet e propozuara për periudhën 2023-2025 për Arsimin Parauniversitar

ARSIMI PARAUNIVERSITAR (Arsimi Bazë+Arsimi i Mesëm)									
	Buxheti rishikuar 2020	Fondet miratuara "Për Buxhetin e vitit 2021"	Tavanet miratuar ligji nr.115/2021 "Per buxhetin e vitit 2022 "	Tavanet e propozuar në P/ligjin, Tetor 2022					
Artikujt				2023	2024	2025	2023/2022	2024/2023	2025/2024
Paga (600-601)	25,752,705	28,059,363	27,979,666	28,150,670	28,033,367	27,723,767	1%	0%	-1%
Korrente të Tjera (602-606)	2,121,558	2,010,320	2,371,451	2,571,451	2,680,767	3,049,734	8%	4%	14%
Kapitale (230-232) Të Brendshme	1,913,487	446,003	2,320,000	2,599,000	2,899,000	3,099,000	12%	12%	7%
Kapitale (230-232) Të Huaja	2,000	-	-	-	-	-			
Totali nr.1	29,789,750	30,515,686	32,671,117	33,321,121	33,613,134	33,872,501	2%	0,9%	0,8%
Strukt ndaj totalit buxh MAS	71.9%	71.0%	71.9%	70.6%	69.9%	69.4%			4%
Ne % ndaj GDP sipas p.ligjit treguesit fiskale	1.8%	1.6%	1.6%	1.53%	1.47%	1.41%			
Ne % ndaj shpenzimeve publike, sipas pligjit treguesit fiskale	5.6%	5.1%	4.9%	4.85%	4.82%	4.64%	92%	84%	83%
Numri I Nxenesve AB+AM	347,495	338,628	327,906	327,906	324,000	321,000	7%	8%	8%

Numri Nxenesve AB+AML + femijeve kopshte publike.	422,705	400,581	380,066	380,066	374,000	370,000			
Kosto mesatar vjetore parashikuar / nxenes ne leke	70,474	76,179	85,962	87,672	89,875	91,547			

Për periudhën 2023-2025, Produktet/aktivitetet/shërbimet që janë parashikuar të financohen me përparësi në arsimin parauniversitar nga shpenzimet korrente (artikujt buxhetore 602-606) janë:

- *Shërbimi i Transportit* për 44 300 nxënës që kanë vendbanimi mbi 2 km nga shkolla si dhe transportin për rreth 12 mijë mësues që punojnë mbi 5 Km nga vendbanimi/qendra e përhershme e punës në shkollë, konform kërkesave të VKM nr. 692, datë 29.7.2015 në shumën rreth 1 miliard 380 milion lekë/vit.
- *Blerja e teksteve shkollore* nxënësit nga klasa e parë në klasën e 9-të me fonde nga buxheti i shtetit, si dhe për nxënësit nga shtresat sociale në nevojë që ndjekin arsimin e mesëm të lartë, në shumën rreth 1 miliard e 250 milion lekë/vit.
- *Bursat ose kuotë ushqimore* të nxënësve me nevoja të veçanta si dhe fëmijëve më me ndikim në uljen e braktisjes shkollore, për rreth 1200 -1500 nxënës të arsimit para-universitar nga shtresat sociale në nevojë, në shumën e parashikuar prej 170 milion lekë/vit.
- *Hartimi i programeve dhe rishikimi i kurrikulës* të arsimit para-universitar për veprimtarinë e ASCAP, me 80-100 milion lekë/vit.
- *Trajnimi çdo vit për 20-25% të punonjësve mësimorë* të arsimit para-universitar, me fond 80 -100 milion lekë/vit.
- *Veprimtaria e Maturës Shtetërore*, provimet e shtetit, si dhe testime kombëtare e ndërkombëtare me fond prej 25 -30 milion lekë/vit.
- *Blerja e dokumentacionit shkollor*, materialeve didaktiko mësimore të arsimit parauniversitar, me fond prej 80-100 milion lekë në vit.
- *Blerja e materialeve* për veprimtaritë e shkollave ku do të aplikohen programi “Arti dhe Zejet” me rreth 100 milion lekë/vit; ku përfshihen vegla muzikore për shkollat artistike, materiale didaktike për praktika mësimore në fushën e zejeve dhe bujqësisë si dhe materiale sportive.

Produktet/aktivitetet/shërbimet që janë parashikuar të mbulohen për periudhën 2023-2025, në arsimin parauniversitar nga shpenzimet kapitale/investimet (artikujt 230-231) *për periudhën 3-vjeçare 2023-2025*, parashikohet të financohet rreth 8 miliard e 597 milion lekë, ku prioritet në financim do të kenë;

- Projektet “për Ndërtime të reja” dhe “Rikonstruksione”, rindërtime/shtesa në objektet ekzistuese, ku parashikohen të financohen 1.7 miliard lek/vit (rreth 5.2 miliard lekë në tre vitet e PBA-së 2023-2025) për rreth 120-150 objekte arsimore, 1200-1500 klasa dhe laboratorë mësimore, ku parashikohet të përfitojnë 25,000- 30,000 nxënës dhe 2500-3000 mësues dhe edukatorë. Përparësi në financim kanë 20 objekte të cilat kanë filluar punimet në vitin 2022 dhe me cikël financimi 2022-2023, dhe vlera që do financohet nga MAS për këto objekte për vitin 2023 është rreth 1,2 miliard lek ndërsa 450 milion lekë është parashikuar bashkëfinancimi nga NJVQV. Në këtë zë, përfshihet edhe kontributi vjetor i ministrisë së arsimit dhe sportit me 350 milion lek/vit në programin e përbashkët me Bashkinë e Tiranës për shkollat e ndërtura me PPP.
- Blerje “Pajisje shkollore” për shkollat e reja dhe të rehabilituara, për pajisjen e klasave në arsimin parashkollor si dhe në arsimin 9-vjeçar, për rreth 80-100 objekte shkollore me 1200-1500 klasa/laboratorë mësimorë, me vlerë financimi rreth 200 milion lek/vit ose 600 milion lekë për tre vjet, ku parashikohet të përfitojnë rreth 25,000-30,000 nxënës dhe 2500-3000 punonjës mësimorë.

- Blerje pajisje elektronike kompjuter, laptop, janë parashikuar të furnizohen 180-200 objekte shkollore klasa/laboratorë mësimorë me vlerë financimi 320 milion lekë/vit ose 950 milion lekë për tre vjet, ku parashikohet të përfitojnë rreth 40,000 nxënës dhe 3000-3500 punonjës mësimorë.
- Blerje pajisje didaktiko-mësimore për “fizike, kimi, biologjie”, janë parashikuar 160 milion lekë/vit për financimin e 120-150 klasa/laboratorë mësimorë me vlerë financimi 480 milion lekë për tre vitet e PBA 2023-2025, ku parashikohet të përfitojnë rreth 25,000-30,000 nxënës dhe 2500-3000 punonjës mësimorë.
- Blerje libri artistik “Për krijimin e fondit të bibliotekave shkollore”, për rritjen e mundësisë dhe aksesit të fëmijëve e sidomos të fëmijëve nga shtresat sociale në nevojë, janë parashikuar 75 milion lekë për periudhën 2023-2025, me financim çdo vit me rreth 25 milion lek/vit, ku parashikohet të përfitojnë 25,000- 30,000 nxënës dhe punonjës mësimorë të arsimit parauniversitar.

Në fonde për investime në arsimin parauniversitar për periudhën 2021-2025, nuk janë përfshirë fondet e ndërhyrjeve emergjente, për rindërtimin e 167 objekteve arsimore për pasojave nga tërmeti i 26 Nëntorit 2019, në qarkun Tiranë, Durrës dhe Lezhë, fonde të cilat janë miratuar, administrohen dhe menaxhohen nga Ministria e Shtetit për Rindërtimin, si dhe drejtpërdrejt nga Organizat dhe donatorë të tjerë.

Fondet e Rindërtimit për investime ne sektorin e arsimit;

Në arsimin për periudhën 2021-2024, janë parashikuar rreth 70 milion euro me burim financimin nga buxheti i shtetit si dhe nga donatorët, nga fondi për rindërtim ndërhyrje emergjente, pas pasojave të tërmetit të 26 Nëntorit 2019, për rindërtimin e afro 167 objekteve arsimore në qarkun Tiranë, Durrës dhe Lezhë, fonde të cilat janë miratuar, administrohen dhe menaxhohen pranë Ministrisë të Shtetit për Rindërtimin.

Ndërkohë janë 167 shkolla, duke përfunduar rindërtimi në harkun e një viti e gjysëm.

- Fondi Shqiptar i Zhvillimit - janë planifikuar 38 objekte arsimore ku vetëm Bashkia Tirane përfiton financim në 18 objekte arsimore, ndërkohë, në programin e infrastrukturës ka filluar puna për rindërtimin e infrastrukturës së dëmtuar në 4 zona, Fushë- Krujë; Thumanë; Kavajë; Bubq. (*Vendim nr.212, datë 11.3.2020 i Këshillit të Ministrave “Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të objekteve arsimore”).
- EU4 Schools (programi 1), **Komisioni European**: janë angazhuar 15 milionë euro, për 22 objekte arsimore që është pjesa e 15 milionë eurove, 22 objekte i ka filluar UNDP, pjesë e angazhimit të Komisionit European. <https://rindertimi.gov.al/lajme/nenshkruhet-kontrata-e-pare-per-rindertimin-e-shkollave-be-dhe-undp-perzgjedhin-22-objekte-ne-5-bashki/>.
- EU4Schools (programi 2) - 54 objekte, që sërish do të prokurohen nga UNDP si agjenci e besuar e Komisionit European.
- **Gjermania**: 11 milionë euro të angazhuar në sektorin e arsimit. Janë përzgjedhur tre shkolla në dy bashki: Sulejman Elezi (Kamëz); Hillary Clinton (Kamëz); Rexhep Mezini (Durrës). Projekti zbatohet nga KFW.
- TOKI i Turqisë ka 1 objekt arsimor, shkollën 9-vjecare, në bashkinë Kurbin.
- Katari ka 3 objekte arsimore, me 4,6 milionë euro që do të angazhohen në sektorin e arsimit. Janë përzgjedhur tre shkolla në Tiranë: 15 shtatori (Pezë e Madhe); Lasgush, Poradeci; Kopshti nr. 42. Zbatimi do të bëhet nga vetë Fondi i Katarit në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë;

- **Slovenia:** ka 1 objekt arsimor 300 mijë euro. Do të angazhohet në sektorin e arsimit, shkolla 9-vjecare në Nuaje, Krujë. Zbatimi nga pala sllovene dhe Bashkia Krujë;
- **Slovakia:** 250 mijë euro, në sektorin e arsimit. Janë përzgjedhur për rikonstrukcion 3 shkolla në dy bashki, Tiranë dhe Lezhë: Shkolla 9-vjecare Pezë-Helmës; Shkolla 9-vjecare Kallmet, Lezhë; Shkolla 9-vjecare Manat, Lezhë. Zbatimi nga FSHZH dhe Bashkia Tiranë.

Programet e “Arsimit Bazë” dhe “Arsimit të Mesëm” jepen të detajuara sa më poshtë:

ARSIMI PROFESIONAL DHE PUNËSIMI.

Buxheti i planifikuar për Programin e Arsimit të mesëm profesional, për vitin 2022 është 3 miliard e 63 milion lekë.

Politika e këtij programi: synon të përmbushë qëllimin e Strategjisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi e 2019-2022 dhe planit të saj të veprimit, të identifikojë dhe hartojë politikat e duhura për punësimin, arsimin dhe formimin profesional, në mënyrë që të krijojë vende pune dhe mundësi cilësore për punësim dhe aftësi përgjatë gjithë ciklit të jetës

Programi synon zhvillimin e një sistemi të arsimit dhe formimit profesional, i cili garanton arsim dhe formim profesional cilësor dhe gjithëpërfshirës nëpërmjet:

- Sigurimit të një procesi mësimor cilësor e me kushte optimale të të nxënësve, teorik e praktik për t'i pajisur nxënësve me kompetencat e duhura;
- Ndërtimit, rikonstrukcionit dhe paisjes me laboratorë/makineri, të shkollave dhe repartëve të praktikave profesionale si një nga prioritetet dhe në programin e qeverisë Shqipëria 2030 për arsimin profesional;
- Rishikimit të programeve ekzistuese dhe hartimit të programeve të reja në përputhje me parimet e barazisë gjinore dhe të gjithëpërfshirjes, në zbatim të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve;
- Hartimit dhe miratimit të standarteve të profesioneve dhe kualifikimeve sipas niveleve të KSHK;
- Zhvillimit të vazhdueshëm profesional të mësuesve, si një nga shtyllat kryesore të sigurimit të cilësisë në arsimin profesional;
- Fillimit të implementimit të akreditimit të ofruesve të AFP-së;
- Funkcionimit të komitetit sektorial të TIK;
- Ngritjes dhe funksionimit të strukturës së Inspeksionit të Arsimit Profesional;
- Modernizimit të kuadrit ligjor të AFP ekzistues, që rregullojnë sistemin e AFP-së, si dhe aspektet që kanë të bëjnë me AFP-në (hartimi i skeletkurrikulave, materialeve mësimore, trajnimi i mësuesve, etj.) në zbatim të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.

Treguesit e Performancës për buxhetin 2022

- Rritja e numrit të të punësuarve pas diplomimit në shkollat e mesme profesionale në 46% të totalit që mbarojnë studimet në vitin 2022, krahasuar me 42% në vitin 2020;
- Rritja e numrit të nxënësve që vijnë nga zonat rurale të cilët ndjekin studimet në shkollat e mesme profesionale, nga 43% e totalit në vitin 2020 në 55% e totalit në vitin 2022;
- Rritja e numrit të nxënësve që ndjekin studimet në shkollat e mesme profesionale, në 19.5% të totalit të nxënësve që ndjekin arsimin parauniversitar në vitin 2022, krahasuar me 17% në vitin 2020;

Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor

Për financimin e veprimtarisë në IAL-të publike “Arsimi i Lartë” dhe të “Kërkimit Shkencor” për periudhën 2023-2025, janë planifikuar fonde me burim financimi buxhetin e shtetit, në shumën totale 39,1 miliardë lekë, ose rreth 13 miliard lek në vit.

Për vitin 2023 financimi është planifikuar në shumën totale **12,6 miliard lek**, nga të cilat 10,8 miliardë lek janë *janë në grupin e shpenzimeve korrente dhe 1.73 miliard lekë janë në grupin e shpenzimeve kapitale*).

Buxheti i “Arsimit të lartë” dhe “Kërkimit Shkencor” (pa përfshirë fondet jashtë buxhetore) për vitin 2023, kompozohet si më poshtë:

- 20,1 milion leke janë shpenzime personeli për Agjensitë e Arsimit të lartë & Kërkimit shkencor;
- 10 miliard e 860 milion lek janë shpenzime korrente/operative (602-606);
- 1 miliard e 730 milion lekë janë shpenzime kapitale, nga të cilat 1 miliard e 130 milion me financim të brendshëm dhe 600 milion me financim të huaj.

Për vitin 2023, Fondet e planifikuara për “*Arsimin e Lartë*” dhe “*Kërkimin Shkencor*” zënë:

- **26,7% e fondeve totale të MAS;**
- **0,6% ndaj PBB-së;**
- **1,84% ndaj shpenzimeve publike.**

Buxheti 2023 për programet “Arsimi i Lartë” dhe “Kërkimi shkencor” ka shënuar një rritje totale prej 9,2% ose 1 miliard e 58 milion lekë krahasuar me buxhetin 2022, rritje e cila është orientuar kryesisht në shpenzimet korrente (fondet grand me financim të brendshëm në shumën 884 milion lekë dhe 300 milion lekë shpenzime kapitale/financimi i huaj). Konkretisht,

- Programi i “Arsimit të Lartë” është rritur në total në masën 774 milion lek ose 7,2% krahasuar me vitin 2022, nga të cilat 100 milion lekë është shtesë financimi i huaj;
- Programi i “Kërkimit Shkencor” është rritur me 284,74 milion lek ose 38,2% krahasuar me vitin 2022, nga të cilat 200 milion lekë është shtuar financimi i huaj;

Rritja e buxhetit 2023 do të orientohet për të financuar shtesën e pagave me 7% të personelit akademik të IAL-ve publike, financimin e projekteve të ndërkombëtarizimit dhe studentëve në degët prioritare dhe ekselente të arsimit të lartë në Shqipëri si dhe të projekteve të kërkimit shkencor.

Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm janë ulur me 126 milion lek.

Për vitin 2024 fondet arrijnë

- 27,3% e fondeve totale të MAS;
- 0,6% ndaj PBB-së;
- 1,9% ndaj shpenzimeve publike.

Për vitin 2025 fondet arrijnë

- 27,5% e fondeve totale të MAS;
- 0,6% ndaj PBB-së;
- 1,8% ndaj shpenzimeve publike.

Tabela 5. Fondet e buxhetit të miratuara për vitin 2020-2022 dhe tavanet për periudhën 2023-2025, në 000/lekë e në %, Arsimi i Larte (09450) dhe Kerkim Shkencor 09770

Emri i Programit	ARSIMI I LARTE + KERKIM SHKENCOR dhe EKSELENCE								
	Buxheti rishikuar 2020	Fondet miratuara "Për Buxhetin e vitit 2021"	Tavanet miratuar ligji nr.115/2021	Tavanet miratuar projektligjin tetor 2022					
Artikujt	.			2023	2024	2025	2023/2022	2022/2021	2025/2024
Paga (600-601)	20,160	20,160	20,160	20,160	20,160	20,160	0.0%	0.0%	0.0%
Korente të Tjera (602-606)	9,899,264	9,359,840	9,976,080	10,860,840	10,961,840	11,211,840	8.9%	0.9%	2.3%
Kapitale (230-232) Të Brendshme	485,672	1,021,600	1,256,000	1,130,000	1,530,000	1,580,000	-10.0%	35.4%	3.3%
Kapitale (230-232) Të Huaja	300,000	200,000	300,000	600,000	600,000	600,000			
Jashtë-buxhetore									
Totali	10,705,096	10,601,600	11,552,240	12,611,000	13,112,000	13,412,000	9.2%	4.0%	2.3%
Strukt ndaj totalit buxh MAS	25.8%	24.7%	25.4%	26.7%	27.3%	27.5%			0
Ne % ndaj GDP, Sipas sipas VKM Treguesit Fiskale 2018-2025	0.7%	0.6%	0.6%	0.6%	0.6%	0.6%			
Ne % ndaj shpenzimeve publike, Sipas sipas VKM Treguesit Fiskale 2018-2026	2.0%	1.8%	1.7%	1.8%	1.9%	1.8%			
TOTALI Jashtë-buxhetore _Kap 06	3,050,000	3,350,000	2,700,000	3,100,000	3,330,000	3,450,000			

TOTALI Buxheti +Te Ardhura e IAL	13,755,096	13,951,600	14,252,240	15,711,000	16,442,000	16,862,000	1,759,400		
Kosto mesatar vjetor/ student ne lekë	131,248	143,258	148,461	163,656	174,915	179,383	0	0	0
Numri Total I studenteve në tre ciklet të studimeve në IAL publike	104,802	97,388	96,000	96,000	94,000	94,000			
Strukt ndaj totalit buxh MAS	24.0%	21.6%	21.8%	22.9%	22.7%	22.2%			
Ne % ndaj GDP, Sipas sipas p.ligjit treguedit fiskale	0.8%	0.7%	0.7%	0.7%	0.7%	0.7%			
Ne % ndaj shpenzimeve publike, Sipas sipas VKM Treguesit Fiskale 2018-2026	2.6%	2.3%	2.2%	2.3%	2.4%	2.3%			

Produktet/aktivitetet/shërbimet që janë parashikuar të mbulohen për periudhën 2023-2025, në “Arsimin e Lartë” dhe “Kërkimin Shkencor” nga **shpenzimet korrente** (artikujt buxhetore 602-606) janë:

- **Shpenzime korrente pjesë e fondeve grant** për IAL publike për vitin 2023-2025, është planifikuar 10,8 miliard lekë në vitin 2023, në 10,9 miliard në vitin 2024, dhe 11.2 miliard në vitin 2025, ku pjesa më të madhe fondeve janë “**grant për mësidhënie**”, ku shpenzimet e personelit në IAL publike parashikohet të arrijnë në shumën 8.5 deri 8.8 miliard lekë.
- Shpenzimet për mbulimin e **bursave financiare për studentët** në kuadrin e “Paktit për Universitet”, si dhe akomodimin e studenteve në shtëpiat e trajtimit të studentëve parashikohen me rreth 1 miliard e 50 milion lekë në vit, ku përfitues parashikohen të jenë 11.5-12 mijë studentë. Ky fond u jep mundësinë financiare rreth 12 000 studentëve për të ndjekur studimet në institucionet publike të arsimit të lartë, në një program të ciklit të parë, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, kategori të caktuara të studentëve sipas rezultateve dhe studentëve nga kategoritë sociale në nevojë, të cilët nuk kanë mundësi financiare për të përballuar një pjesë të kostos të studimeve kostot e shkollimit, sipas kriterëve të përcaktuara në Vendimin nr. 903, datë 21.12.2016 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë” i ndryshuar.
- Fonde grant, për të mbuluar shpenzimet e studentëve **për akomodimin e studentëve** në “Shoqëritë e Trajtimit të studentëve në Tiranë dhe në Rrethe”, për periudhën 2023-2025 janë parashikuar të akomodohet rreth 6 mijë studentë, me një fond vjetor mbështetje financiare prej 250 milion lekë në vit.
- Fondet për mbulimin e **bursave financiare për studentët ekselencë** (studentet e ndermjetem), që ndjekin studimet në 15 universitetet më të mira, referuar renditjes së “Times Higher Education”, si dhe punonjësve të administratës publike, të cilët përfitojnë trajnime/kualifikime apo studime të ciklit të dytë dhe tretë në 300 universitet më të mira të botës; parashikimi është për vitin 2023 të financohen **50 milion lek.**
- Fonde grant, për të mbuluar shpenzimet e studentëve sipas VKM nr.396, datë 01.06.2022 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e fushave dhe programeve të **studimit që përbëjnë prioritet kombëtar dhe mbështetjen fianciare të studentëve të shkëlqyer**, e studentëve që ndjekin këto programe në institucionet publike të arsimit të lartë”, në shumën prej 150 milion lekë;
- **Fonde për pjesëmarrjen në marrëveshjen kuadër “Horizon Evropë”,** fonde për pjesëmarrjen në marrëveshjen kuadër, ERASMUS+ , është parashikuar pagesa për kuota anëtarësie si tranferta ndërkombëtare shuma prej 160 milion lekë në vit, nga të cilat janë parashikuar të paguhet me fonde grand nga buxheti shuma prej 100 milion lekë në vit dhe diferenca nga të ardhurat e rimbursuara nga Komisioni Evropian.

Produktet/aktivitetet/shërbimet që janë parashikuar të mbulohen për periudhën 2023-2025, në “Arsimin e Lartë” dhe “Kërkimin Shkencor” nga **shpenzimet kapitale** (artikujt buxhetore 230-231) janë:

- **Investimet kapitale** në godinat universitare do të vijojnë edhe në periudhën 2023-2025, për të financuar projektet e infrastrukturës së IAL publike, 2 projekte në vazhdim dhe 4 projekte të reja, në shumën totale 2,5 miliardë lek. Financimi për vitin 2023 është planifikuar 643 milion lekë dhe 20 milion lekë është financim TVSH për projekte të IAL publike.
- Investime kapitale në kuadër të **projekteve të ndërkombëtarizimit** parashikohen në shumën 878 milion lekë për periudhën 2023-2025 dhe financimi për vitin 2023 është 216 milion lekë.
 - Me këto fonde do të financohen shpenzimet kapitale për rreth 15 projekte të IAL ve publike e paralelisht ato do të përfitojnë edhe fonde korrente për përballimin e shpenzimeve për honoraret e stafit të huaj akademik dhe shkëmbimet e studentëve apo bursa studentësh për projektet e përbashkëta.
- **Investimet në laboratorët kërkimorë shkencorë** për IAL-të publike për periudhën 2023-2025 janë parashikuar 750 milion lekë, me financim vjetor 250 milion lek, ku parashikohet të financohen rreth 15-20 projekte të univeriteteve publike. Përparësi në financim do të kenë projektet në vazhdim të cilat janë miratuar në vitin 2022 dhe mund të mos kenë arritur të përmbyllim zbatimin e kontratave për arsye objektive apo që lidhen me procedurat e prokurimit publik.

Programi për sportin

Ky program siguron dhe mbron të drejtat e shtetasve që merren me edukim fizik dhe sport, në përputhje me Kartën Evropiane të Sportit dhe me rekomandimet e organizatave ndërkombëtare në këtë fushë. Ridimensionimi i edukimit fizik dhe sportiv si pjesë përbërëse e programit të edukimit të nxënësve dhe studentëve në institucionet arsimore dhe rishikimi dhe zbatimi i politikave në fushën e sportit, synon sigurimin e një shërbimi cilësor nëpërmjet sportit elitare dhe sportit në institucionet arsimore dhe forcimin e statusit të të rinjve shqiptarë në të gjitha fushat e jetës si; edukim, punësim, familje, shëndetësi, mjedis, mbrojtje sociale, drejtësi.

Edukimi nëpërmjet sportit si një faktor efikas në përmirësimin e shëndetit e të mirëqenies për qytetaret dhe mbrojtja, stimulimi dhe promovimi i arritjeve sportive, ka si synim masivizimin dhe përmirësimin cilësor të sportit, krijimin e shanseve të barabarta dhe kushteve për pjesëmarrjen në aktivitete sportive të të gjithë shtetasve shqiptar mbështetur në të drejtat e njeriut për të ushtruar aktivitet fizik e sportiv, duke krijuar infrastrukturën e duhur ligjore, financiare dhe fizike si dhe rregullimin e marrëdhënieve shtet-institucione sportive.

Objektivat e programit:

- **Objektiv 1.** Sigurimi i mbështetjes financiare për federatat Olimpikë në aktivitete, Evropiane, Botërore, Ballkanike në funksion të kualifikimeve për Lojërat Olimpikë Paris 2024, realizimi i 30-35 analizave antidoping për sportistët elitare si dhe ato kandidat për Lojërat Olimpikë Pekin 2022, si dhe Paris 2024.
- **Objektiv 2.** Mbështetja financiare për Ekipin Kombëtar Olimpik pjesëmarrës në Lojërat e Olimpikë si dhe aktivitetet kombëtare dhe ndërkombëtare për Federatat Sportive, në të gjithat disiplinat sportive, sipas kalendarëve të aktiviteteve në 42 Kampionate Kombëtare, 42 Kupa Shqipërisë, 42 Kampionate Evropiane, si dhe 42 Kampionate Botërore, në përputhje me parimet e barazisë gjinore.

- Objekti 3. Mbështetja financiare me investime në sport, për ndërtimin/rindërtimin e objekteve sportive, pajisjes me bazë materiale të tyre në funksion të ekipeve kombëtare.
- Objekti 4. Zhvillimi i programeve trajnuese në sistemin sportiv kombëtar në funksion të rritjes së kapaciteteve në fushën e sportit, trajnime çdo vit për 20-25% e stafet teknike të sistemit sportiv kombëtar (732 teknike-trajnerë, specialistë, instruktorë, mjekë etj, ku përparësi kanë sportistët dhe trajnerët femra).
- Objekti 5. Rritja e mbështetjes financiare për shpërblimin e sportistëve elitari, fitues në aktivitete ndërkombëtare, mbështetje financiare për 25-30 sportistë elitari në vit si dhe trajnerët e tyre, si dhe mbështetje financiare për aktivitete sportive promovuese dhe garuese në institucionet arsimore të arsimit parauniversitar dhe universitar.

Fondet e planifikuara në programin e sportit për periudhën 2023-2025 janë në shumën 1.739 miliard lekë nga të cilat;

- Për vitin 2023, janë parashikuar fondet në shumën prej 446 milion lekë, pra një shtesë prej 33 milion, ose 7.8% më shumë ndaj vitit 2022; fondet e miratuara për vitin 2023 arrijnë 0.95% e fondeve të parashikuara për MAS, në masën 0.07% ndaj shpenzimeve publike, si dhe ndaj PBB në masën 0.02%.
- Për vitin 2024, janë parashikuar në shumën prej 596 milion lekë, pra një shtesë prej 150 milion, ose 33,7% më shumë ndaj vitit 2023; fondet e miratuara për vitin 2024 arrijnë 1,24% e fondeve të parashikuara për MAS, në masën 0.03% ndaj shpenzimeve publike, si dhe në masën 0.09% ndaj PBB.
- *Për vitin 2025*, janë parashikuar në shumën prej 696.5 milion lekë, pra një shtesë prej 100 milion, ose 16.8% më shumë ndaj vitit 2024; fondet e miratuara për vitin 2025 arrijnë 1.43% e fondeve të parashikuara për MAS, në masën 0.1% ndaj shpenzimeve publike, si dhe ndaj PBB në masën 0.03%.

Tab nr. 6 Fondet të Programit Buxhetor “Zhvillimin e Sportit 08140”, për vitin 2020-2021, tavanet për periudhën 2023-2025 në 000 lekë si dhe në %.

Programi i SPORTIT dhe RINISE										
Emri i Programit	Programi i SPORTIT dhe RINISE									
	Buxheti faktik 2019	Buxheti rishikuar 2020	Fondet e Buxhetin e vitit 2021	Fondete buxhetit e vitit 2022			Tavanet miratuar VKM nr.535, date 29.7.2022			
Artikujt					2023	2024	2025	2023/2022	2024/2023	2025/2024
Paga (600-601)	41,792	42,590	52,600	28,930	28,930	28,930	28,930	0.0%	0.0%	0.0%
Korente të Tjera (602-606)	156,070	177,510	768,400	94,740	247,070	247,570	347,570	160.8%	0.2%	40.4%
Kapitale (230-232) Të Brendshme	249,764	14,200	300,000	270,000	150,000	300,000	300,000	-44.4%	100.0%	0.0%
Kapitale (230-232) Të Huaja	0	14,000	0	20,000	20,000	20,000	20,000	0.0%	0.0%	0.0%
Jashtë-buxhetore	1,156.7	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0			
Totali	448,782	248,300	1,121,000	413,670	446,000	596,500	696,500	7.8%	33.7%	16.8%
Strukt ndaj totalit buxh MAS	1.12%	0.60%	2.61%	0.91%	0.95%	1.24%	1.43%	2025/2022		68%
Ne % ndaj GDP	0.03%	0.02%	0.06%	0.02%	0.02%	0.03%	0.03%	55%	42%	50%
Ne % ndaj shpenz publike	0.09%	0.05%	0.18%	0.06%	0.06%	0.09%	0.10%	34%	50%	43%

Për periudhën 2023-2025, me fondet e planifikuara sigurohet mbështetja financiare/ndihmë shtetërore me fonde grant për 246-347 milion lekë në vit, për rreth 25 federatave sportive olimpike dhe jo-olimpike, shpërblimin e sportistëve me rezultate kombëtare dhe ndërkombëtare, shpërblime dhe çmime për sportistet elitar, ku për vitin 2023, janë parashikuar në formën e transfertës së pakushtëzuar 246 milion lekë, të detajuara sipas aktiviteteve sa vijon:

- Sigurimi i mbështetjes financiare për federatat Olimpikë në aktivitete, Evropiane, Botërore , Ballkanike në funksion të kualifikimeve për Lojërat Olimpikë Pekin 2022, si dhe Paris 2024, realizimi i 30-35 analizave antidoping për sportistet elitar si dhe ato kandidat për Lojërat Olimpikë me rreth 160 milion lekë
- Mbështetja financiare për Ekipin Kombëtar Olimpik pjesëmarrës në Lojërat e Olimpikë Japoni 2021 si dhe aktivitetet kombëtare dhe ndërkombëtare për Federatat Sportive, në të gjithat disiplinat sportive, sipas kalendarëve të aktiviteteve në 42 Kampionate Kombëtare, 42 Kupa Shqipërisë, 42 Kampionate Evropiane, si dhe 42 Kampionate Botërore, në përputhje me parimet e barazisë gjinore 20 milion lekë
- Zhvillimi i programeve trajnuese në sistemin sportiv kombëtar në funksion të rritjes së kapaciteteve në fushën e sportit, trajnime çdo vit për 20-25% e stafet teknike të sistemit sportiv kombëtar (732 teknike-trainerë, specialistë, instruktorë, mjekë etj, ku përparësi kanë sportistet dhe trajnerët femra) 1 milion lekë
- Mbështetje financiare për shpërblimin e sportistëve elitar, fitues në aktivitete ndërkombëtare, mbështetje financiare për 20-25 sportistë elitarë në vit, si dhe mbështetje financiare për aktivitete sportive promovuese dhe garuese në institucionet arsimore të arsimit parauniversitar dhe universitar 35 milion lekë.
- Mbështetje financiare, për veprimtarinë e Agjencinë e Sporti “Sigurimi i mbështetjes financiare për organizimin e aktiviteteve kombëtare dhe ndërkombëtare”, me 30 milion lekë në vit.
- Mbështetja financiare me investime në sport, për ndërtimin/rindërtimin e objekteve sportive, pajisje me bazë materiale të tyre në funksion të ekipeve kombëtare, ku vetëm për vitin 2023-2025, janë parashikuar në formën e investimeve direkte 150 milion lekë.
- Financim i huaj për projekte në sport projekti “Be Active +” projekte të tjera në sport dhe projekte rinore, me 20 milion lekë.
- Sigurimi i mbështetjes financiare të aktiviteteve sportive promovuese me shkollat e arsimit prauniversitar dhe të IAL në kuadër të nismës së Komisionit Evropian BE-Activ (si rishikim politikash)
- Në zbatim të Vendimit nr. 523, datë 22.09.2021 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit”, si dhe parashikimi “Rritja e numrit të Analizave antidoping në kuadër të plotësimit të standardeve të Kodit WADA, Agjencia Botërore Antidoping, si dhe dispozitave ligjore të përcaktuara në Konventat Ndërkombëtare kundër dopingut në sport, të ratifikuara nga Kuvendi i Shqipërisë si dhe angazhimet e MAS në mbledhjen e online të organizuar nga Ministri i Arsimit dhe Sportit me aktorët kombëtar dhe ndërkombëtar në datën 07 Maj 2021, për përmbushjen e standardeve do të realizohen 50 analiza nga 30 analiza që janë kryer deri tani.
- Edhe në vitin 2023 do të vijojë projekti Ekipet Sportive 2022, i cili është mbështetur nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave me 500 milion lekë financim, projekt icili do të fillojë të

implementohet në shkollat publike, për disiplinat volejboll e basketboll me synim për tu zgjeruar edhe në disiplina të tjera.

Buxheti për Ministrinë e Shtetit për Rininë dhe Fëmijet

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, bazuar mbi VKM nr. 524 dt 22.09.2021 “Për Përcaktimin e Fushës së Përgjegjësisë Shtetërore të Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët” harton dhe zbaton politika që synojnë mbrojtjen e të drejtave të të rinjve, garantimin e pjesëmarrjes së të rinjve në jetën sociale dhe koordinimin e çështjeve që kanë të bëjnë me mbrojtjen, perkujdesjen, shëndetin, mirërritjen dhe mirëedukimin e fëmijëve.

II. MBËSHTETJA PËR RININË-AGJENCIA KOMBËTARE E RINISË

Në projekt buxhetin e vitit 2023 janë planifikuar **162, 960, 000 lekë si mbështetje për rininë**, përkatësisht në zërin 08610 të “Buxhetit 2023” sipas Ministrive të linjës dhe Institucioneve buxhetore, me një rritje krahasuar me buxhetin e vitit 2022, 161,370,000.

Më poshtë gjeni analizën e shpenzimeve korrente dhe kapitale, të ndara sipas aktivitetit:

Shpenzime korrente në shumën 112,960,000 lekë sipas kategorive në vijim:

- e) Mbështetje financiare, për veprimtarinë e Agjencisë Kombëtare të Rinisë dhe të programit kombëtar të praktikave të të rinjve.
- f) Realizimi i aktiviteteve mbi lidhshmërinë rinor, pjesëmarrjen në vendimmarrje, punësimin, kreativitetin dhe edukimin joformal, informimin e të rinjve, shkëmbimin e informacionit dhe pjesëmarrjen në zbatim të planit kombëtar të Veprimit për Rininë, përfshirë thirrjen e tretë për projektpropozime për rininë.
- g) Pagesë për kuotën e anëtarësimit në Organizatën Rinore të Ballkanit Perëndimor (RYCO)¹, me synim rritja e pjesëmarrjes së të rinjve në aktivitete me karakter social-kulturor dhe edukativ, rritja e pjesëmarrjes/ mbështetjes financiare të organizatave rinore në projekteve rajonale dhe të BE (RYCO, ERAZMUS +, etj).
- h) Grante për projektpropozime nga organizatat rinore dhe ose për të rinjtë në kuadër të thirrjes së tretë për projektpropozime për rininë.

Shpenzime kapitale: 50,000,000 lekë

Mbështetja me investime për ristrukturimin/ ndërtimin dhe pajisjen e objekteve për rininë, si qendra rinore, biblioteka apo hapësira për të rinjtë në shumën 50 milion lekë të financuara nga buxheti i shtetit, ku parashikohet të mbështeten disa bashki.

Zërat specifikë

Kodi buxhetor /Ministri i linjës	Institucioni	Emri i Institucionit	Llogaria Ekonomike	Shuma 2023
86	1087039	Agjencia Kombëtare e Rinisë	600	21,100,000

86	1087039	Agjencia Kombëtare e Rinisë	601	3,530,000
86	1087039	Agjencia Kombëtare e Rinisë	602	7,230,000
86	1087039	Agjencia Kombëtare e Rinisë	604	60,700,000
86	1087039	Agjencia Kombëtare e Rinisë	605	20,400,000
86	1087039	Agjencia Kombëtare e Rinisë	231	50,000,000

TOTAL	162,960,000
TOTAL	
Shpenzime.	
Korrente	112,960,000

Nga thirrja e parë për rininë janë financuar 12 projekte të organiztave rinore/për të rinjtë dhe 4 projekte të infrastrukturës rinore në 4 bashki në vlerën totale 48 milionë lekë (buxheti 2021).

Nga thirrja e dytë për rininë pritet të financohen mbi 20 projekt propozime rinore të organiztave rinore/për të rinjtë dhe 5 projekte të infrastrukturës rinore në 5 bashki në vlerën totale 108 milionë lekë (buxheti 2022) dhe do të vijohet në po të njejtat linja edhe për vitin 2023.

III. STRATEGJIA KOMBËTARE E RINISË 2022-2029

Bazuar në germën a, të nenit 5, të ligjit nr. 75/2019 “Për rininë”, Ministria përgjegjëse për rininë harton dhe propozon bazën ligjore, politikat, programet, strategjitë dhe veprimtaritë për rininë;

Me urdhër të Kryeministrit, u ngrit Grupi Ndërinstitucional i Punës i kryesuar nga MSHRF dhe me përbërje nga institucionet shtetërore kyçe dhe partnerët e huaj për zhvillim që veprojnë në fushën e rinisë, me përgjegjësi për: Hartimin e draft-Strategjisë Kombëtare për Rininë 2022 - 2029, në përputhje me udhëzimet e dhëna nga Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes në Kryeministri dhe legjislacioni në fuqi.

Ditën e djeshme, dt 26.10.2022, me vendim të Këshillit të Ministrave, është miratuar Strategjia Kombëtare të Rinisë 2022-2029 së bashku me planin e veprimit sipas parashikimit në PPAP 2022.

Dokumenti i Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022-2029 përfshin 3 qëllime, 9 objektiva specifike, dhe një sërë masash dhe aktivitete, i cili është konsultuar me të gjitha palët e interesit si dhe rakorduar me rreth 20 institucione shtetërore.

Konkretisht qëllimet politike janë:

Qëllimi i Politikës 1: Të rehat dhe të rinjtë marrin pjesë aktivisht në shoqëri dhe ndihen të fuqizuar për t'u shprehur me zërin e tyre. Politikat ndërsektoriale rimore janë të koordinuara, të bazuara në analiza, me mekanizma të mirë financiar.

Qëllimi i politikës 2: Mbështetet dhe nxitet novacioni rinor dhe rritja e aftësive dhe profesionalizmit të të rejave dhe të rinjve përmes edukimit cilësor në TIK dhe fusha të tjera të zhvillimit digjital duke rritur dhe përmirësuar kështu mundësitë për të hyrë në tregun e punës;

Qëllimi i politikës 3: Mirëqenia aktive, e shëndetshme, fizike, sociale dhe mendore e të rinjve. Siguria, mbrojtja dhe përfshirja e të rinjve në të gjithë diversitetin e tyre, veçanërisht për ata të rinj që janë në situatë rreziku apo mënjanimi social (vulnerabiliteti).

Në vitin 2022, kanë filluar zbatimin disa nga masat dhe aktivitete e parashikuara në Strategji si:

1. Thirrja për projekt propozime rimore.
2. Forcimi I kapaciteteve të AKR nëpërmjet programeve të trajnimit nga UNDP lidhur me metodologjinë LOD për dhënien e granteve organizatave të shoqërisë civile. Programe të tjera trajnimi nga donatorë si Ambasada Italiane, Palladium Group etj për rritjen e kapaciteteve të stafit të AKR-së.
3. Përgatitja e termave të referencës për ngritjen e databzës rimore
4. Nxitja e ngritjes së KVR-ve (Statusi aktual 42 KVR të ngritura) si dhe aktivitete të fuqizimit të të rinjve të KVR të organizuara në ditën e rinisë me asistencën e UNDP/UNFPA.
5. Ka vijuar puna për ndryshimin e ligjit të vullnetarizmit nëpërmjet grupit të përbashkët të punës me institucione shtetërore si MSHRF, MFE, AKPA dhe organizatave të shoqërisë civile që kanë në fokus përmirësimin e mjedisit të vullnetarizmit në Shqipëri.
6. Programi Kombëtar i Praktikave të punës, thirrja e 7, me 470 praktikantë të cilët po zbatojnë praktikën e punës pranë institucionet shtetërore, organizatat ndërkombëtare dhe bizneset gjatë periudhës shtator-dhjetor 2022.

IV. PROGRAMI I KODIMIT PËR FËMIJËT QË NË KLASË TË I

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, bazuar në fushën e përgjegjësisë, harton, zhvillon dhe monitoron politika për sigurimin e mirëqenies dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së fëmijës, duke promovuar e mundësuar zhvillimin e tyre në shoqëri, ndihmën dhe përkujdesjen efektive për fëmijën. Zhvillimi i kompetencës digjitale vlerësohet si një aftësi e një rëndësie të lartë për tregun e sotshëm të punës dhe zhvillimin e njohurive kompjuterike dhe aftësive të mendimit kritik për fëmijët duke filluar që nga klasa e parë.

Gjatë vitit 2022, MSHRF ka udhëhequr përpjekjet e Qeverisë për të siguruar përgatitjen dhe më pas përfshirjen e lëndës së kodimit që në klasë të parë fillimisht në 100 shkolla të shpërndara në të gjithë qarqet e vendit për vitin mësimor 2022-23 dhe shtrirjen e tij në të gjithë shkollat fillore të vendit brenda 4 vitesh. Aktualisht jemi në fazën e pajisjes së laboratorëve me bazën e duhur materiale dhe ka përfunduar trajnimi i mësuesve të TIK.

Ngritja e 100 laboratorëve për vitin 2022 është mbështetur përmes fondeve të miratuara në buxhetin e vitit 2022 për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, "Për blerje pajisje elektronike, kompjuter, laboratorë TIK për arsimin bazë, si dhe për arsimin e mesëm të lartë, për vitin 2022", në masën 402 (katërqind e dy) milion lek dhe financimin e Fondacionit Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim AADF përmes projektit "ElementIT" në vlerën 435 milionë lekë (3.75 milionë USD) për 5 vite. Kontributi i AADF-së përfshin dhe sigurimin e platformës online për mësimdhënien dhe trajnimin e mësuesve. Ndërkohë që donatorë

të tjerë si UNICEF Albania dhe OSFA janë angazhuar për të dhënë financim për ngritjen e laboratorëve në shkolla të tjera.

V. PROGRAMI I EKIPEVE SPORTIVE

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët ka mbështetur Komitetin Olimpik Kombëtar Shqiptar, Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Bashkive të vendit, në hartimin dhe zbatimin e programit të ekipeve sportive në disiplinat volejboll dhe basketboll për vajza dhe djem, në ciklin e arsimit parauniversitar dhe atë universitar.

Ky projekt po mbështet përfshirjen e rreth 8500 vajza dhe djem, të cilët aktualisht ndjekin studimet në shkollat 9-vjecare, gjimnaze dhe universitete në ekipet e basketbollit dhe volejbollit dhe ka angazhuar rreth 350 trajnerë të këtyre disiplinave që po udhëhqin punën me këto ekipe.

Në kuadër të këtij programi nën drejtimin e KOKSH janë parashikuar të realizohen kampionate në 12 qarqe, dhe kampionate kombëtare në vitin 2023.

Vlera e financimit për këtë program është 500 milionë lekë sipas buxhetit të vitit 2022 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit: Programi “Për sportin”, titulli 08140.

VI. PROGRAMI JASHTËSHKOLLOR PËR FËMIJËT DHE TË RINJTË

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Ministrinë e Kulturës, Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Agjencinë e Sigurimit Cilësor të Arsimit Para universitar, si dhe ekspertizës nga UNICEF Albania ka përgatitur një program për aktivitete jashtë shkollore të cilat do të zbatohen në 230 shkolla në të gjithë vendin, gjatë vitit 2023. Ky program i cili synon të ofrojë kurse jashtë shkollore në 5 disiplina të ndryshme për fëmijët dhe të rinjtë ku përfshihen: artet, zeje, agrikulturë & mjedis, sport, dhe teknologji informacioni.

Programi Kombëtar për aktivitetet jashtë orarit mësimor (IOM) do të financohet përmes fondit prej 276 milion lekësh miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit” sipas VKM nr. 606 datë 14.9.2022 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit Art, Zeje, sport dhe një shtesë në buxhetin e vitit 2022 miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit”.

Buxheti për Ministrinë e Kulturës

Grupi i Menaxhimit Strategjik i Ministrisë së Kulturës pas diskutimeve ka miratuar shpërndarjen e fondeve buxhetore sipas programeve duke mbajtur parasysh politikat dhe objektivat e çdo programi buxhetor. Si pjesë e Programit Buxhetor Afatmesëm, në kuadër të negociatave me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë kërkesat buxhetore sipas zërave të projektbuxhetit të vitit 2023, krahasuar me buxhetin e vitit 2022 paraqiten si më poshtë:

Në lekë

Buxheti sipas zërave	Viti 2022	Viti 2023	Diferenca	%
Paga+Sigurime Shoqerore (600 -601)	962,347,000	1,116,328,000	153,981,000	16.00%
Shpenzime Korente (602-606)	927,413,000	1,044,153,000	116,740,000	12.60%
Mallra dhe Shërbime (602)	241,912,000	250,892,000	8,980,000	3.71%

Shpenzime nga te Ardhurat (602/5)	68,910,000	68,910,000	0	0.00%
Korrente Brendshme (604)	505,800,000	611,786,000	105,986,000	20.95%
Korrente te Huaja (605)	10,611,000	10,641,000	30,000	0.28%
Transferta per Buxhetet Familjare dhe Individet (606)	100,180,000	101,924,000	1,744,000	1.74%
Financim me investim të brendshme (230-231)	2,262,500,000	1,700,000,000	-562,500,000	-24.86%
Financim Huaj	160,000,000	100,000,000	-60,000,000	-37.50%
Shuma	4,312,260,000	3,960,481,000	351,779,000	8.16%

Nisur nga treguesit e mësipërm, projektbuxheti i vitit 2023 krahasuar me buxhetin e vitit 2022 ka një rënie prej 8,16 % ose 351,8 milion lekë.

Gjithashtu sipas tabelës më poshtë prezantojmë tavanet e projekt buxhetit të vitit 2023 krahasuar me buxhetin e vitit 2022 edhe në nivel programi.

në lekë

Buxheti sipas Programeve	Viti 2022	Viti 2023	Diferenca	%
Planifikim, Manaxhim	172,400,000	176,408,000	4,008,000	+2.3
Art & Kulturë	3,424,020,000	3,019,438,000	-404,582,000	-11.8
Trashëgimia Kulturore e Muzetë	715,840,000	764,635,000	48,795,000	+6.8
Shuma	4,312,260,000	3,960,481,000	-351,779,000	-8.16

- Referuar tavaneve të projekt buxhetit për vitin 2023, Ministria e Kulturës paraqet në mënyrë të detajuar planifikimin e shpenzimeve sipas artikujve buxhetor:

-Planifikimi i Shpenzimeve për Paga e Sigurime Shoqërore (llog. 600+601)

Emërtimi	Buxheti-Pagat dhe Sigurimet (600+601)			%
	Buxheti 2022	Buxheti 2023	Diferenca	
Planifikim, Manaxhim	115,200,000	119,108,000	3,908,000	3.4
Trashegimi Kulturore dhe Muzete	300,347,000	318,982,000	18,635,000	6.2
Art & Kulture	546,800,000	678,238,000	131,438,000	24.0
Shuma	962,347,000	1,116,328,000	153,981,000	16.0

Përlllogaritjet për zërin paga e sigurime shoqërore, janë kryer mbështetur në numrin e punonjësve sipas organikes së Ministrisë Kulturës. Për vitin 2023 fondi i pagave është i ndryshëm nga viti 2022, në zbatim të Vendimit nr.475, date 13.07.2022 "Per disa shtesa dhe ndryshime ne Vendimin nr.187,date 08.03.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e strukturës dhe te niveleve të pagave të nëpunësve civile/nëpunësve, Zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në disa institucione te Administrates Publike " të ndryshuar"; Vendimit nr.604, date 14.09.2022 "Per percaktimin e pages minimale ne shkalle vendi"; Vendimit nr.621, date 28.09.2022 "Per disa shtesa dhe ndryshime ne Vendimin nr.187,date 08.03.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e strukturës dhe te niveleve të pagave të nëpunësve civile/nëpunësve, Zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në disa institucione te Administrates Publike " të ndryshuar". Në projekt buxhetin 2023, vihet re se fondi i pagave dhe sigurimeve në programin Arti dhe Kultura paraqitet i rritur në masën 24% ose 131 milion lekë krahasuar me vitin 2022.

-Planifikimi i Shpenzimeve korrente nga të ardhurat (llog.602/5)

Programet	Zeri Shpenzime Administrative (art.602)			%
	Viti 2022	Viti 2023	Diferenca	%
Aparati,planifikim,manaxhim.	1,370,000	1,370,000	0	0.00%
Art & Kultura	14,940,000	16,440,000	1,500,000	10.04%
Trashegimia Kulturore e Muzete	52,600,000	51,100,000	-1,500,000	-2.85%
Shuma	68,910,000	68,910,000	0	0.00%

Shpenzimet korrente nga të ardhurat për vitin 2023 krahasuar me vitin 2022, ruajnë të njëjtat nivele për Programin Planifikim, Menaxhim, Administrim dhe Programin Art dhe Kulturë dhe Trashegimia Kulturore dhe Muzetë.

-Planifikimi i Shpenzimeve korrente (602)

Programet	Shpenzime nga te Ardhurat (602/5)			%
	Viti 2022	Viti 2023	diferenca	%
Aparati,planifikim,manaxhim.	55,650,000	54,750,000	-900,000	-1.62%
Art & Kultura	64,550,000	128,430,000	63,880,000	98.96%
Trashegimia Kulturore e Muzete	121,712,000	67,712,000	-54,000,000	-44.37%
Shuma	241,912,000	250,892,000	8,980,000	3.71%

Shpenzimet korrente për vitin 2023 krahasuar me vitin 2022 janë rritur në masën 3.71% ose në vlerën 8.9 milion lekë të cilat ndahen sipas programeve më sipër. Këto shpenzime janë parashikuar të

përdoren kryesisht për mbulimin e shpenzimeve administrative të domosdoshme për funksionimin e veprimtarisë së Aparatit të Ministrisë së Kulturës dhe institucioneve të varësisë. Gjithashtu, ky zë do të përdoret pjesërisht për mbulimin e shërbimit të sigurimit dhe ruajtjes të Monumenteve të Kulturës dhe Parqeve.

-Planifikimi i Shpenzimeve për projekte (Ilog.604)

Shpenzimet për transferta korrente të brëndshme, zëri Projekte për vitin 2023 kanë pësuar rritje në masën prej 20.95 % ose 106 milion lekë përkatësisht si më poshtë:

Programet	Korrente Brendshme (604)			%
	Viti 2022	Viti 2023	diferenca	%
Aparati,planifikim,manaxhim.				
Art & Kultura	450,100,000	554,110,000	104,010,000	23.11%
Trashëgimia Kulturore e Muzete	55,700,000	57,676,000	1,976,000	3.55%
Shuma	505,800,000	611,786,000	105,986,000	20.95%

-Këto shpenzime në Programin e Trashëgimisë Kulturore, krahasuar me vitin 2022, janë rritur me 1.97 milion, fonde të cilat janë parashikuar të përdoren për mbulimin e gjithë aktiviteteve në fushën e trashëgimisë materiale dhe jo material.

-Shpenzimet në fushën e Artit dhe të Kulturës, krahasuar me vitin 2022 janë rritur me 104 milion lekë. Me këtë zë shpenzimesh janë parashikuar të realizohen kryesisht një rrjet aktivitetesh që synojnë në konsolidimin e vlerave artistike, promovimin e Artit Shqiptar në arenën ndërkombëtare si dhe mbështetja e aktiviteteve kulturore në mbarë vëndin nëpërmjet thirrjeve për aplikime në fushën e artit dhe kulturës librit dhe përkthimit. Institucionet e vartësisë së këtij programi do të realizojnë një sërë veprimtarish artistike kulturore, do të realizojnë premiera si dhe rivenie. Në realizimin e veprimtarive të ndryshme artistike do të jetë prioritet integrimi, angazhimi dhe promovimi i të rinjve më të evidentuar të kësaj fushe. Në këtë program gjithashtu është parashikuar edhe mbështetje për Javët kulturore të huaja në Shqipëri" si një nga programet me te reja te Ministrisë se Kulturës, në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga programi i Qeverisë Shqiptare, projekt do të zbatohet në kuadër të Politikave Integruese nëpërmjet artit-kulturës dhe trashëgimisë kulturore në RSH. Ministria e Kulturës në bashkërendim me ambasadat, partnerët dhe organizma dhe përfaqësi të rëndësishme të akredituara në vëndin tonë, do të vijojë të organizojë periodikisht **“Javët kulturore të huaja në Shqipëri”**, mbështetja financiare për të cilën në këtë vit është shtuar. **Promovimi i “Artit në Hapësirat Publike”**, politikë e nisur përgjatë vitit 2022 me qëllim mbështetjen e bashkëpunimeve të artistëve të vlerësuar nga personalitete dhe kritikë të fushës për risitë e sjella para publikut, të cilat kanë për qëllim të rrisin interesin nëpërmjet ekspozimit në territore publike dhe sociale-kulturore. Rritja e mbështetjes për aktivitete të fushës së **Artit dhe Kulturës, për Projektin Tetori i Librit**, projekt i ri i cili do të zbatohet në 2023.

-Planifikimi i Shpenzimeve për kuotizacione, antarësime (llog.605)

Programet	Korrente te Huaja (605)	%	diferenca	%
	Viti 2022	Viti 2023		
Aparati,planifikim,manaxhim.	0	0	0	0.00%
Art & Kultura	10,130,000	10,150,000	20,000	0.20%
Trashegimia Kultureore e Muzete	481,000	491,000	10,000	2.08%
Shuma	10,611,000	10,641,000	30,000	0.28%

Shpenzimet për transferta korrente të jashtme, zëri kuotizacione për vitin 2023 ruajnë afërsisht të njëjtat nivele si ato të vitit 2022. Këto shpenzime janë parashikuar referuar marrëveshjeve të nënshkruara aktualisht për mbulimin e shpenzimeve të angazhimeve të Ministrisë së Kulturës në përfaqësimet jashtë vendit.

-Planifikimi i Shpenzimeve Transferta për individ dhe familje (llog.606)

Programet	Transferta per Buxhetet Familjare dhe Individet (606)			%
	Viti 2022	Viti 2023	diferenca	%
Aparati,planifikim,manaxhim.	180,000	1,180,000	1,000,000	555.56%
Art & Kultura		288,000	288,000	
Trashegimia Kultureore e Muzete	100,000,000	100,456,000	456,000	0.46%
Shuma	100,180,000	101,924,000	1,744,000	1.74%

Edhe këto shpenzime për transferta të Brëndshme, ruajnë të njëjtat nivele si ato të vitit 2022 dhe ofrojnë mbështetje financiare për programin e ri **Bonusi i Rijetëzimit**, nëpërmjet të cilit zbatohen politikat e programit qeverisës, në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga programi i Qeverisë Shqiptare për reformën ligjore në trashëgiminë kulturore, e cila nisi me miratimin e ligjit nr.27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”. “Bonusi i Rijetëzimit” është një financim për restaurimin dhe rijetëzimin e objekteve në qendra historike, në modele të qëndrueshme biznesi, që gjenerojnë të ardhura dhe punësim për komunitetin.

-Planifikimi Shpenzimeve Kapitale të Brëndshme (llog.230-231)

Shpenzimet Kapitale për Programin e Artit dhe Kulturës paraqesin një rënie në masën prej 26.76% ndërsa Programi i Trashëgimisë Kulturore paraqitet me një rritje në masën prej 187.5% krahasuar me vitin 2022.

Shpenzimet për Investimet Publike (230-231)	Viti 2022	Viti 2023	Diferenca	%
Aparati,planifikim,manaxhim.	0	0	0	0
Art & Kultura	2,242,500,000	1,642,500,000	-600,000,000	-26.76%
Trashegimia Kulturore e Muzete	20,000,000	57,500,000	37,500,000	187.50%
Shuma	2,262,500,000	1,700,000,000	-562,500,000	-24.86%

Referuar tavaneve të projekt buxhetit për vitin 2023, përsa i përket zërit të investimeve të brëndshme, Ministria e Kulturës do të përqëndrohet në:

Emërtimi institucionit	Emërtimi i Projektit	Statusi projektit	Vitit Fillimit	Viti I përfundimit	Vlera Totale e projektit	Financimi deri në 31.12.2021	Detajimi I Buxhetit v.2022 Plan	Parashikimi për v.2023	Parashikimi për v.2024	Parashikimi për v.2025	Vlera e mbetur per tu financuar pas v.2025
Ministria e Kultures					11,264,653	359,865	2,083,022	1,700,000	2,150,000	1,750,000	2,296,179
Arti dhe Kultura					11,072,175	359,865	2,042,500	1,642,500	2,142,500	1,742,500	2,296,179
Bashkia Tirane	Rijetesimi I Piramides Tirane	vazhdim	2020	2024	1,190,000	168,957	447,597	110,000	57,653		
Aparati MK	Restaurimi, Rikonstruksioni dhe Rehabilitimi I hapësirave ne Muzeun e Arteve te Bukura (GKA)	vazhdim	2021	2024	1,079,404	17,354	121,926	409,392	300,000		
Aparati MK	Projektim dhe Implementim I Mozaikut Tirane	vazhdim	2022	2023	179,259	0	36,000	100,000	43,259		
Aparati MK	Mbikqyrje per projektin, Projektim dhe Implementim I Mozaikut Tirane	vazhdim	2022	2023	2,046	0	409	1,000	637		
Aparati MK	Parku i artit, rivitalizimi dhe rikualifikimi i territorit te ish-Kinostudios "Shqipëria e Re", Tiranë	vazhdim	2022	2023	186,010	69,078	100,000	86,010			
Aparati MK	Ndertim I Qendres Kombetare per Femije dhe TK	vazhdim	2022	2024	1,242,435	0	250,272	442,163	550,000		
Bashkia Tirane	Godina e Teatrit Tirane	vazhdim	2022	2025	3,034,951	0	607,000	493,935	915,951	471,771	546,294
Bashkia Tirane	Godina e Teatrit Tirane (pajisje,mobilim)	vazhdim	2024	2026	1,371,690	0	0	0	275,000	1,020,730	75,960
Trashegimia Kulturore dhe Muzete					192,478	0	40,522	57,500	7,500	7,500	0
Instituti Kombëtar I Trashëgimise Kulturore	Restaurimi I "Kisha Shen Kollit", Krujtje e Siperme, Lushnje	I RI	2022	2025	18,690			4,975	7,500	6,215	
Instituti Kombëtar I Trashëgimise Kulturore	Projekt "Restaurimi i Kishës Fjetja e Shën Mërise", fshati Bishqethem, Lushnje	I ri	2023	2023	10,463			10,463			
Instituti Kombëtar I Trashëgimise Kulturore	Projekt restaurimi "Shen Kolli Shelcan"	I ri	2023	2023	10,500			10,500			
Instituti Kombëtar I Trashëgimise Kulturore	Projekti i plotë: "Restaurimi i kishës së Shën Gjergji," dhe "Ndërrhyrje konsoliduese në pikturën murale dhe ikonostasin", Libofsh, Fier.	I ri	2023	2023	13,823			13,823			
Instituti Kombëtar I Trashëgimise Kulturore	Projekt restaurimi I Ures se Kamares	I ri	2023	2023	3,400			3,400			
Instituti Kombëtar I Trashëgimise Kulturore	Projekt Restaurimi "Ura ne fshtatin Postenan"	I ri	2023	2023	2,400			2,400			
Instituti Kombëtar I Trashëgimise Kulturore	Projekt I plote "Restaurimi I Kishes se Shen Kollit dhe Nderhyrje konsoliduese ne pikturën murale dhe ikonostasin, Vanaj, Fier	I ri	2023	2023	9,814			9,814			
Instituti Kombëtar I Trashëgimise Kulturore	Projekt "Restaurim i kishës Shën e Premte", në fshatin Sop, Fier.	I ri	2023	2023	2,125			2,125			

-Në programin e Artit dhe Kulturës

1-“**Rijetesimi i Piramides Tirane**” projekt me bashkëfinancim me Bashkinë e Tiranës, që parashikohet për vitet 2021-2024.

2-Dyfishimi i hapësirave të **Galerisë Kombëtare të Arteve**, që sipas Ligjit të Trashëgimisë kthehet në Muze të Arteve të Bukura. Do të ketë dyfish hapësira për fondin e veprave të artit, dyfish hapësira ekspozimi, edukimi për të rinj; do të ketë laboratorë restaurimi e hapësira për formimin e profesionistëve të rinj. Dhe mbi të gjitha krijimi i kushteve të favorshme për ruajtjen e veprave të artit, modernizim të të gjitha ambienteve, që do të reflektojnë kulturë dhe do të jenë të denja për të pritur emra të mëdhenj artistësh.

5- Një ndër prioritetet për vitet 2022-2024 është krijimi i **Qendrës Kombëtare për Fëmijë**, hapi i parë për politikën dhe programet në favor të familjes dhe fëmijëve, ku synohet “KULTURA E SË ARDHMES” duke parashikuar hapësira, që do ta afrojnë brezin e ri me artin dhe kulturën, leximin, por edhe me natyrën.

6-**Ndërtimi i Parkut të Artit, Faza II**, në zonën e ish-Kinostudios, një bashkëfinancim me BE po ashtu synon krijimin e një poli të tillë, një hapësirë social-kulturore që do të shërbejë për bashkëveprim dhe zhvillime inovative kulturore nëpërmjet një platforme të qëndrueshme. Një hapësirë në shërbim të komunitetit lokal, por dhe komunitetit të artistëve, të fëmijëve, por edhe profesionistëve; të atelieeve të artit, por dhe hapësirave argëtuese e shlodhëse, projekt që parashikohet për vitet 2022.

7-**Godina e Teatrit Kombëtar**, projekt me bashkëfinancim me Bashkinë e Tiranës dhe parashikuar për vitet 2022-2024.

-Në programin e Trashëgimisë Kulturore dhe Muzetë

Në këtë program, synohet restaurimi i disa monumenteve kulturore në të gjithë Shqipërinë si:

9. Restaurimi i "Kisha Shen Kollit", Krujtje e Siperme, Lushnje
10. Projekt “Restaurimi i Kishës Fjetja e Shën Mërise”, fshati Bishqethem, Lushnje
11. Projekt restaurimi "Shen Kolli Shelcan"
12. Projekti i plotë: “Restaurimi i kishës së Shën Gjergji,” dhe “Ndërhyrje konsoliduese në pikturën murale dhe ikonostasin”, Libofsh, Fier.
13. Projekt restaurimi i Ures se Kamares
14. Projekt Restaurimi "Ura ne fshtatin Postenan"
15. Projekt I plote "Restaurimi I Kishes se Shen Kollit dhe Nderhyrje konsoliduese ne pikturën murale dhe ikonostasin, Vanaj, Fier
16. Projekt “Restaurim i kishës Shën e Premte”, në fshatin Sop, Fier.

-Planifikimi Shpenzimeve për Financimin e Huaj (limite buxhetore)

Programet	Financimi I huaj (Grante)			%
	Viti 2022	Viti 2023	diferenca	%
Aparati,planifikim,manaxhim.				

Art & Kultura	95,000,000	50,000,000	-45,000,000	-47.37%
Trashëgimia Kulturore e Muzete	65,000,000	50,000,000	-15,000,000	-23.08%
Shuma	160,000,000	100,000,000	-60,000,000	-37.50%

Me qëllim për të vijuar me projektet IPA në vazhdim nga viti 2022, Ministria e Kulturës referuar disbursimeve të pritshme për financimin e huaj ka planifikuar për vitin 2022 vijimin e projekteve IPA si më poshtë:

- Milestone III- Projekti bashkë financohet nga Bashkimi Europian. D.R.T.K - Vlore është në cilësinë e partnerit në këtë projekt. Projekti i përfituar nga D.R.T.K - Vlore, konsistonte në ndryshimet e restaurimit në murin jugor në Kalanë e Kaninës si dhe në Tëqenë dhe Tyrben në Fshatin Kaninë. Punimet e restaurimit kanë përfunduar dhe aktualisht është duke vijuar vetëm me procedurat e likuidimit të plotë të zerave të projektit, ku është likuiduar rreth 90% e gjithë projektit.
- CREATURES - Adria. Projekti bashkë financohet nga Bashkimi Europian. D.R.T.K - Vlore është në cilësinë e partnerit në këtë projekt. Projekti i përfituar nga D.R.T.K - Vlore, konsiston veç të tjerave, në krijimin e tur guidave kulturore (2), ku aktualisht është në përfundim procesi i vendosjes së gjithë infrastrukurës në shërbim të këtyre tureve, kioskave dhe infokioskave që do jenë në funksion të vizitorëve. Kjo është faza e fundit e projektit, për të cilin ka përfunduar rreth 70% e zbatimit të të gjithë zerave të projektit.
- Projekti Smart4You2 është një projekt i cili ka prioritetin e inkurajimit të turizmit, kulturës dhe trashëgimisë kulturore dhe natyrore duke zhvilluar në mënyrë të vazhdueshme dhe të qëndrueshme potencialin e turizmit si dhe duke promovuar trashëgiminë kulturore dhe vlerat e saj, mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore, zhvillimin e turizmit dhe bashkëjetesës, duke mundësuar kështu një zhvillim të qëndrueshëm social-ekonomik të rajonit ndërkufitar të Pellagonisë.
- Projekti 3 C - Programi INTERREG IPA CBC Itali-Shqipëri- Mali i Zi 2014-2020 po zbaton Projekti Tematik “3C - Cross-border exchange for the development of Cultural and Creative Industries”, nën programin Interreg IPA CBC Itali-Shqipëri-Mali Zi, nr. 354. Forcimi i bashkëpunimit ndërmjet aktorëve të CCI në zonën e projektit, nëpërmjet krijimit të qendrave inovative me programe rezidenciale të artit dhe rrjetet e përbashkëta bashkëpunimi ndërkufitar; Rilidhja e kulturës dhe territorit, dhe të ndarja e njohurive, përvojës dhe potencialin krijues, duke rigjallëruar trashëgiminë përmes artit bashkëkohor; Krijimi dhe promovimi i një platforme rrjetëzimi midis aktorëve kryesorë rajonalë në sektorin e kulturës dhe krijimtarisë, me qëllim përcaktimin e strategjive dhe zbatimin e veprimeve për përmirësimin e sektorit, duke mbështetur shkëmbimin e përvojave, njohurive dhe ideve përmes zhvillimit të produkteve transnacionale, marketingut, brendimit dhe përdorimit të tij për të vlerësuar siç duhet dhe në mënyrë të qëndrueshme asetet kulturore të rajonit.

Sqarim

Në lidhje me projektbuxhetin e vitit 2023 për Ministrinë e Kulturës, i cili planifikohet në **masën 3.9 miliardë lekë**, kërkohet sistemimet e fondeve si më poshtë vijon:

1. **Mbështetje për “Bonusin e Rijetëzimit”**, me qëllim kthimin e objekteve në qendra historike, në modele biznesi, të shtohet në vlerën **50 milion lekë në artikullin 606**

nëpërmjet ri-alokimit të tyre nga programi Arti dhe Kultura (pra, nga artikulli 604 në artikullin 606).

Rrjedhimisht, rritja e mbështetjes për aktivitete të fushës së **Artit dhe Kulturës**, për projekte dhe programe në mbështetje të skemës së pavarur, pakësohet në vlerën 50 milionë lekë (transferim nga programi Arti dhe Kultura artikulli 604 në Programi Trashegimia Kulture dhe Muzete artikulli 606).

2. Investimet Publike 1.8 miliardë lekë në vitin 2023 të alokuar kërkojme sistemim si vijon:

- **Pakesim për limitin e financimit të huaj në vlerën 62 milionë lekë**,
Programi (Art dhe Kulture në vlerën 22 milionë lekë);
Programi (Trashegimia Kulture dhe Muzete në vlerën 40 milionë lekë)

Shtimin e fondit për investimet e brendshme në vlerën 62 milionë lekë në programin Art dhe Kulture për projektet:

- Hartim Projekti Cirkut të ri Kombëtar me një vlerë prej 50 milionë lekësh,
- Hartim Projekti për Restaurimi dhe Muzealizimi i ish banesës së Toptanasve me një vlerë prej 12 milionë lekësh.

•

III. KONSULTIMI PUBLIK I PROJEKLIJIT

Komisioni mbështetur në nenin 36, pika 1 dhe nenin 80, pika 2 të Rregullores së Kuvendit, në kuadër të gjithëpërfshirjes, transparencës dhe konsultimit publik, ka realizuar seanca dëgjimore me aktorë të interesit, si: Akademinë e Shkencave, Akademinë e Studimeve Albanologjike, RTSH-në, ATSH-në, QKK-në, Agjencia për Media dhe Informin, universitetet publike, si në Tiranë dhe në rrethe, Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave etj..

Agjencia për Media dhe Informin

Në hartimin e kërkesave buxhetore janë respektuar tavanet e përcaktuara sipas VKM nr. 130, datë 02.03.2022 “Për miratimin e tavanëve përgatitore të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025”.

Referuar faktit se MIA është institucion i ri i krijuar me VKM nr. 512, datë 18.09.2021 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Media dhe Informim”, për vitin buxhetor 2023, është parashikuar të ketë vetëm 1 (një) produkt me Kod respektivisht 1087040 i cili përfshin *Komunikimin dhe Informimin Mediatik të Këshillit të Ministrave*.

PËRSHKRIMI I PROGRAMIT

- Te sigurojë transparencën në lidhje me politikat, aktivitetet, projektet, eventet, si dhe qëllimin, objektivat, risitë apo problematikat që zgjidhen nëpërmjet akteve të Këshillit të Ministrave dhe të akteve të tjera të Ministrave dhe cdo Institucioni të administratës shtetërore.

OBJEKTIVAT

- Informimi i institucioneve mbi raportimet mediatike; prodhimi i përmbajtjes për komunikimin publik të qeverisë dhe përgatitja e sondazheve qeveritare

- Informimi i qytetarëve mbi nismat, vendimet dhe politikat e qeverisë përmes të gjitha mjeteve të komunikimit masiv.
- Informimi i medias mbi vendimet dhe politikat e qeverisë, si dhe menaxhimi i marrëdhënieve me gazetarët që ndjekin aktivitetin e qeverisë.
- Dhënia e informacionit të qytetarët dhe media mbi veprimtarinë e Ministrive dhe Agjencive të varësisë, si dhe informimi i gazetarëve mbi çështje që lidhen me punën ndërsektoriale të Qeverisë.
- Organizimi i aktiviteteve publike të Kryeministrit dhe Kryeministrit si dhe realizimi i produksionit dhe postproduksionit të materialeve për publikim, lidhur me këto organizime.

Kërkesat buxhetore për vitet 2023 janë parashikuar bazuar në objektivat e institucionit për realizimin e misionit, nëpërmjet produkteve që realizon secila drejtori e institucionit.

Bazuar në udhëzimin standard të përgatitjes së PBA, jemi përpjekur të përlllogarisim kërkesat buxhetore në përputhje me nevojat e institucionit për shpenzime korente.

Kërkesat buxhetore janë hartuar sipas pasqyrave standarde, për çdo produkt në përputhje me objektivin dhe misionin e institucionit.

Tabela e mëposhtme paraqet informacionin e fondeve buxhetore për vitet 2023, referuar tavaneve buxhetore të miratuara për MIA.

Tabela 1. Fondet sipas tavaneve buxhetore.

(000 lekë)

Artikujt	Buxheti	PBA 2023 - 2025		
	2022	2023	2024	2025
Paga (600-601)	94,300	94,300	94,300	94,300
Korente të Tjera (602-606)	50,000	52,000	52,000	52,000
Kapitale (230-232) Të Brendshme	62,000	30,000	5,000	5,000
Kapitale (230-232) Të Huaja	0	0	0	0
Jashtë-buxhetore	0	0	0	0
Totali	206,300	176,300	151,300	151,300

Tabela 2. Fondet sipas kerkesave buxhetore.

(000 lekë)

Artikujt	Buxheti	PBA 2023
----------	---------	----------

	2022	2023	Pakesim Buxheti ne vlere	Pakesim Buxheti ne %
Paga (600-601)	94,300	87,300	7,000	7.4%
Korente të Tjera (602-606)	50,000	30,000	20,000	40%
Kapitale (230-232) Të Brendshme	62,000	0	62,000	100%
Kapitale (230-232) Të Huaja	0	0	0	
Jashtë-buxhetore	0	0	0	
Totali	206,300	117,300	87,000	43%

Në bazë të analizës të të gjithë faktorëve po shpjegojmë nevojat buxhetore të vitit 2023 si më poshtë:

➤ **Parashikimi i Pagave dhe Sigurimeve Shoqërore për vitin 2023 është 87,300,000 leke.**

Llogaritja e fondit të pagave dhe sigurimeve (600+601) është bërë sipas organikës të miratuar me Urdhër nr. 136 dt. 23.11.2021 “Per miratimin e strukturës dhe organikes së Agjencisë për Media dhe Informim (MIA)”, dhe Urdhër nr. 20 dt. 08.02.2022 për disa ndryshime dhe shtesa të Urdhërit nr. 136 dt. 23.11.2021 të Kryeministrit “ Për miratimin e strukturës dhe organikes së Agjencia për Media dhe Informim (MIA)”. Numri i miratuar i punonjësve definitive është 69. Gjithashtu llogaritjet janë bazuar në nivelet e pagave të miratuara me Vendim nr.187 datë 08.03.2017 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nënpunësve civilë/nënpunësit në të gjitha institucionet pjesë e fushës së veprimt të këtij vendimi” (ndryshuar me VKM nr.696 datë 22.11.2017, nr.1 datë 04.01.2018, nr. 116 datë 23.02.2018)(i përditësuar).Fondi i pagës (600) për punonjësit definitivë sipas organikës dhe niveleve të pagave parashikohet në vlerën 75.000.000 (shtatëdhjet e pesë milion) lekë, ku kemi nje pakesim nga viti i kaluar ne vleren 7,000,000 (shtate milion) lekë dhe fondi i sigurimeve (601) parashikohet në vlerën 12.300.000 (dymbëdhjetë milion e treqind mijë) lekë.

➤ **Parashikimi i Shpenzimeve operative për vitin 2023 është 30.000.000 leke.**

Llogaritja e fondit për shpenzimet operative (602) eshte bere sipas struktures së MIA dhe analizës së shpenzimeve operative për vitin 2022. Gjithashtu në përlllogaritjen e shpenzimeve operative për vitin e ardhshëm janë marrë në konsideratë vendimi i Kryeministrit Nr. 160, dt. 14.03.2022 “Për reduktimin e shpenzimeve të transportit për funksionarët, nënpunësit, punonjësit e institucioneve të administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave” dhe akti normativ i Këshillit të Ministrave Nr 14, dt 05.10.2022 “Për marrjen e masave të veçanta gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike”.

Agjencia për Media dhe Informim ka kërkuar një fond total prej 30,000,000 (tridhjetë milionë) lekësh për shenzimet operative për vitin 2023.

➤ **Investimet për vitin 2023.**

Në zërin 231 tavanet e vendosura janë 30,000,000 (tridhjetë milionë) lekë por institucioni nuk ka kërkesa të parashikuara për këtë zë.

- **Për realizimin dhe funksionimin në kushte të nevojave reale kërkohet një fond total për buxhetit 2023 në vlerën 117,300,000 lekë.**

Tabela 3. PBA për vitin 2023

(000 lekë)

VITI 2023							
Shpenzime korente				Shpenzime kapitale			TOTAL
600	601	602	Totali Shpenzime Korente	Financim i brendshem	Financim i huaj	Total Shpenzime kapitale	
75,000	12,300	30,000	117,300	0	0	0	117,300

Akademia e Shkencave

Projekt-buxheti afatmesëm (PBA) 2023-2025 i Akademisë së Shkencave, i cili është hartuar bazuar në Udhëzimin nr.7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm”, të Udhëzimeve Plotësuese nr. 9, datë 28.02.2022 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025” (Faza strategjike) dhe nr. 22, datë 08.07.2022 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025” (Faza II, Teknike) të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, duke iu përmbajtur tavanëve përfundimtare të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2023 – 2025 të miratuara me VKM nr. 535, datë 29.07.2022 “Për miratimin e tavanëve përfundimtare të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025”, si dhe buxhetit të miratuar për vitin 2022, është paraqitur në tabelën e mëposhtme:

II. Buxheti bazë vjetor

a. Sipas artikujve buxhetorë

Në 000 lekë

Nr. Llog	Emërtimi	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024	Viti 2025
600	Paga	30,000	30,000	30,000	30,000
601	Sigur. shoq. / shëndetësore	4,500	4,500	4,500	4,500
602	Mallra dhe shërbime	86,700	122,900	44,400	44,400
605	Transferta korrente të huaja	600	600	600	600
606	Transferta për individët	30,300	30,000	30,000	30,000
231	Investime	1,000	1,000	1,000	1,000

TOTALI	153,100	189,000	110,500	110,500
---------------	----------------	----------------	----------------	----------------

Buxheti i parashikuar për vitin 2023 ka një rritje prej 36,000 në mijë lekë ose rreth 23% krahasuar me buxhetin fillestar të vitit 2022,

- Buxheti i parashikuar për vitin 2024 ka një rënie prej 78,000 në mijë lekë ose rreth 42% krahasuar me vitin 2023.
- Buxheti i parashikuar për vitin 2025 është i njëjtë me atë të vitit 2024.

b. Sipas produkteve

Buxheti i Akademisë së Shkencave për vitin 2023 përbëhet nga 4 produkte.

• **Produkti 1 “92201AA”:** në vlerën 74 500 mijë lekë

“Veprimtaria e Asamblesë së ASH-së, seksioneve shkencore, Kryesisë, administratës dhe personaliteteve në fushat e shkencës, në përputhje me misionin e saj, pagat dhe pagesat për tituj”.

Ky produkt përfshin:

5. Pagat	30 000 000 lekë
6. Sigurimet shoqërore e shëndetësore	4 500 000 lekë
7. Titulli akademik	30 000 000 lekë
8. Shpenzime administrative	10 000 000 lekë

Totali	74 500 000 lekë
--------	------------------------

• **Produkti 2: “92201AB”** në vlerën 41 000 mijë lekë

“Veprimtaria e seksioneve, njërive kërkimore, komisioneve, veprimtaria promovuese (Veprimtari kërkimore – studimore, projekte, konferenca, seminare, ligjërata, kongrese) etj.”.

Ky produkt përfshin:

1. Veprimtari kërkimore-studimore, projekte, konkurset e çmimeve	40 400 000
2. Transferta me jashtë (kuota anëtarësimi)	600 000

Totali	41 000 000 lekë
--------	------------------------

• **Produkti 3: “92201AC”** në vlerën 12 000 mijë lekë

“Publikime shkencore: Botime, monografi dhe revista periodike (Albanian Journal of Natural and Technical Sciences dhe Studia Albanica), të përzgjedhura kombëtare/ndërkombëtare; Raporte të veprimtarisë së ASHSH-së dhe buletine për veprimtaritë e saj”.

Ky produkt përfshin:

1. Botime 12 000 000 lekë

Totali 12 000 000 lekë

•Produkti 4: “92201AE” - Projektet madhore në Albanologji, në vlerën 60 500 mijë lekë.

Prej më se 2 vitesh, pjesë përbërëse e buxhetit të ASH-së është bërë **Produkti “92201AE”** që përfaqëson projektin për hartimin e tri veprave madhore në albanologji: **1. Hartimi i enciklopedisë shqiptare, 2. Fjalori i madh i shqipes, 3. Historia e shqiptarëve**”, financimi i të cilave për vitin aktual 2022 është 30,000 mijë lekë, ndërsa në PBA 2023-2025 për vitin 2023 është parashikuar 60,000 mijë lekë.

Viti 2023 përkon me fillimin e punës për vënien në jetë të marrëveshjes së lidhur ndërmjet Qeverisë Shqiptare dhe asaj të Kosovës sipas Vendimit nr. 421, datë 17.06.2022 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin në parim të marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës për bashkëfinancimin e projektit madhor në Albanologji *Enciklopedia Shqiptare* si dhe me përfundimin e dy projekteve *Fjalori i madh i Gjuhës Shqipe* dhe *Historia e Shqiptarëve*”.

Theksojmë se:

Botimi i *Fjalorit të madh të shqipes*, përveç rëndësisë që ka për të konfirmuar fuqinë shprehëse të shqipes, mbi të gjitha është me rëndësi për të stabilizuar në një shkallë shumë më të lartë normën leksikore të shqipes së shkruar, me zgjerime të një rëndësie themelore.

Historia e shqiptarëve do të jetë një histori sintetike e popullit shqiptar, që do të ketë si lexues pritës kryesisht të huajt, studiuesit e albanologjisë dhe ekspertët të institucioneve evropiane që kanë nevojë për një njohje të thelluar të historisë së popullit shqiptar. Teksti do të promovojë vlerat e identitetit, qytetërimit dhe trashëgimisë shqiptare dhe do të çmjegullojë paqartësitë lidhur me origjinën, vendin e formimit, veçanësinë dhe vijimësinë e popullit shqiptar në trojet e veta.

Enciklopedia shqiptare është vepra e tretë madhore në albanologji, më e vështira dhe më e domosdoshmja. Enciklopedia do të jetë mediumi më i rëndësishëm shkencor për njohjen e shqiptarëve, të historisë, kulturës, trashëgimisë, identitetit dhe vlerave etnotipike të tyre. Do të jetë vepra më e rëndësishme e promovimit të shqiptarëve brenda dhe jashtë vendit.

Duke qenë se për vitin 2023 u buxhetua shuma e kërkuar nga ana jonë prej 60 000 mijë lekë për këto projekte, kërkojmë që **për vitet 2024-2025 të na shtohen respektivisht nga 100 000 mijë lekë për çdo vit**, pasi projekti *Enciklopedia Shqiptare* shtrihet në një afat prej 5 vitesh duke filluar nga viti 2023 dhe vlera e plotë e projektit është 447 000 mijë lekë. Kjo do të garantonte marrëveshjen e bërë ndërmjet dy qeverive dhe sigurinë e vijimit të këtij projekti madhor në albanologji.

**KËRKESA BUXHETORE 2023-2025
PËR PROJEKTET ALBANOLOGJIKE**

Nr.	ZËRAT E SHPENZIMEVE	Vlera e plotë e projektit	Shtrirja në vite			
			2022	2023	2024	2025
1	Tri projektet albanologjike	447,225	30.000	60,000	100,000	100,000

Të katër këto produkte së bashku, duke shtuar këtu dhe 1 000 000 lekë investime, kapin vlerën **189,000** mijë lekë, që përbën buxhetin bazë vjetor për vitin 2023 të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Me këtë buxhet është parashikuar të përballohen të gjitha shpenzimet vjetore bazë të ASHSH dhe i tërë aktiviteti kërkimor-shkencor që pa dyshim përbën përqendrimin dhe prioritetin e shpenzimeve. Gjatë vitit 2022 janë në realizim e sipër gjithsej 17 projekte kërkimore-shkencore. Nga këto, 14 projekte, ku shumica prej tyre vijojnë edhe për vitin 2023, përballohen nga buxheti bazë që sapo e përmendëm më lart. Ndërsa tri projektet e tjera i përkasin fushës së albanologjisë ku përfshihet hartimi dhe botimi i tri veprave madhore, të cilat do të përballohen nga buxheti shtesë i kërkuar nga ana jonë dhe i propozuar nga Këshilli i Ministrave për miratim në vitin 2023.

II. Investimet për projektet në Bioteknologji Gjenetike e Qendra NanoAlb (Pajisje laboratorike)

Për sa u përket investimeve (shpenzime kapitale) tavani buxhetor i miratuar është 1 000 në mijë lekë, të detajuara 300 mijë lekë për blerje librash të rinj (pasurim të bibliotekës) dhe 700 mijë lekë për blerje pajisjesh elektronike e informatike. Ky buxhet i alokuar në vite është tepër minimal dhe ka shërbyer e shërben për të mbuluar disa blerje pajisjesh si kompjutera e kondicionerë për të zëvendësuar ata ekzistues. Këto shpenzime kanë qenë minimale për të menduar për digjitalizim apo blerje pajisjesh moderne elektronike, pa të cilat në ditët e sotme as që nuk mund të mendohet një Akademi e Shkencave apo institucion tjetër kërkimor-shkencor.

Sot pranë Akademisë së Shkencave aktualisht funksionojnë 9 komisione të përhershme, ku krahas akademikëve, kontribuojnë si anëtarë të rregullt mbi 90 përfaqësues të universiteteve e qendrave studimore, 7 njësi e qendra kërkimore-shkencore dhe 2 institute virtuale. Aktualisht, veprimtaria e Akademisë së Shkencave ka rrokur në tërësi bashkësinë shkencore, universitare e intelektuale të vendit.

Në këto vite reformimi, Lidërshipi i ASHSH ka bërë të mundur thellimin e reformimit të sistemit tonë shkencor, ngritjen e nivelit të kërkimit për shkencat bashkëkohore, realizimin me sukses të iniciativave shkencore madhore dhe me mbështetjen e kujdesin e afërt të qeverisë, bërjen realitet qëllimin për **transformimin e njësisve kërkimore të saj në qendra e institute të mirëfillta kërkimore - shkencore.**

Përballë këtij realiteti, përmirësimi dhe optimizimi i infrastrukturës së strukturave kërkimore - shkencore pranë saj duke filluar me ato bashkëkohore si Qendra Kërkimore e Bioteknologjisë dhe Gjenetikës; Laboratori Epidemiologjik; Laboratori i Bioteknologjisë bimore *in vitro*; Qendra Kërkimore NanoAlb etj.

Krahas me ndryshimet dhe zhvillimet e sipërcituara, ndërtimi i një godine të re dinjitoze për akademikët, profesorët, studiuesit, kërkuesit etj., është një nevojë dhe domosdoshmëri për mbështetjen e këtij institucioni elitë të dijes.

Kështu, përveç kërkesave shtesë për projektet e sipërcituara nga ASHSH, janë bërë kërkesa shtesë edhe për shpenzime kapitale, si:

Për vitin 2023 është kërkuar buxhetin në artikullin 231 (Investime) në vlerën **64,600** në mijë lekë për pajisje laboratorike dhe ndërtim godine.

Për vitin 2023 kërkohet buxhetim në vlerën 24,900 në mijë lekë për blerje të pajisjeve për:

4. Laboratori Epidemiologjik (8,200 në mijë lekë nga 20,000 në mijë në total kostoja);
5. Qendra Kërkimore e Bioteknologjisë dhe Gjenetikës (12,500 në mijë lekë nga 28,000 në mijë në total kostoja)
6. Ngritja e Laboratorit të Bioteknologjisë bimore *in vitro* (4,200 në mijë lekë, aq sa është edhe kostoja totale e projektit).

në 000/lekë

Nr	Kërkesa shtesë per investime 2023 -2025 (pajisje laboratorike)	2023	2024	2025	
1	Blerjen e pajisjeve për Laboratorin Epidemiologjik	8,200	10,000	10,000	28,200
2	Përmirësimi dhe optimizimi i infrastrukturës së QKBGJ	12,500	9,500	6,000	28,000
3	Regjistrimi kombëtar i dhuruesve të qelizave staminale		1,000		1,000
4	Studimi gjenetik dhe funksional i semundjeve të rralla		10,000		10,000
5	Implementimi i qelizave (T CAR) mjekimin e sëmundjeve malinje			15,000	15,000
6	Implementimi i teknologjisë NGS			5,000	5,000
7	Ngritja e laboratorit të Bioteknologjisë bimore <i>in vitro</i>	4,200			4,200
8	Ngritja e Kriobankës		6,800		6,800
9	Ngritja e laboratorit të Bioteknologjisë bimore dhe bioteknologjisë molekulare		9,000		9,000
	Totali kërkesat shtesë për Bioteknologjia dhe Nanoshkenca (blerje pajisje)	24,900	46,300	36,000	107,200
1	Investim - ndërtim godine e re (Zyra për akademikët, profesorët, administratën) në ambientet e ASHSH	40,000	30,000		70,000
	Totali kërkesat shtesë për investime (2023 -2025)	64,900	76,300	36,000	177,200

Kërkesat e mësipërme konsistojnë në funksionimin e njësisë së kërkim-studimit të Bioteknologjisë dhe Gjenetikës që i ka filluar në vitin 2020, si hapi i parë i rëndësishëm në fillimin e organizimit të punës në këtë drejtim.

Misioni i QKBGJ është i shumëfishtë dhe lidhet me nxitjen, promovimin, organizimin e drejtimin shkencor në çështje dhe drejtime me rëndësi që kanë ndikim të gjerë në zbatimin e tyre ku disa

trajtohen edhe për herë të parë dhe njëkohësisht kërkojnë koordinim e bashkëpunim me një sërë institucionesh të tjera në vend e rajon me qëllim mundësimin e lidhjeve me qendrat homologe si dhe afrimin e angazhimit të mjaft shqiptarëve të suksesshëm që punojnë dhe jetojnë jashtë Shqipërisë.

Në fushën e Gjenetikës qëllimet kryesore lidhen kryesisht me studimet në gjenetikën mjekësore e antropogjenetikë duke synuar më shumë lidhjet me shkencat albanologjike.

Përvoja botërore ka treguar se të dhënat e gjenetikës janë thelbësore në ndërtimin e historisë së popullatës njerëzore.

Kështu, studimeve në fushat e historisë, arkeologjisë, gjuhësisë etj. u mungojnë pothuajse tërësisht studimet antropogjenetike të domosdoshme për ndërtimin e historisë gjenetike të popullatës shqiptare, studime të cilat lidhen edhe me problemet e gjenetikës mjekësore të popullatës si probleme të mprehta e sfiduese për mjeksinë bashkëkohore.

Si hap i parë është parashikuar ngritja e bankës gjenetike, e cila kërkon pajisje të veçanta frigoriferike, të cilat do të mundësojnë ruajtjen e materialeve që do të mbliidhen nga ekspeditat, të cilat më pas do të shfrytëzohen për ekstraktimin e ADN-së, e cila do të analizohet duke kombinuar metodat e përparuara të biologjisë molekulare dhe gjeomikës me metodat matematikore dhe kompjuterike.

Përmes analizave të ADN-së me materialet e furnizuara nga arkeologjia, do të analizohet dhe synohet të provohet lidhja gjenetike e popullatave të sotme me popullatat e vjetra ilire për të kuptuar dhe interpretuar nivelet e vazhdimësisë dhe gjenealogjisë midis tyre.

Në fushën e Bioteknologjisë bimore dhe shtazore kërkohet buxhetim për ngritjen e infrastrukturës laboratorike për realizimin e kërkimeve shkencore aplikative që nuk janë prekur deri tani, si:

- Çertifikimi fitosanitar gjenetik i fidanëve të drurëve frutorë për modernizimin e biznesit të fidanishteve.

- Ngritja e Kriobankës *in vitro* për konservimin e bimëve si për krijimin e kultivarëve të rinj cilësorë.

- Krijimi i kloneve të hardhive autoktone për të përfituar vlera e cilësi unike e konkurrese.

- Prodhimi i produkteve bionatyrle nga bimët aromatike mjekësore shqiptare.

- Vlerësimi i diversitetit gjenetik në racat e kafshëve të fermës dhe ato unike për menaxhim efektiv të resurseve shtazore.

- Diagnostikimi molekular për detektimin e patogjenëve të rinj.

Nga sa më sipër, kërkojmë buxhetimin e kërkesave për këto pajisje laboratorike bazë për funksionimin e laboratorëve të njëjësive e qendrave kërkimore-shkencore pranë ASHSH.

V.

Gjithashtu për këtë periudhë të PBA kemi kërkuar kërkesë shtesë edhe për ndërtimin e objektit “Ndërtim godine për akademikët, profesorët, kërkuesit shkencorë dhe administratën e ASH-së”, pasi aktualisht nuk kemi zyra e ambiente të tjera të mjaftueshme.

ASH ushtron aktivitetin e saj në ambienti me qira, ku për një vit buxhetor paguajmë **7 000** mijë lekë.

Ndërtimi godinës së re me kosto të përafërt që shkon **70 000** mije lekë do të rikuperonte për një periudhë 10-vjeçare qiranë që paguhet për godinën aktuale si dhe do krijojë kushte më të përshtatshme për personelin e ASH. Për këtë është kërkuar buxhetim **40,000** në mijë lekë për vitin 2023 dhe **30,000** në mijë lekë për vitin 2024.

Theksojmë se kjo godinë ku punojnë personeli i ASH, akademikët, bashkëpunëtorët e ASH-së, përveç mbajtjes me një kosto të lartë qiraje, është edhe në kushtet e shembjes dhe rrezikshmërisë së qëndrimit në të.

Është e domosdoshme që për funksionimin sipas reformës së re PBA për Akademinë e Shkencave të jetë gjithnjë në rritje referuar kjo kërkesave buxhetore bazë dhe ato shtesë të bëra nga Akademia e Shkencave.

Bashkëlidhur formati 3, format standard i përgatitjes së kërkesave buxhetore PBA 2023-2025 dhe preventivat e shpenzimeve të projektit për tri veprat e mëdha në shkencat albanologjike.

Komisioni mbështetet kërkesën e Akademisë së Shkencave për realizimin me efektivitet të veprimitarisë së saj.

RTSH

Në Programin Buxhetor Afatmesëm 2023-2025 të miratuar dhe publikuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, tavanet buxhetore të RTSH për vitet 2023-2025 janë rishikuar krahasuar me fazën e parë dhe të dytë të PBA 2023-2025, me një rritje në total prej rreth 40 mln lekësh (rreth 7 %), përkatësisht 20 mln ne zërin e programit për orkestrën Simfonikë të RTSH dhe 20 mln leke ne programin e projekteve teknike për futjen e teknologjive te reja, si më poshtë:

Tavanet e shpenzimeve te RTSH sipas Programeve Buxhetore		Viti 2023		Viti 2024		Viti 2025	
1	Shërbimi për shqiptarët jashtë kufirit dhe shërbimi për publikun në gjuhë të huaj	ALL	240,000,000	ALL	240,000,000	ALL	240,000,000
2	Prodhime Filmike ose veprimtari Artistike të mëdha mbarëkombëtare	ALL	68,000,000	ALL	68,000,000	ALL	68,000,000
3	Orkestra Simfonike RTSH dhe Kinematografisë	ALL	82,000,000	ALL	82,000,000	ALL	62,000,000
4	Projekte Teknike për Futjen e Teknologjive të Reja	ALL	220,000,000	ALL	200,000,000	ALL	200,000,000
TOTALI		ALL	610,000,000	ALL	590,000,000	ALL	570,000,000

Financimi buxhetor sipas programeve përkatëse, gjatë viteve te fundit paraqitet si me poshtë:

Tavanet e shpenzimeve te RTSH sipas Programeve Buxhetore		Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022
1	Shërbimi për shqiptarët jashtë kufirit dhe shërbimi për publikun në gjuhë të huaj	ALL 240,000,000	ALL 240,000,000	ALL 270,000,000	ALL 220,000,000	ALL 240,000,000
2	Prodhime Filmike ose veprimtari Artistike të mëdha mbarëkombëtare	ALL 65,000,000	ALL 74,000,000	ALL 60,000,000	ALL 60,000,000	ALL 67,600,000
3	Orkestra Simfonike RTSH dhe Kinematografisë	ALL 60,000,000	ALL 60,000,000	ALL 54,000,000	ALL 60,000,000	ALL 62,400,000
4	Projekte Teknike për Futjen e Teknologjive të Reja	ALL 400,000,000	ALL 300,000,000	ALL 250,000,000	ALL 266,000,000	ALL 197,600,000
TOTALI		ALL 765,000,000	ALL 674,000,000	ALL 634,000,000	ALL 606,000,000	ALL 567,600,000

Theksojmë se hartimi i Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025, është bazuar në të dhënat e aktivitetit të viteve të fundit, Programin Buxhetor Afatmesëm 2022-2024 dhe në vlerësimin me përgjegjësi të kërkesave nga të gjitha njësitë e drejtoritë, bazuar në nevojat dhe në informacionet mbi strukturën programore, planet zhvillimore të RTSH, sipas zërave të detajuara të buxhetit.

Radio Televizioni Shqiptar gjatë fazës së II të PBA 2023-2025 ka qene i detyruar ti përmbahet tavanaeve buxhetore në zbatim te udhëzimit plotësues, por në relacionin e dërguar pranë Ministrisë se Financave dhe Ekonomisë, kemi riparqitur kërkesat shtesë si domosdoshmëri për funksionimin e RTSH ne realizimin e misionit të saj.

Ne projekt buxhetin e paraqitur rezulton qe Buxheti i përgjithshëm i RTSH për vitin 2023 parashikohet te jete ne vlerën e 2.265.000.000 ALL.

- 610.000.000 ALL nga financimi buxhetor

- 1.655.000.000 ALL nga te ardhurat e vete RTSH (1.4 mld nga tarifa e aparatit, 130 mln nga shfrytëzimi i infrastrukturës transmetuese, 100 mln nga reklamat dhe 25 mln nga te ardhurat e tjera)

Me poshtë po ju paraqesim kërkesat e RTSH, sipas programeve të shpenzimeve:

1. Programi I - Shërbimi për shqiptarët jashtë kufirit dhe shërbimi i publikut në gjuhë të huaj

Politika e Programit

Politika e RTSH për këtë program është përcjellja në kohë reale si në Radio edhe në Televizion të gjitha zhvillimet politike, ekonomike, sociale, kulturore, sportive, historike të popullit tonë për të gjithë shqiptarët që jetojnë jashtë kufijve, arkiva e pasur e Radiotelevizionit Shqiptar, filma prodhim Kinostudio, teatër të regjistruar nga të gjitha trevat shqiptare si edhe prodhimet filmike të Televizionit Shqiptar, seriale filma me metrazh të gjatë e të shkurtër duke arritur zgjerimin në maksimumet e mundshme të komunikimit me shqiptarët kudo ndodhen.

Radio Tirana Internacional transmeton në shtatë gjuhe të huaja (Anglisht, Gjermanisht, Frëngjisht, Italisht, Turqisht, Greqisht dhe Serbisht) emisione informative, rubrikat për Shqipërinë, figurat e shquara të popullit tonë, muzikën, trashëgiminë kulturore, reformat integruese dhe zhvillimin ekonomik të vendit.

Qëllimet e Politikës

Informim i vazhdueshëm i shqiptarëve që jetojnë jashtë me zhvillimet në Shqipëri, ngjarjet e përditshme në vend, mundësitë e udhëtimit në Shqipëri . RTSH synon edhe të mbështesë kulturën e krijimtarinë letrare dhe artistike shqiptare, të edukojë dhe të zhvillojë kulturën e të folurit shqip sipas rregullave të drejtshkrimit, të realizojë emisione që respektojnë dinjitetin vetjak dhe të drejtat themelore të njeriut.

Objektivat e politikës

Zgjerim i platformës së transmetimit dhe të larmishmërisë së programeve

Produktet e politikës

Emisione televizive dhe emisione radiofonike

RTSH është e pranishme në kohë reale, me të gjitha informacionet për programet e saj në të gjitha kanalet e transmetimit.

Me investimet e bëra në sistemin satelitor, kudo që jetojnë shqiptarë në Europë, nga 1 (një) program transmetimi televiziv që ndiqnin para vitit 2017, ndjekin 7 programe transmetimi Televizive (3 programe në definicion HD dhe 4 programe në definicion SD) dhe 11 kanale radioje që nga viti 2018 dhe të gjitha kanalet në OTT.

Gjithashtu, në zbatim të ligjit 96/2017 “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, RTSH transmeton në 7 gjuhe për nëntë minoritete në kanalin RTSH2.

Më poshtë janë paraqitur në mënyrë të përmbledhur shpenzimet për programin e “Shërbimi për shqiptarët jashtë kufirit dhe shërbimi i publikut në gjuhë të huaj”

1	Programi Buxhetore:"Shërbimi për shqiptarët jashtë kufirit dhe shërbimi për publikun në gjuhë të huaj"	Viti 2023	Viti 2024	Viti 2025
	Shpenzimet për Paga e Sigurime Shoqërore e Shëndetësore (Njesia lajmeve)	ALL 45,495,677	ALL 45,495,677	ALL 45,495,677
	Shpenzime te tjera (Njesia e Lajmeve)	ALL 2,916,000	ALL 2,916,000	ALL 2,916,000
	Shpenzimet për Paga e Sigurime Shoqërore e Shëndetësore (Njesia teknike)	ALL 33,299,160	ALL 33,370,000	ALL 33,370,000
	Shpenzime te tjera (Njesia Teknike)	ALL 34,670,000	ALL 34,670,000	ALL 34,670,000
	Shpenzime per Tarifa Satelitore	ALL 30,000,000	ALL 30,000,000	ALL 30,000,000
	Shpenzimet për Paga e Sigurime Shoqërore e Shëndetësore (Njesia Programeve)	ALL 9,351,876	ALL 9,351,876	ALL 9,351,876
	Shpenzime te tjera (Njesia Programeve)	ALL 4,799,000	ALL 4,799,000	ALL 4,799,000
	Shpenzime direkte dhe indirekte per prodhime filmike dhe artistike	ALL 80,000,000	ALL 80,000,000	ALL 80,000,000
	TOTALI	ALL 240,531,713	ALL 240,602,553	ALL 240,602,553

Bazuar në projekt buxhetin e paraqitur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, buxheti i shtetit pritet të finançojë 240 mln lekë për çdo vit duke mbuluar nevojat e RTSH për këtë zë për vitet 2023-2025.

2. PROGRAMI II-Prodhime filmike e artistike me rëndësi mbarëkombëtare

Politika e programit

Realizim i projekteve cilësore në fushën e radios e televizionit, përfshirë këtu aktivitete të rëndësishme artistike, sportive kombëtare e ndërkombëtare me pjesëmarrje shqiptare, seriale televizive shqiptare, bashkëprodhime me të tretë etj.

Qëllimet e Politikës

Në cilësinë e transmetuesit publik, RTSH duhet të ofrojë programet më të mira dhe synon realizimin e një sërë projektesh cilësore artistike, filmike në fushën e Radios dhe Televizionit.

Objektivat e Politikës

Zgjerim i larmshmërisë së projekteve dhe programacionit e cila do të sjellë rritje e audiencës

Produktet që do të ofrohen :

Program muzikor me rëndësi mbarëkombëtare, Projekte filmike, artistike etj.

Ndryshimet në strukturën programore të RTSH ecën paralelisht me ndryshimet në teknologjinë e transmetimit. RTSH transmeton një paketë të plotë programore ne TV e radio:

RTSH1, RTSH2, RTSH3, RTSH Sport, RTSH Muzikë, RTSH Film, RTSH Shqip, RTSH Kuvend, RTSH Agro, RTSH Fëmijë, RTSH 24, RTSH Shkollë, RTSH Plus, TV Korça, TV Gjirokastra, TV Kukës, TV Shkodër.

Radio Tirana1, Radio Tirana2, Radio Tirana 3, Radio Internacional, Radio Tirana Klasik,

Radio Tirana Jaz, Radio Tirana Fëmijë, Radio Korça, Radio Kukësi, Radio Gjirokastra, Radio Shkodra.

Struktura programore është transformuar si në formë edhe në përmbajtje.

RTSH gjatë periudhës 2023-2025 synon realizimin e prodhimeve, bashkëprodhime me të tretë për aktivitete të rëndësishme mbarëkombëtare artistike, filmike etj.

Në kushtet e zgjerimit të platformës së transmetimit edhe prodhimet e RTSH duhet të kenë rritje sasiore e cilësore, për prodhimin e projekteve të rëndësishme filmike, radiofonike, artistike etj, të cilat do të sjellin pasurim e përmirësim programesh në kanalet e radios e televizionit, e për rrjedhojë rritje të audiencës të RTSH-së.

Aktualisht me fondet e planifikuara nga Buxheti i shtetit RTSH arrin të mbulojë aktivitetet mbarëkombëtare si Eurosong, Junior Eurosong, Festivalin e Këngës në RTSH dhe vetëm pjesërisht programet e fund vitit.

Më poshtë janë paraqitur në mënyrë të përmbledhur shpenzimet për programin e “*Prodhime filmike e artistike me rëndësi mbarëkombëtare*”

2	Programi Buxhetore: "Prodhime Filmike ose veprimtari Artistike të mëdha mbarëkombëtare"	Viti 2023		Viti 2024		Viti 2025	
	Festivali i Këngës në RTSH	ALL	55,000,000	ALL	55,000,000	ALL	55,000,000
	Pjesëmarrja e RTSH evente nderkombetare	ALL	15,000,000	ALL	15,000,000	ALL	15,000,000
	Programi Festiv i FundVitet	ALL	10,000,000	ALL	10,000,000	ALL	10,000,000
	Prodhime Filmike	ALL	15,000,000	ALL	15,000,000	ALL	15,000,000
	TOTALI	ALL	95,000,000	ALL	95,000,000	ALL	95,000,000

Bazuar në projekt buxhetin e paraqitur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, buxheti i shtetit pritet të financojë 68 mln lekë për çdo vit 2023-2025.

Kërkesat shtesë për këtë program qëndrojnë në nivelin 27 milion lekë në vitin 2023, dhe vitet 2024 dhe 2025.

3. PROGRAMI III - Orkestra Simfonike e RTSH dhe Kinematografisë

Politika e këtij programi

Formacion orkestral brenda strukturës së Drejtorisë së Përgjithshme RTSH, organikë unike në Republikën e Shqipërisë, e cila krahas veprimtarisë koncertale për publikun, prodhon programe muzikore për fonotekën dhe Arkivin e RTSH.

Qëllimet e Politikës

Formacion lider që do të japë ndihmesën në zhvillimin kulturor, muzikor kombëtar, riprodhimin e veprave muzikore shqiptare e të huaja dhe prodhimin e regjistrimeve të muzikës së lehtë dhe popullore, përgatitjen dhe shfaqjen e koncerteve dhe shfaqjeve të tjera publike, regjistrimin e krijimeve artistike të huaja e të vendit, koncertet mujore, festivalet dhe krijimtari të tjera.

Objektivat e Politikës

Orkestra e RTSH ka si objektiv rritjen e cilësisë së punës dhe te nivelit artistik të saj ku gjate vitit 2022 është bere e mundur realizimi i shume koncerteve me pjesëmarrjen e artistëve dhe muzikantëve te mirënjohur ne arenën ndërkombëtare. Gjithashtu, shkëmbimi i eksperiencës së orkestrës sonë edhe me orkestrat e vendeve të tjera ka si qellim rritjen e nivelit artistik..

Produktet që do të ofrohen

Orkestra Simfonike të RTSH gjate gjithë vitit ofron koncerte te cilat zhvillohen me pjesëmarrjen e muzikanteve te mirënjohur vendas dhe të skenave ndërkombëtare.

Nëpërmjet stinës koncertore të vitit, stinë gjatë së cilës zhvillohen mesatarisht 2 koncerte në muaj me pjesëmarrjen e instrumentistëve, këngëtarëve dhe dirigjentëve më të mirë shqiptarë apo të huaj, RTSH pasuron arkivin e saj me mesatarisht programe premierë 3 orë/muaj në kanalet:

RTSH Muzikë dhe RTSH 1, si edhe ritransmetime të koncerteve të tjera të regjistruara të orkestrës mesatarisht 8 orë/muaj në kanalet e mësipërme.

Radio Tirana Klasik transmeton çdo mbrëmje nga ora 20.00 koncerte të Orkestrës 45-90 minuta, si edhe në Radio Tirana 1 transmeton 2 herë/muaj emisione që përfshijnë stinën koncertore

Shpenzimet e parashikuara për vitin 2023 dhe i parashikuar i njëjtë për 2 vitet në vazhdim (2024-2025), bazuar në strukturën aktuale dhe në nivelin aktual të pagave, është si më poshtë:

3	Programi Buxhetore: "Orkestra Simfonike RTSH dhe Kinematografisë"	Viti 2023	Viti 2024	Viti 2025
	Shpenzimet për Paga e Sigurime Shoqërore e Shëndetësore	ALL 74,324,830	ALL 74,324,830	ALL 74,324,830
	Shpenzime për Aktivitetet e Orkestrës Simfonike për Stinën koncertore	ALL 15,000,000	ALL 15,000,000	ALL 15,000,000
	Shpenzime të Tjera Indirekte	ALL 1,100,000	ALL 1,100,000	ALL 1,100,000
	TOTALI	ALL 90,424,830	ALL 90,424,830	ALL 90,424,830

Bazuar në projekt buxhetin e paraqitur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, buxheti i shtetit pritet të financojë 82 mln lekë për vitet 2023 dhe 2024 dhe në vlerën 62 mln lekë në 2025.

Bazuar në ligjin Nr. 97/2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë" neni 116, buxheti e shtetit duhet të financojë 100% Orkestrën Simfonike të RTSH, por shpenzimet faktike për paga e sigurime shoqërore për Orkestrën e RTSH-së, shpenzime të stinës koncertore janë në nivele më të larta se financimi nga buxheti i shtetit për vitin korrent 2022 dhe gjithashtu, bazuar në tavanet buxhetore 2023 dhe 2024, financimi i parashikuar nuk arrin të mbulojë këto shpenzime në vlerën 8.4 milion lekë ndërsa në vitin 2025 vlerën prej 28.4 mln lekë.

Shtesa nga Buxheti i Shtetit paraqitet si domosdoshmëri, pasi edhe në dy vitet e fundit diferenca për pagat e sigurimet shoqërore, dhe për shpenzimet e stinës koncertore të orkestrës, është përballuar nga të ardhurat e veta të RTSH.

Financimi do të sjellë rritje të cilësisë së punës së Orkestrës, si edhe aktivitetet e organizuara do të përbëjnë bazën edhe të pasurimit të arkivës së RTSH me programe, të cilat do të pasurojnë edhe strukturën programore të kanaleve në radio e televizion, duke çuar në rritjen e audiencës, e për rrjedhojë rritjen e të ardhurave të RTSH.

Kërkesat shtesë për këtë program qëndrojnë në nivelin 8.4 milion lekë në vitin 2023 dhe 2024, dhe 28.4 milion lekë në vitin 2025.

4. PROGRAMI IV- Projekte Teknike për Futjen e Teknologjive të Reja

Politika e Programit

Investime në teknologji në kuadër të digjitalizimit të prodhimit dhe transmetimit, shpenzime për përshtatjen e teknologjisë ekzistuese, shpenzime të mirëmbajtjes së sistemit të integruar DVB-T2 në RTSH

Në këtë program përfshihen:

- Shpenzime të mirëmbajtjes së sistemit të integruar DVB-T2, bazuar në projektligjin për buxhetin 2023, janë planifikuar sipas taveve buxhetore në vlerën 220.000.000 ALL për vitin 2023 dhe në vlerën 200.000.000 ALL për 2024-2025
- investimet e reja në teknologji dhe përshtatje, të cilat janë planifikuar sipas taveve buxhetore në vlerën 0 ALL për periudhën 2023-2025.

1.4.1. Mirëmbajtja e rrjetit të digjitalizimit DVB-T2

Procesi i realizimit të projektit për transmetimet digjitale tokësore në të gjithë territorin e vendit tonë është implementuar dhe për mirëfunksionimin e sistemit digjital të transmetimeve DVB-T2 është e nevojshme një asistencë të vazhdueshme për operimin, diagnostikimin, riparimin dhe mirëmbajtjen periodike të tij.

Qëllimi i shërbimit të mirëmbajtjes është ofrimi i shërbimit të multipleksimit, transportimit dhe transmetimit në ajër nëpërmjet teknologjisë digjitale DVB-T2 të programeve televizive të RTSH-së dhe të gjithë operatorëve të tjerë privatë të interesuar. Gjeografikisht shërbimi ofrohet në Tiranë (Headend dhe në MUX 1 dhe MUX 2), si dhe në 59 pika transmetimi dhe 11 pika të mukseve lokale të shpërndara në tërë territorin e vendit (sistemi i ruterimit dhe transmetimit mikrovalor dhe i transmetimit broadcast)

Politika e këtij programi:

Operimi, diagnostikimi, mirëmbajtja periodike, mirëmbajtja e emergjencës, përditësimi dhe mirëmbajtja e sistemit të transmetimit digjital audioviziv DVB-T2 në çdo komponent të tij.

Qëllimet e Politikës

Ofrimi i shërbimit të multipleksimit, transportimit dhe transmetimit në ajër nëpërmjet teknologjisë digjitale DVB-T2 të programeve televizive të RTSH dhe të gjithë operatorëve të tjerë privatë, sigurimi i vazhdimësisë së punës në mbi 99.8% të kohës.

Objektivat e Politikës

Krijimi i kushteve optimale për vijueshmërinë e punës së sistemit, si edhe përditësimi i të dhënave mbi ndryshimet e mundshme.

Shtimi i kapaciteteve të pajisjeve të reja dhe integrimi i tyre deri në momentin e bërjes funksionale
Diagnostikimi i defekteve të shfaqura në sistem.

Produkti i Politikës

Realizimi i funksionimit të rrjetit të transmetimeve digjitale (DVB-T2)

Bazuar në kontratat aktuale të mirëmbajtjes dhe shpenzimeve të tjera kontraktuale dhe në funksion të funksionimit të rrjetit DVB-T2 shpenzimet e parashikuara për vitin 2023 dhe vitet 2024-2025 janë si më poshtë:

4	Programi Buxhetore: "Projekte Teknike për Futjen e Teknologjive të Reja"	Viti 2023	Viti 2024	Viti 2025
	Shpenzimet e mirëmbajtjes së rrjetit DVB-T2	ALL 270,000,000	ALL 270,000,000	ALL 270,000,000
	Shpenzime të Tjera Indirekte të lidhura me DVB-T2	ALL 8,000,000	ALL 8,000,000	ALL 8,000,000
	TOTALI	ALL 278,000,000	ALL 278,000,000	ALL 278,000,000

Gjatë pesë viteve të fundit, përfshirë edhe vitin aktual 2022, RTSH është financuar nga buxheti i shtetit në rreth 70%-75% të vlerës së shërbimit të mirëmbajtjes të rrjetit DVB-T2.

Kjo është një vlerë e konsiderueshme kundrejt shpenzimeve që RTSH është e detyruar të kryej për mirëmbajtjen MUX-it të dytë që shërben vetëm për të transmetuar operatorët lokalë dhe vendorë privatë dhe jo për programet e RTSH-së. Gjysma e shpenzimeve për mirëmbajtjen shkojnë për MUX

2, ndërkohë që nga këta operatorë lokalë dhe vendorë nuk mblidhet tarifa as për të përballuar as gjysmën e këtij shpenzimi.

Referuar kontratës aktuale të shërbimit të mirëmbajtjes dhe shpenzimeve të tjera të lidhura me funksionimin e rrjetit të digjitalizimit ka një kosto vjetore prej rreth 278 mln ALL (22,5 mln ALL/muaj ose 183.249 Euro/muaj mirëmbajtja dhe 8 mln/vit shpenzime të tjera si qira, energji, lëndë djegëse, shërbime të tjera).

Sa më lart, kërkesat shtesë të RTSH për programin “Projekte Teknike për Futjen e Teknologjive të Reja” për mirëmbajtjen e rrjetit DVB-T2, është 58 mln ALL për vitin 2023 dhe nga 78 mln ALL për vitet 2024 dhe 2025.

1.4.2. Investimet në teknologji

Bazuar në nevojat e RTSH për investime në teknologji po paraqesim kërkesat me poshtë:

1.4.2.1. Mbështetje e teknologjisë së re DVB-S2

Politika e Projektit

Investime në teknologji dhe përshtatje e teknologjisë ekzistuese në prodhim dhe transmetim
Qëllimi i Politikës

Rinovimi i pajisjeve të transmetimit satelitore TV me qëllim përshtatja me zhvillimet teknologjike të kohës

Objektivi i Investimit

Ruajtja e performances së transmetimeve satelitore për bashkatdhetarët. Sigurimi i redundances (automatizimi i up-linku satelitor).

Përshkrimi i Projektit:

Zbatimi i këtij projekti është që të sjellë një teknologji të re në transmetimet satelitore të RTSH, e cila siguron një kualitet më të mirë në këto transmetime duke siguruar qëndrueshmëri më të mirë të sinjalit satelitor, kjo e mundur nga ndryshimi i teknologjisë së amplifikatorit nga ajo “traveling wave tube” në teknologjinë “solid state”. Ky ndryshim do të rrisë jetëgjatësinë e punës së amplifikatorit si pjesë mjaft e rëndësishme e një sistemi up-link satelitor.

Në këtë projekt parashikohet blerja e një sistemi stacionar UP-link, i përbërë nga: 2 amplifikator KU-Band Solid State 100 w me hyrje L-Band, sistem komutimi automatik, panel dore për komandimin e sistemit, si dhe 2 copë Up-konverter IF në L-Band.

Parashikohet rritja e performances së transmetimeve satelitore sidomos për bashkatdhetarët.

Gjithashtu realizohet edhe sigurimi i redundancës (automatizimi i up-linku satelitor).

Projekti: “Mbështetje e teknologjisë së re DVB-S2” është parashikuar të realizohet në vitin 2023 në vlerën 17.08 mln ALL

1.4.2.2. Rinovimi i regjive TV me qëllim përshtatja me zhvillimet teknologjike të kohës

Politika e Projektit

Investime në teknologji dhe përshtatje e teknologjisë ekzistuese në prodhim dhe transmetim

Qëllimi i Politikës

Rinovimi i pajisjeve të transmetimit TV me qëllim përshtatja me zhvillimet teknologjike të kohës

Objektivi i Investimit

Rinovimi i pajisjeve të transmetimit TV me qëllim përshtatja me zhvillimet teknologjike të kohës, duke rritur cilësinë e transmetimit dhe ulur konsumin e energjisë elektrike

Përshkrimi i Projektit:

Në këtë projekt parashikohet të rinovohen pajisje bazë të transmetimit në regjitë dhe studiot TV me qëllim përmbushjen e objektivave.

Me këtë projekt kërkohet të zëvendësojmë një pjesë të konsiderueshme të pajisjeve të transmetimit në studio dhe regjitë TV, pasi një pjesë e tyre janë të kualitetit Standart Definition (SD) dhe kemi qenë të detyruar të përdorim konverter SD-HD, ndërkohe që transmetimet tashmë prej vitesh janë të kualitetit High Definition (HD). Këtu vlen për t'u përmendur routeri modular që zë një pjesë të konsiderueshme të vlerës së këtij projekti dhe është zemra e transmetimeve TV. Realizimi i këtij projekti do të bëjë të mundur edhe spostimin e të gjitha pajisjeve transmetuese në dhomën e serverëve duke krijuar kushte më të përshtatshme pune për aparaturat dhe lirin e hapësirës që zë ambienti aktual i aparaturës qendrore duke rritur cilësinë e transmetimit dhe ulur konsumin e energjisë elektrike.

Në këtë projekt parashikohet të rinovohen pajisje bazë të transmetimit në regjitë dhe studiot TV me qëllim përmbushjen e objektivave.

Do të blihen: Router modular HD/SD-SDI 256x256, Mixer audio, Kamera kit hd për studio, Objektiv për kamera studio broadcast, Stativ për kamera, Konvertera FO, Embedder/ De embedder. Mikrofoona për studio, Pajisje matëse e kontrolli audio dhe video, Distributor modular, Kufje profesionale. Ingest. CG, Karta video, Playout, etj. Të gjitha pajisjet e këtij projekti do të kenë një sjellje miqësore me ambientin duke qenë brenda kërkesave për ruajtjen e mjedisit.

Projekti: “*Rinovimi i pajisjeve të transmetimit TV me qëllim përshtatja me zhvillimet teknologjike të kohës*” është parashikuar të realizohet i në vitin 2023 në vlerën 241,3 mln ALL.

1.4.2.3. Rinovimi i Ateliesë në ambientet e ish-kinostudios

Politika e Projektit

Ristrukturimi dhe kthimi i ambienteve në studio televizive

Qëllimi i Politikës

Përmirësimi i kapaciteteve të RTSH për prodhimin e emisioneve të mëdha televizive.

Objektivi i Investimit

Pasja e një studio televizive për emisione dhe evente televizive të mëdha

Përshkrimi i Projektit:

Kryerja e punimeve civile, punimeve elektrike, sisteme kondicionimi dhe aspirimi, krijimi i ambienteve ndihmese te punës dhe sistem ndriçimi profesional
Vlera e investimit është parashikuar ne shumen prej 129.1 mln lekësh e parashikuar kjo përgjatë vitit 2023

1.4.2.4. "Digjitalizimi i arkivës"

Politika e Projektit

Digjitalizimi i materialeve audio, audiovizuale dhe filmike të arkivës se RTSH

Qëllimi i Politikës

Kalimi i materialeve arkivore nga formati analog në digjital

Objektivi i Investimit

Pasja e një arkivë digjitale e cila do te jete me e aksesueshme për përdorim dhe do ti rezistojë kohës bazuar ne standardet teknike optimale

Përshkrimi i Projektit:

Me këtë projekt synohet që të fillojë procesi i hedhjes së materialeve arkivore që aktualisht janë në shirita, bobina apo kasete në format digjital me qëllim ruajtjen dhe vitalizmin e arkivës së RTSH-s të krijuar ndër vite si një pasuri e pazëvendësueshme kulturore e vendit.

Synohet që të sigurohen pajisje dhe ambiente për të siguruar konvertimin e formateve të ndryshme analoge në atë digjitale. Materialet kryesore që do të nisin të konvertohen janë ato të filmit dhe shiritave magnetike.

Vlera e investimit është parashikuar ne shumen prej 290.4 mln lekësh e parashikuar kjo përgjatë viteve:

- në vitin 2023 në vlerën => 150 mln ALL
- në vitin 2024 në vlerën => 70.2 mln ALL
- në vitin 2025 në vlerën => 70.2 mln ALL

1.4.2.5. Hartimi i projektit arkitekturor të RTSH-së

Politika e Projektit

Rikonstruksioni i te gjithë ambienteve dhe godinave te RTSH

Qëllimi i Politikës

Krijim e kushteve sa me optimale dhe efecientë për realizimit te aktivitetit te RTSH

Objektivi i Investimit

Hartimi i projektit për rikonstruksionit të godinave te RTSH

Përshkrimi i Projektit:

Ky projekt është i domosdoshëm për të rinovuar të gjitha ambientet e punës në RSTH si nga ana funksionale ashtu dhe nga ajo estetike duke patur parasysh evidencën energjetike në kushte që një pjesë e këtyre ambiente nuk është rikostruktuar prej dekadash.

Vlera e investimit është parashikuar në shumën prej 33.5 mln lekësh e parashikuar kjo për vitin 2023.

1.4.2.6. “Mikrofona dhe aksesore për regjistrimin e orkestrës”

Politika e Projektit

Investime në blerjen e mikrofonave dhe pajisjeve të tjera ndihmese për regjistrimin e orkestrës simfonike të RTSH

Qëllimi i Politikës

Rinovimi i sistemit të regjistrimit audio të Orkestrës Simfonikë të RTSH

Objektivi i Investimit

Blerja e pajisjeve si mikrofonat dhe pajisjet të tjera ndihmese për regjistrim që do të përmirësojnë cilësinë e programeve muzikore që prodhohen nga orkestra simfonike

Përshkrimi i Projektit:

Me këtë projekt synohet të përmirësohet regjistrimi në sallën e Orkestrës me qëllim regjistrimin e koncerteve simfonike me kualitet të lartë, me qëllim nxjerrjen e tyre në tregun mediatic. Projekti: “Mikrofona dhe aksesore për regjistrimin e orkestrës” është parashikuar të realizohet në vitin 2023 në vlerën 7.2 mln ALL

1.4.2.7. Blerje Regji Lëvizëse (OB-Van)

Politika e Projektit

Përmirësimi i teknologjisë së prodhimit.

Qëllimi i Politikës

Prodhim televiziv sipas standardeve teknike bazuar në nevojat e tregut mediatic

Objektivi i Investimit

Përmirësimi i teknologjisë së prodhimit për programe dhe evente televizive.

Përshkrimi i Projektit:

Me këtë projekt synohet të bëhet një përmirësim cilësor për rritjen e mundësive teknike për regjistrime dhe prodhime televizive me anë të Studiove Lëvizëse, si p.sh: Festivali i fund vitit në RTSH, evente të mëdha sportive dhe artistike, kombëtare dhe ndërkombëtare. Deri me tani mundësitë për regjistrime edhe prodhime televizive direkte të përmasave të tilla janë të kufizuara.

Investimi që kërkohet, përfshin blerje pajisjesh dhe mjet lëvizës transporti të modifikuar (autobus alias OBVAN) sipas të gjitha standardeve teknologjike për tu përdorur për këtë qëllim.

Vlera e investimit është parashikuar në shumën prej 305 mln lekësh e parashikuar kjo për vitin 2024.

1.4.2.8. “Përmirësimi i cilësisë së transmetimeve në FM të Radio Tiranës”

Politika e Projektit

Investime në teknologji dhe përshtatje e teknologjisë ekzistuese në prodhim dhe transmetim

Qëllimi i Politikës

Përmirësimi i cilësisë së transmetimit të programeve në FM të Radio Tiranës si dhe rritja e nivelit të shërbimit të RTSH ndaj dëgjuesve të Radio Tiranës.

Objektivi i Investimit

Blerja e pajisjeve digjitale që do të përmirësojnë cilësinë e transmetimit të programeve në FM të Radio Tiranës si dhe do të rrisë nivelin e shërbimit të RTSH ndaj dëgjuesve të Radio Tiranës.

Përshkrimi i Projektit:

Ky projekt synon të sigurojë blerjen e pajisjeve digjitale (enkodera MPX-IP dhe dekodera IP-MPX) që do të sigurojnë një shpendarie shumë më të mirë të sinjalit të kanaleve të Radio Tiranës, cilësi më të lartë të tij, qëndrueshmëri si dhe të dhëna të përditësuara mbi programet e Radio Tiranës si: emrin e programit, titullin e këngës, emrin e këngëtarit. etj. Realizimi i këtij projekti do të realizojë edhe monitorimin dhe rregullimin e sinjalit në hyrje të transmetuesve FM duke lehtësuar punën për mirëmbajtjen e tyre si dhe do të sigurojë të dhëna të rëndësishme nëpërmjet logeve.

Si rrjedhojë do të përmirësojë cilësinë e transmetimit të programeve në FM të Radio Tiranës si dhe do të rrisin nivelin e shërbimit të RTSH ndaj dëgjuesve të Radio Tiranës.

Janë parashikuar të blihen pajisje si enkodera MPX-IP dhe dekodera IP-MPX për të gjitha pikat e transmetimit në FM.

Projekti: “Përmirësimi i cilësisë së transmetimeve në FM të Radio Tiranës” është parashikuar të realizohet në vitin 2024 në vlerën 17.1 mln ALL.

1.4.2.9. Rinovimi i sistemit të transmetimit FM

Politika e Projektit

Investime në teknologji dhe përshtatje e teknologjisë ekzistuese në prodhim dhe transmetim

Qëllimi i Politikës

Rinovimi i sistemit të transmetimit me qëllim mbulimin me transmetim të 99 % të territorit dhe 100% të popullsisë

Objektivi i Investimit

Blerja e pajisjeve digjitale që do të përmirësojnë cilësinë e transmetimit të programeve në FM.

Përshkrimi i Projektit:

Në këtë projekt parashikohet rinovimi i sistemit të transmetuesve aktual FM për shkak të amortizimit të sistemit aktual të transmetimit dhe teknologjisë së vjetërsuar të transmetuesve.

Do të synohet blerja e transmetuesve dhe sistemeve të antenave, si: transmetues FM 10 kW 1(një) copë, transmetues FM I kW 7 (shtate) cope, transmetues FM 500 W 2 (dy) cope, sisteme antenash me 4 dipole 6 (gjashte) cope, feeder 1+5/8, etj.

Këta transmetuese do të mundësojnë monitorimin dhe rregullimin e parametrave të transmetimit FM duke lehtësuar punën për mirëmbajtjen e tyre si dhe do të sigurojë të dhëna të rëndësishme nëpërmjet logeve.

Parashikohet të blihen pajisje të cilat do të jenë miqësore me mjedisin duke ju përmbajtur direktivave për këtë qëllim. Gjithashtu do të sigurojnë uljen e konsumit të energjisë elektrike duke sjellë përfitime direkt për financat e institucionit.

Projekti: “Rinovimi i sistemit te transmetimit FM” është parashikuar te realizohet në vitin 2024 në vlerën 15.6 mln ALL.

Më poshtë paraqitja në mënyre të përmbledhur i kërkesave shtesë për investime për “Projekte Teknike për futjen e Teknologjive të reja” për vitet 2023-2025:

4	Programi Buxhetore: "Projekte Teknike për Futjen e Teknologjive të Reja"	Viti 2023	Viti 2024	Viti 2025
	Mbështetje e teknologjisë së re DVB-S2	ALL 17,080,000		
	Rinovimi i regjive	ALL 241,274,000		
	Rinovimi i Ateliese	ALL 129,100,000		
	Digjitalizimi i arkives se filmit	ALL 150,000,000	ALL 70,200,000	ALL 70,200,000
	Hartimi i projektit te RTSH-se	ALL 33,500,000		
	Mikrofona dhe aksesore për regjistrimin e orkestrës	ALL 7,200,000		
	OB - VAN		ALL 305,000,000	
	Përmirësimi i cilësisë së transmetimeve në FM të Radio Tiranës		ALL 17,100,000	
	Sistemi i Transmetimeve në FM		ALL 15,552,800	
	TOTALI	ALL 578,154,000	ALL 407,852,800	ALL 70,200,000

Sa më lart, kërkesat shtesë për investime të RTSH për programin “Projekte Teknike për Futjen e Teknologjive të Reja” paraqiten përkatësisht sipas viteve:

- në vitin 2023 në vlerën => 578.1 mln ALL
- në vitin 2024 në vlerën => 407.9 mln ALL
- në vitin 2025 në vlerën => 70.2 mln ALL

2. Përmbledhje e kërkesave buxhetore sipas politikave

Bazuar ne kërkesat e paraqitura për te 4 programet e financimit buxhetor duke përfshire edhe kërkesat shtese të RTSH sipas viteve 2023-2025, theksojmë domosdoshmërinë e miratimit te tyre në kushtet aktuale.

Domosdoshmëria e financimit ka ardhur si pasoje e mungesës së plotësimit të kërkesave shtesë paraqitur gjatë viteve te fundit, e cila ka ndikuar edhe në pamundësinë nga ana e RTSH të likuidimit të kësteve, qofte edhe te pjesshëm të kredisë së financimit te investimit për ngritjen e rrjetit te digjitalizimit.

VITI 2023				
	Programi	Tavani Indikativ	Kerkesa Buxhetore	Kerkesa per Financim shtese
1	Shërbimi për shqiptarët jashtë kufirit dhe shërbimi për publikun në gjuhë të huaj	ALL 240,000,000	ALL 240,000,000	ALL 0
2	Prodhime Filmike ose veprimtari Artistike mbarëkombëtare	ALL 68,000,000	ALL 95,000,000	ALL 27,000,000
3	Orkestra Simfonike RTSH dhe Kinematografisë	ALL 82,000,000	ALL 90,424,830	ALL 8,424,830
4	Projekte Teknike për Futjen e Teknologjive të Reja	ALL 220,000,000	ALL 856,154,000	ALL 636,154,000
TOTALI		ALL 610,000,000	ALL 1,281,578,830	ALL 671,578,830

VITI 2024				
	Programi	Tavani Indikativ	Kerkesa Buxhetore	Kerkesa per Financim shtese
1	Shërbimi për shqiptarët jashtë kufirit dhe shërbimi për publikun në gjuhë të huaj	ALL 240,000,000	ALL 240,000,000	ALL 0
2	Prodhime Filmike ose veprimtari Artistike mbarëkombëtare	ALL 68,000,000	ALL 95,000,000	ALL 27,000,000
3	Orkestra Simfonike RTSH dhe Kinematografisë	ALL 82,000,000	ALL 90,424,830	ALL 8,424,830
4	Projekte Teknike për Futjen e Teknologjive të Reja	ALL 200,000,000	ALL 685,852,800	ALL 485,852,800
TOTALI		ALL 590,000,000	ALL 1,111,277,630	ALL 521,277,630

VITI 2025				
	Programi	Tavani Indikativ	Kerkesa Buxhetore	Kerkesa per Financim shtese
1	Shërbimi për shqiptarët jashtë kufirit dhe shërbimi për publikun në gjuhë të huaj	ALL 240,000,000	ALL 240,000,000	ALL 0
2	Prodhime Filmike ose veprimtari Artistike mbarëkombëtare	ALL 68,000,000	ALL 95,000,000	ALL 27,000,000
3	Orkestra Simfonike RTSH dhe Kinematografisë	ALL 62,000,000	ALL 90,424,830	ALL 28,424,830
4	Projekte Teknike për Futjen e Teknologjive të Reja	ALL 200,000,000	ALL 348,200,000	ALL 148,200,000
TOTALI		ALL 570,000,000	ALL 773,624,830	ALL 203,624,830

Komisioni mbështetet kërkesën e RTSH për realizimin me efektivitet të veprimtarisë së saj.

ATSH

Për vitin 2023, fondi i akorduar për buxhetin e ATSH-së është parashikuar të jetë 59,500 mijë lekë; fondi i pagave 37 200 mijë lekë; fondi i sigurimeve shoqërore 6,450 mijë lekë; fondi për shpenzime operative 11,350 mijë lekë; fondi për transfertat me jashtë 3500 mijë lekë dhe fondi për investimet e trupëzuara 1000 mijë lekë.

Sikurse e dini, Agjencia Telegrafike Shqiptare, e themeluar që në 1913 dhe zyrtarisht me Dekret të vitit 1954, vazhdon të jetë agjencia e vetme shtetërore e lajmeve në Shqipëri.

ATSH prodhon dhe shpërndan në botë lajmin zyrtar institucional, përveçse në gjuhën shqipe edhe në anglisht dhe frëngjisht, duke u referuar të gjitha burimeve serioze, jo vetëm të informacionit, por edhe prej agjencive të specializuara që përpunojnë të dhëna, informacione mbi zhvillimet politike, ekonomike, klimën e biznesit, interesin për investime etj.

Lajmi zyrtar, shpërndahet nëpërmjet rrjetit të agjencive partnere në të gjithë botën duke shërbyer si referim real për zhvillimet në vend, duke kryer kështu një komunikim lehtësisht të aksesueshëm nga rrjetet apo tregjet globale të informacionit.

Duke ndjekur edhe modelin e agjencive më të rëndësishme botërore, syonojmë që nëpërmjet lajmit të jemi kontribues në sektorë të rëndësishëm dhe jetik të vendit, në ekonomi, bujqësi dhe turizëm. ATSH ka një rrjet të gjerë partnerësh seriozë dhe homologë ndërkombëtarë, në rajon dhe Europë, që përbëjnë shtyllën informative të vendeve të tyre me të cilat kemi marrëdhënie të ngushtë dhe të vazhdueshëm bashkëpunimi në shkëmbimin e informacioneve.

Nisur nga kjo, ATSH ka potencialin dhe mundësitë që të jetë burimi i vetëm i informacionit zyrtar mbi zhvillimet në vendin tonë. ATSH ka arritur të prodhojë në ditë të zakonshme deri në 200 tituj lajmesh në ditë në gjuhën shqipe, të përkthyer në dy gjuhë, anglisht dhe frëngjisht.

Konkretisht, deri tani që flasim janë botuar në gjuhën shqipe 23 980 tituj lajmesh, 7527 tituj lajmesh të përkthyer në anglisht dhe 4360 tituj lajmesh në frëngjisht.

Gjithashtu ekipi i Agjencisë Telegrafike Shqiptare ka vijuar edhe gjatë këtij 6-mujorit botimin e përjavshëm të “**Newsletter**” në anglisht për të gjithë klientët e agjencisë, përfshirë dhe ambasadat e huaja në vend. Përmes këtij buletini përcillen në mënyrë të përmbledhur zhvillimet më kryesore të ditës. Një fokus i veçantë në “Newsletter” i është dhënë sektorit të turizmit duke promovuar nëpërmjet botimeve speciale, destinacionet dhe resurset e njohura dhe të panjohura turistike, traditën dhe kulinarinë e pasur shqiptare.

Komisioni mbështetet kërkesën e ATSH për realizimin me efektivitet të veprimtarisë së saj.

Qendra Kombëtare e Kinematografisë (QKK)

Shqipëria ka buxhetin më të vogël krahasuar me vendet e Ballkanit dhe Evropës (përfshi këtu dhe Kosovën). Kjo ka ndikuar për keq, në potencialin e bashkëprodhimeve shqiptare, të cilat nuk kanë fuqi ekonomike për të krijuar një kusht të barazvlefshëm financiar me prodhimet e vendeve të tjera.

Buxheti dy vitet e fundit ka pësuar ulje, ndërkohë që kërkesat për mbështetje financiare të projekteve kinematografike është në rritje, nga autorët dhe producentët vendas dhe të huaj.

Si pjesë e Programit Buxhetor Afatmesëm kërkesat buxhetore sipas zërave të projekt buxhetit të vitit 2023, krahasuar me buxhetin e vitit 2022 paraqiten si më poshtë:

	<u>Viti 2022</u>	<u>Viti</u>	<u>2023</u>
	<u>Ndryshimi</u>	<u>Në lekë dhe %</u>	
- Shpenzime për paga e sig.shoq	9,390	9,390	0
- Shpenzime korrente	148,050	147,610	-440
- Investime të brendshme	1,000	1,000	0
- Investime të huaja			
TOTALI	158,440	158,000	-0.01 %

Tavanet e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025 nuk i përmbushin nevojat më të domosdoshme të funksionimit të Qendrës Kombëtare të Kinematografisë.

Megjithatë, të ndërgjegjshëm për situatat që po kalon mbarë bota, ne jemi treguar modestë dhe kërkesa për rritjen e buxhetit për vitin 2023 është përqendruar vetëm në kërkesën për shtesë për aplikimin e skemës “Cash Rebate”- rimbursimi i pjesshëm i shpenzimeve që bëhen nga produksione të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, e cila është parashikuar të implementohet me hyrjen në fuqi të projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8096, datë 21.03.1996, “Për kinematografinë”, i ndryshuar.

Sa më i madh të jetë fondi, aq më e madhe është aftësia e tyre për të afuar prodhime të mëdha të huaja që duan të xhirojnë në territoret e tyre, aq më shumë rritet e fuqizohet industria e tyre kinematografike, dhe si rezultat aq më shumë oferta kanë. Është një proces ortek.

Shqipëria ka potencial të fuqishëm për xhirime për të huajt, të cilët shfaqin shumë interes për të ardhur këtu për të bërë xhirime, shoqëruar kjo dhe me çmimin e lirë të specialistëve të grupeve të filmit, koston e ulët të vendeve ekzotike të xhirit, si dhe rritjen e ndjeshme

të turizmit kulturor e familjar; e bëjnë Shqipërinë një vend të lakmuar për kompanitë e mëdha prodhuese.

Mungesa e hapësirave ligjore për aplikimin e mekanizmit financiar (Tax Rebate, Tax Incentive, Taks Kredit), ka bërë dhe bën që ata të zgjedhin xhirojnë në vendet e rajonit (Greqi, Mali i Zi, Kroaci, Slloveni, Maqedonia e Veriut, etj.), në vend të Shqipërisë; duke u stepur për të sjellë financimet e tyre në Republikën e Shqipërisë, vetëm për mungesën e legjislacionit për aplikimin e skemës “Cash Rebate”.

Iniciativa për incentivën “Cash Rebate”, është një domosdoshmëri e kohës dhe tregut kinematografik. Kjo mungesë ligjore e dëmton kinematografinë shqiptare, prandaj është përfshirë në këtë ndryshim në ligj, si pjesë përbërëse shumë e rëndësishme e tij.

Herë pas here nga partnerë të huaj na bëhen prezente kërkesa të vazhdueshme lidhur me mundësinë e shfrytëzimit të territorit shqiptar për xhirimin e filmave dhe produkteve të tjera audiovizuale, por stepen kur nuk gjejnë terrenin ligjor të përshtatshëm, kështu që kjo çështje është bërë urgjente.

Vendi ynë ofron në këtë aspekt mundësi ideale, pasi ka peisazhe të pasura në variacion nga deti në alpe, nga fusha në mal, nga lumi, liqeni, rrënoja arkeologjike, kështjella, qytete mesjetare, mbetje industriale fabrikash dhe uzinash të trashëguara nga periudha komuniste.

E gjithë kjo larmishmëri, e bën peisazhin tonë tepër të veçantë dhe të pa përsëritshëm. Përveç, sa më sipër, territori shqiptar ka edhe një avantazh tjetër të madh që e gjithë kjo larmishmëri shtrihet në distanca tepër të vogla krahasuar me vende të tjera gjë që e bën koston e xhirit më të ulët në Shqipëri.

Këto avantazhe që nuk i shfrytëzon Shqipëria, i shfrytëzojnë me sukses vendet fqinje. Për t’iu përgjigjur kërkesave gjithmonë e më shumë në rritje për shfrytëzimin e territoreve, të gjitha vendet kanë punuar për të krijuar paketa komplete stimuluese në shërbim të thithjes së investuesve të huaja në territoret e tyre.

Këtë kanë bërë prej vitesh vendet më të zhvilluara dhe e kanë aplikuar këto vitet e fundit edhe të gjitha vendet e Ballkanit.

Të ardhurat direkte nga investimet për xhirimet janë njëra anë e medaljes ndërkohë që ana tjetër, aspak për t’u neglizhuar është benefiti në aspektin e punesimit të specialistëve në fushën e prodhimit kinematografik si dhe të promocionit në territorin me konsekuencë të pashmangshme në rritjen e turizmit kulturor dhe jo vetëm.

Për këtë incentivë kemi kërkuar buxhetin në masën 100,000 milionë Lekë.

Komisioni mbështetet kërkesën e QKK për realizimin me efektivitet të veprimtarisë së saj.

Akademia e Studimeve Albanologjike

Hartimi i projektbuxhetit të Akademisë së Studimeve Albanologjike (ASA) për periudhën 2023-2025 është bërë duke marrë në konsideratë:

- d) Realizimin e detyrave që i dalin në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, dhe me Statutin e ASA-s.
- e) Planin e Zhvillimit të ASA-s, të miratuar nga Senati Akademik i ASA-s, si dhe vendimet e propozimet e Këshillave Shkencorë të Instituteve të ASA-s.
- f) Përvojën e deritanishme të institucionit, me qëllim që të bëhet i mundur një funksionim normal dhe rezultativ i Instituteve dhe i njësive kërkimore-shkencore e atyre ndihmëse përse i përket kërkimit shkencor, veprimtarisë pedagogjike dhe hulumtuese, si dhe nevojave urgjente për mirëmbajtjen, përmirësimin dhe pasurimin e bazës materiale, për shërbimet e investimet në ambiente e në paisje etj.
- ç) Gjithashtu, në hartimin e këtij projektbuxheti është synuar që të paraqiten kërkesa sa më reale dhe të domosdoshme për funksionimin e ASA-s, në përputhje me misionin dhe me statusin e këtij institucioni elitar kombëtar në fushën e kërkimit shkencor dhe të albanologjisë.

Në hartimin e projektbuxhetit për periudhën 2023-2025 jemi mbështetur në zbatimin të Ligjit Nr. 9936, dt. 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar të Ligjit Nr.10 296, dt. 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar të Ligjit Nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar, si dhe të Udhëzimit Plotësues Nr.1, dt. 10.01.2022 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022”.

Për vitin 2022 fondi i akorduar institucionit tonë në formën e grantit është: **235,000,000 lekë**

Artikull	Përshkrimi	Shuma
600	Shpenzime Paga	158,640,000
601	Shpenzime Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore	26,492,880
602	Shpenzime operative	49,363,120
606	Shpenzime për transferta të tjera tek personeli	504,000
Totali		235,000,000

Për vitin 2023 ASA-ia kërkon nie tond në total prej 400,196,560 lekë. Në viim do të eieni të detaiuar sipas Artikuive të Shpenzimeve 600, 601, 602, 604, ei dhe Artikulli 231 Investime.

I. SHPENZIME OPERATIVE

1. DIETA

a. DIETA BRENDA VENDIT shuma që kërkohet është 12,000,000 lekë

ASA-ja zhvillon 9do vit rreth 45 projekte kërkimore në terren, ku marrin pjesë mesatarisht 90 studiues, për një periudhë 21 ditore. Kostoja e pjesëmarrjes për një studiues duke përfshirë shpenzime për Dieta + Hotel + Transport është 175,000 lekë. 9do projekt përbëhet me 2-3 punonjës shkencorë.

b. DIETA JASHTË VENDIT shuma që kërkohet është 12,000,000 lekë

Këto dieta do të përdoren për punonjësit, që do të udhëtojnë nëpër arkiva të ndryshme dhe

biblioteka në institucionet homologe në botë.

Për vitin 2023 shuma e totale që kërkohet për zërin UDHËTIME dhe DIETA është 24,000,000 lekë.

2. HONORARE

Për vitin 2023 kërkojmë për zërin HONORARE shumën prej: 40,000,000 lekë.

Në 5 vitet e fundit ASA-ja ka publikuar 475 Monografi. Detyrimi i prapambetur i pagesave të honorareve dhe pagesave të tjera, që lidhen me botimin e veprave është **40,000,000 lekë.**

3. KONFERENCA SHKENCORE BRENDA DHE JASHTË VENDIT

- a. 90 studiues të ASA-s marrin pjesë 2-3 herë në vit në Konferenca Shkencore brenda dhe jashtë vendit. Mesatarisht këto aktivitete kanë një kosto prej **12,000,000 lekë.**
- b. DITËT E ALBANOLOGJISË - aktiteti më i rëndësishëm shkencor që organizohet nga ASA-ja në bashkëpunim me institucione të Prishtinës, Shkupit dhe të Europës, ka një kosto mesatare prej **3,000,000 lekë**

Për vitin 2023 kërkojmë për zërin KONFERENCA SHKENCORE BRENDA DHE JASHTË VENDIT shumën prej 15,000,000 lekë.

4. SHPENZIME PËR RUAJTE TË OBJEKTEVE

Një zë i rëndësishëm është edhe ruajtja e objekteve. Institucioni ynë ka tre objekte për ruajtje.

Për vitin 2023 kërkojmë për zërin SHËRBIME TË SIGURIMEVE DHE RUAJTJES shumën prej 20,000,000 lekë. SHPENZIME PËR BOTIMIN E VEPRAVE SHKENCORE TË ALBANOLOGJISË

Zë i rëndësishëm në veprimtarinë shkencore të institucionit tonë është edhe botimi i veprave shkencore: monografi; revista shkencore të fushës së arkeologjisë, historisë, gjuhësisë e letërsisë dhe antropologjisë; vëllime dokumentare historike; përmbledhje aktesh të konferencave shkencore kombëtare e ndërkombëtare; tekste në ndihmë të arsimit; albume arkeologjike dhe etnografike etj. Për vitin 2023 nga katër institutet e ASA-s parashikojmë që të çojmë për botim rreth 77 tituj nga 90 studiuesit tanë.

Për vitre 2023 kërkojmë për zërin SHPENZIME PËR BOTIMIN E VEPRAVE SHKENCORE TË ALBANOLOGJISË shumën prej 12,000,000 lekë.

Për vitin 2023 ASA për zërin Shpenzime Opezative kërkon një buxhet prej 127,630,000 lekë sipas tabelës së mëposhtme:

		Në Lekë	
Përshkrimi nga Art.602		I pritshmi 2022	Kërkesa 2023
602.0	Materiale zyre dhe të përgjithshme	2,960,000	4,800,000

1	Kancelari	700.000	1,000,000
2	Materiale për pastrim dhe dezinfektim	1,660,000	2,500.000
3	Materiale për funksionimin e paisjeve të zyrës, Tonera	600,000	1,000.000
4	Materiale të tjera zyre dhe të përgjithshme	0	300.000
602.1	Materiale dhe sbërbime speciale	9,600,000	12,800,000
1	Vepra shkencore të albanologjisë	9,000,000	12,000,000
2	Materiale laboratorike	0	0
3	Të tjera materiale	600.000	800,000
602.2	Shërbime nga të tretë	18,498,000	23,880,000
1	Elektricitet	1,500.000	2.000,000
2	Ujë	400,000	400,000
3	Internet	480,000	500,000
4	Telefoni Fikse	278.000	300,000
5	Posta	20,000	30,000
6	Shërbime të sigurimit dhe ruajtje	15,300,000	20,000,000
7	Shërbime të printimit dhe publikimit (fotokopje)	520,000	650,000
602.3	Shpenzime transporti	1,240,000	2,380,000
1	Carburant dhe vaj	1,000,000	2.000,000
2	Pjesë këmbimi, gonna dhe bateri	120,000	250,000
3	Shpenzime siguracioni mjeteve transporti	120,000	130,000
602.4	Shpenzime udhëtimi	4,303,000	24,000,000
1	Udhëtim i brendshëm	2,303,000	12,000,000
2	Udhëtim jashtë shtetit	2,000.000	12,000,000
602.5	Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme	2,290,000	3,000,000
1	Shpenzime mirëmbajtje të objekteve ndërtimore	1,600,000	2,000,000
2	Shpenzime për mirëmbajtje të inxeteve të transportit	120,000	200,000
3	Shpenzime për mirëmbajtje të pajisjeve të zyrave	570,000	800,000
602.6	Shpenzime për qiramarrje	400,000	750,000
1	Shpenzime për qiramarrje ambientesh	400,000	750,000

2	Shpenzime për qiramarrje mjete transporti	0	
602.9	Shpenzime të tjera operative	20,876,000	56,020,000
1	Shpenzime për pritje dhe përcjellje	870,000	500,000
2	Shpenzime për Honorare nga shkolla doktorale, Këshillat, Redaksia, e Drejta e Autorit.	15,618,000	40,000,000
3	Shpenzime për organizimin e konferencave dhe “Ditët e Albanologjisë”	4,000,000	1 5,000,000
4	Shpenzime për tarifa vendore	1 8,000	20,000
5	Shpenzime për të tjera materiale dhe shërbime operative	370,000	500,000
	Shuma:	60,167,000	127,630,000

Në Artikullin 602 për vitin 2022 kemi U trashëguar dhe shumën prej 10,800.000 lekë, fond i akumuluar gjatë periudhës së pandemisë, i cili nuk u bë i mundur të realizohej. Është në plan për t’u realizuar brenda këtij viti.

II. INVESTIME

1. Rikonstruksion i “Muzeut didaktik të Arkeologjisë” i Institutit të Arkeologjisë pranë ASA-s.

Duke patur parasysh vlerat që ruhen në këtë Muze dhe rolin e tij në edukimin e brezave të rinj. është e rëndësishme investimi i rikonstruksionit të ambienteve dhe stendave të tij.

Objekti është rikonstruktuar për herë të fundit rreth 40 vjet më parë. **Kostoja e këtij investimi është 36,000,000 lekë.**

2. Rikonstruksion i “Shtëpisë së arkeologëve në Apolloni” i Institutit të Arkeologjisë pranë ASA-s .

Ky objekt ka një rëndësi të madhe për institucionin, pasi shërben si një vend pune dhe akomodimi për personelin e ekspeditave shkencore që organizon instituti i Arkeologjisë. Objekti është ndërtuar rreth 30 vjet më parë. **Kostoja e këtij investimi është 4,000,000 lekë.**

3. Rikonstruksion i çatisë së ndërtesës së IAKSA-s.

Instituti i Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit (IAKSA) është një ndërtesë ku përveç zyrave të punonjësve shkencorë ndodhen edhe fondet muzeale të trashëgimisë antropologjike të Shqipërisë. Rikonstruksioni i çatisë del si domosdoshmëri pas amortizimit të madh të saj. **Kostoja e këtij investimi është 10,000,000 lekë.**

4. Blerje kompjuterash

Për një ruajtje sa më të mirë të fondeve kulturore që ndodhen në institucionin tonë, si dhe vënien e tyre në mënyrë të plotë dhe të shpejtë në funksion të personelit shkencor del e nevojshme blerja e disa

programeve kompjuterike për fondet, arkivat dhe bibliotekën. **Kostoja e këtij investimi është 5,000,000 lekë.**

5. Blerje rafte metalike (stelazhe) për Bibliotekën e ASA-s.

Duke patur parasysh bibliotekën, arkivat e secilit nga 4 Institutet e ASA-s, është planifikuar blerja e stelazheve metalike për të gjitha këto ambiente. **Kostoja e këtij investimi është 6,000,000 lekë.**

6. Blerje pajisje për “Laboratorin e IAKSA-s” pranë ASA-s.

Për ruajtjen sa më të mirë dhe konservimin e rreth 12,630 objekte tekstil-lesh dhe 8,785 objekte dru-metal në fondet etnografike-kulturore, që ndodhen në Institutin e Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit del e nevojshme ngritja dhe kompletimi i këtij laborator me pajisje specifike. Ai ka një rëndësi me vlerë kombëtare për ruajtjen dhe trashëgiminë e kësaj pasurie të jashtëzakonshme të popullit shqiptar. **Kostoja e këtij investimi është 10,000,000 lekë.**

Për vitin 2023 për zërin Investime ASA-ja kërkon një buxhet prej 71,000,000 lekë.

Në Lekë		
	Përshkrimi nga artikulli 231	Kërkesë 2023
1	Rikonstruksion i Muzeut Arkeologjik - Tiranë	36,000,000
2	Rikonstruksion i “Shtëpisë së arkeologëve” në Apolloni	4,000,000
3	Rikonstruksion i çatisë së IAKSA	10,000,000
4	Blerje programi kompjuterik për Fondet, Arkivat, Bibliotekën	5,000,000
5	Blerje rafte metalike (stelazhe) për Bibliotekën	6,000,000
6	Blerje pajisje për laboratorin e IAKSA	10,000,000
	Shuma:	71,000,000

Për vitin 2023 ASA-ja kërkon një rritje buxheti si më poshtë:

Në Lekë		
Artikull	Përshkrimi	Shuma
600	Shpenzime Paga	172.680,000
601	Shpenzime Sigurime Shoqërore dhe Shëndetsore	28,837,560
602	Shpenzime operative	127.630,000
604	Shpenzime të tjera për personelin	49,000
231	Investime	71.000.000
	Totali	400,196,560

Komisioni mbështetet kërkesën e ASA për realizimin me efektivitet të veprimtarisë së saj.

Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave

Në përgatitjen e projekt buxhetit afatmesëm 2023-2025 janë parashikuar disa nga projektet kryesore duke respektuar tavanet e miratuar nga Këshilli i Ministrave. Duke shqyrtuar nevojat dhe kërkesat e Institucionit tonë konstatojmë se gjatë viteve të ardhshme nevojiten të ndërmeren disa projekte për të garantuar funksionim normal të aktivitetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, por që nuk mund të financohen duke konsideruar tavanet e përcaktuara për PBA-në e viteve 2023-2025.

Për këtë arsye, në PBA 2023-2025, “Kërkesë për Fond 231 “Investime”, janë parashikuar disa financime të cilat janë shumë të nevojshme për Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave, për realizimin e të cilave nevojiten shtesë në fondet e ardhshme.

Sa më sipër, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, pas rikonstruksionit dhe përshtatjes së godinës për muze, për të cilin është lidhur kontrata dhe përfundon brenda vitit 2022, ka të domosdoshme fondet për “Strukturim i brendshëm i Muzeut të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave” në shumën e 100 milionë lekë për vitin 2023.

Kërkesa shtesë për PBA-në e viteve 2023 jepet në tabelën e mëposhtme.

Nr.	Emërtimi i Projektit	Llogaria	2023 000/lekë	2024 000/lekë	2025 000/lekë
1	“Strukturim i brendshëm i Muzeut të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave”	231	100,000		
	Shuma		1 00,000		

Komisioni mbështetet kërkesën e DPA për realizimin me efektivitet të veprimtarisë së saj.

Universitetet publike

Në seancat dëgjimore të organizuara me universitetet publike të Tiranës dhe të rretheve, drejtuesit e tyre kërkuan mbështetje në buxhet për vitin 2023.

Universiteti i Mjekësisë

Në përputhje me misionin dhe strategjinë e tij, UMT hartoi Projekt Buxhetin Afatmesëm 2023- 2025, të cilin e shoqëroi me një proces gjithëpërfshirës të stafit akademik, jo akademik dhe këshillave studentore, miratuar: **në Rektorat me Vendimin nr.12, date 02.09.2022** “Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025 dhe treguesit e vitit 2023, për Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”, **në GMS me Vendimin nr.03, date 26.09.2022** “Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025 dhe treguesit e vitit 2023, për Universitetin e Mjekësisë, Tiranë” dhe **në Senatit Akademik me Vendimin nr.67, datë 30.09.2022** “Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025 dhe treguesit e vitit 2023, për Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”.

Hartimi i projekt-buxhetit 2023-2025, ka si synim, plotësimin sa më mirë të treguesve ekonomik dhe financiarë, në mbështetje të veprimtarisë themelore të UMT-së, që është formimi dhe edukimi i profesionistëve të shëndetit në të tria ciklet e studimit sipas standardeve më të larta profesionale,

realizimin dhe nxitjen e kërkimit shkencor, frymëzimin dhe promovimin e risive në fushën e shkencave mjekësore, si dhe për të edukuar dhe frymëzuar liderët e së ardhmes në fushën mjekësore.

Qëllimi i hartimit të PBA-së 2023-2025 mbetet plotësimi sa më i mirë i të gjitha kërkesave ekonomike dhe financiare në funksion të realizimit të misionit të UMT-së. Planifikimi i shpenzimeve për çdo program përfshin shpenzimet në fushën e pagave, shpenzimet materiale dhe të mirëmbajtjes, shpenzime të tjera të nevojshme për funksionimin e procesit akademik dhe punën kërkimore-shkencore. Shpenzimet për investimet kanë për qëllim krijimin e kushteve sa më të mirapër zhvillimin e veprimtarisë akademike, krijimin e laboratorëve të rinj, implementimin e formave të reja elektronike bashkëkohore në komunikim, ngritjen e sistemeve informatike për ofrimin e shërbimeve ndaj studentëve, si dhe nxitjen e punës kërkimore shkencore.

Bazuar në ligjin për arsimin e lartë, buxheti i shtetit i financon Institucionet e Arsimit të Lartë nëpërmjet tre rrugëve:

- Grant i politikave të zhvillimit për institucionet publike të arsimit të lartë;
- Granti i mësimdhënies, si dhe fondit për mbështetjen studentore (bursat);
- Granti i punës kërkimore-shkencore dhe i veprimtarive krijuese;

Financimet e IAL-ve sipas ndarjeve të mësipërme, janë të pasqyruara në projekt ligjin “Për Buxhetin e Vitit 2023”, por meqenëse shpërndarja e tyre bëhet me VKM nr. 75, datë 12.02.2018 “Për miratimin e modelit të financimit të Institucioneve Publike të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor”, me formulë të veçantë të përcaktuar nga MAS, ne nuk mund të gjykojmë se sa shumae grantit që do të shpërndahet në buxhetin e vitit 2023, do të plotësojë realisht nevojat e Institucionittonë.

Gjatë vitit 2022 masa e grantit që i është dhënë institucionit tonë është **792 milion 409 mijë lekë** me anë të të cilit synohet të plotësohet përbalimi i pagave për 12 muaj për stafin akademik dhe jo akademik, bursat e studentëve të ekselencës dhe rimbursimi i tarifës vjetore të shkollimit në masën 50% për studentët e ciklit të parë dhe të integruar.

Bazuar në VKM-në nr. 75, datë 12.02.2018 “Për miratimin e modelit të financimit të Institucioneve Publike të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor”, ku cilësohet: “Fondet e përfituara në formë granti nga institucionet publike të arsimit të lartë dhe të papërdorura në fund të vitit financiar, në përputhje me rregullat dhe standartet e menaxhimit financiar publik trashëgohen në vitin pasardhës” UMT, fondet e papërdorura në fund të vitit financiar i trashëgon për vitin pasardhës.

Në këtë mënyrë gjykojmë se UMT, si një institucion i arsimit të lartë, duhet të jetë e përjashtuar nga fusha e zbatimit të Vendimin nr. 807 datë 16.11.2016 “Për disiplinimin e angazhimeve buxhetore” në lidhje me afatet e zhvillimit të procedurave të prokurimit publik.

Në buxhetin e vitit 2023, të dërguar pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, kërkon **vemendjen Tuaj** për mundësimin e rindërtimit të godinave të dëmtuaranga tërmeti.

Këto godina të UMT-së janë dëmtuar rëndë nga tërmeti i 26 nëntorit 2019 dhe janë të mbyllura bazuar në ekspertizën e institucioneve përkatëse që kanë kryer vlerësimin e shkallës së dëmtimit dhe të sigurisë. Rikonstruksioni i këtyre dy godinave do të jetë një projekt madhor, i cili do të kërkojë patjetër mbështetjen e financimit nga buxheti i shtetit, pasi nuk mund të përballohet nga tëardhurat e universitetit të cilat sigurohen nga tarifatat e studimit të studentëve.

Aktualisht ka përfunduar projekt-preventivi për rindërtim dhe vlera totale e parashikuar është 353,528,249 lekë, për rindërtimin e godinave si më poshtë:

- 4- Godina e Anatomisë - 91,569,144 lekë
- 5- Godina e Farmacisë dhe Shëndetit Publik - 225,248,193 lekë
- 6- Godina e Leksioneve të Godinave të Paraklinikut - 36,710,912 lekë

Sa më sipër, është parashikuar që **Godina e Anatomisë dhe Godina e Leksioneve të Godinave të Paraklinikut, në vlerë totale 128,280,056 lekë (36% e vlerës totale të projekt preventivit), të rindërtohen nga të ardhurat e universitetit.**

Godina e Farmacisë dhe Shëndetit Publik në vlerën 225,248,193 lekë (64% e vlerës totale të projekt preventivit), është kërkuar në Buxhetin e vitit 2023, të rindërtohet nga fondet grantë të buxhetit të shtetit.

Në MAS është dërguar projekt-preventivi final së bashku me fishat e investimit për të përfituar fonde buxhetore.

Universiteti Bujqësor i Tiranës kërkon:

Bazuar në eksperiencën e deritanishme (15-vjeçare), në nevojën për realizimin e aktiviteteve të mësipërme për zhvillimin normal të funksionimit të këtyre njësive, , si dhe bazuar në buxhetin e çdo viti që Universiteti Bujqësor i ka akorduar këtyre njësive, kërkojmë që buxheti për këto njësi të llogaritet jashtë përcaktimeve (*formules*) të përcaktuara nga **VKM nr. 75** datë 12.2.2018 “*Për miratimin e modelit të financimit të Institucioneve Publike të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor*”, duke dedikuar posaçërisht një buxhet të përcaktuar në vlerën e një minimumi të domosdoshëm prej **55 000 000 Lekësh** për aktivitetin e këtyre tre njësive (Banka Gjenetike Shqiptare, Laboratori i Peshkimit dhe Ferma Didaktike Eksperimentale).

Ne propozojmë ndryshime në formulën e financimit të IAL-ve publike të përcaktuara në **VKM nr. 75** datë 12.2.2018 “*Për miratimin e modelit të financimit të Institucioneve Publike të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor*”, ku financimi për këto tre njësi që relatuam, të realizohet me kritere të rëndësishme të veçantë, jashtë formulës së llogaritjes së “*grantit për mësimdhënie*”, grant i cili bazohet në numrin e studentëve që ndjekin ciklin e parë të studimeve, programin apo drejtimin e studimeve, në të ardhurat e siguruar nga tarifat e shkollimit si dhe në koeficientin e financimit për drejtimet e studimeve. Për veprimtarinë e Universitetit Bujqësor të Tiranës do të ishte jetike dhe një zgjidhje përfundimtare për sigurimin e aktivitetit normal të këtyre njësive të cilat janë të një rëndësie kombëtare pasi i shërbejnë ekonomisë së vendit.

Spektori i bujqësisë luan një rol të rëndësishëm në Ekonominë e vendit, dhe **roli i Universitetit Bujqësor** si Institucioni i vetëm arsimor i lartë i këtij lloji në Shqipëri që siguron kompetenca profesionale në këto fusha, është jetik dhe i pazëvendësueshëm dhe si i tillë duhet që të shikohet me përparësi edhe në mbështetje financiare.

Universiteti i Tiranës

Sipas ligjit 80/2015 “*Per arsimin e larte dhe kerkimin shkencor ne institucionet e arsimit te larte ne RSH*”, autonomia financiare e IAL-ve, nder te tjera garantohet nepermjet se drejtes per te

perfituar fonde shteterore. Duke pare buxhetet e miratuara per arsimin e larte ne vitet e fundit megjithe ndonje rritje te here pas hershme konstatojme se ka qene i pamjaftueshem per te lehtesuar institucionet publike te arsimit te larte ne permbushjen e misionit qe ata kane sipas ligjit te arsimit te larte.

Persa i perket projektbuxhetit te vitit 2023 ai ka nje rritje me pak se 1 mld lek por qe krahasuar me kerkesat e institucioneve publike te arsimit te larte lidhur me kete buxhet eshte rreth 2 mld lek me pak.

Keshtu qe do te vleresonim qe minimalisht granti qe duhet miratura per IAL publike duhet te perfshije shumen e kerkuar prej tyre me nje rritje jo me pak se 10% qe vjen dhe si rezultat i rritjes se pagave sipas VKM-se nr.647, date 05.10.2022.

Persa i perket Universitetit te Tiranes, **per vitin 2023** kerkesat sipas PBA per funksionimin e UT-se jane **2,342,679 mije leke**, nga te cilat: **1,778,355 mije leke** per pagat dhe sigurimet shoqerore, **200.000 mije leke** shpenzime operative per projekte te kerkimit shkencor, **364.234 mije leke** per bursat e studenteve. Në këto nevoja per grant nuk eshte perfshire efekti financiar i rritjes se pagave ne UT ne **masen 7%**, **ne shumen 124.485 ne mije leke** miratuar me VKM nr 647, date 5.10.2022.

Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan kërkon rritjen e investimeve, mbështetjen e projekteve kërkimore shkencore

Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë kërkon të mbështetet me fonde per pagat ku shprehet se buxheti I tije vjene ne renie nga viti ne vite.

Universiteti i Arteve kërkon mbeshtetjen dhe miratimin per buxhetin e kerkuar 2022

IV. DISKUTIMI NË KOMISION

Karakteristikat kryesore të projekt buxhetit të vitit 2023 dhe projekt buxhetit afatmesëm 2023-2025

Treguesit kryesorë makroekonomik e fiskalë të projekt buxhetit 2023 jane si më poshtë:

- Rritja reale e PBB 2.6%
- Inflacioni 3.6%
- Të ardhurat 29 e PBB
- Shpenzimet 31.6 PBB
- Dificiti buxhetor 2.6 PBB
- Borxhi publik 7.5% PBB
- Investimet publike 5.5% PBB
- Norma e papunësisë 10.2% PBB

Në diskutimin nen për nen per projektligjin “Për Buxhetin e Vitit 2023”, gjatë seancave me ministritë e linjës dhe institucionet e tjera, u fol gjerësisht për projektligjin, qëndrueshmërinë e tij, përmbushjen e Programit të Qeverisë Shqiptare, prioritetet e saj, ku arsimit, kultura, shkenca e sporti kanë vëmendje të veçantë, gjë që shprehet, në mes të tjerash, në rritjen e buxhetit në disa drejtime. Gjatë gjithë

takimeve, komisioni shprehu gjithë vullnetin në mbëhstetje të nismave ligjore, administrative e mbi të gjitha mbështetjes me sa më shumë fonde për ruajtjen, konservimin, restaurimin, mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë sonë kulturore. Po aq mbëhstesin çdo nismë ndër të rinjtë e madje duke e shtrirë që në arsimin fillor për promovimin dhe edukimin e brezit të ri me vlerat e trashëgimisë sonë kulturore, nxitejn për të lexuar, për të marë pjesë në aktivitete social-kulturore etj. Por thënë nga opozita, shohim se relacioni i projekt buxhetit na jep shumë pak të dhëna, duke u ndalur më shumë tek ide, prioritetet që duken më shumë si propagandë apo premtime elektorale, por nuk na tregojnë, qoftë edhe në vija të trasha, sesi mund të arrihen objektivat e dhëna. Arrijmë në përfundimin se shumë nga prioritetet sikundër e sqaruam, nuk janë të matshem, kanë një shtrirje kohore 2 apo tri vite dhe ne e kemi të pamundur të kontrollojmë rezultatet e tyre, duke qenë se ne po diskutojmë për vitin 2023 dhe jo për 2024 apo për 2025. Në investimet e parashikuara në vitin 2023, duket se ato janë kufizuar në 7 projekte në Bashkitë Fier Lushnjë dhe në Tiranë, që kanë shtrirje kohore më shumë se 1 vit buxhetior.

Janë të paqarta sesi do të arrihen rezultatet e pritshme, ndërkohë që siç theksuam nuk kemi mekanizma si të matim shifrat e dhëna nga MK në këtë relacion. Është e paqartë për ne sesi do të forcohet partneriteti publik-privat në rijetëzimin e objekteve të trashëgimisë kulturore. Duhet të njehemi se cilat janë projekte, shumat që do të shpenzohen për këto projekte dhe së fundmi roli i shtetit dhe privatit në këto projekte. Me thellimin e bashkëpunimit me PPP, mund të rrezikojmë të përsërisim precedentin e Butrinti dhe kjo do të ishte shumë e rëndë dhe krejtësoht e papranueshme nga ana jonë. Mes këtyre dilemave e dyshimeve të mëdha që ngre ky buxhet dhe me një relacion të varfër që nuk jep të dhëna të qenësishme, për të krijuar një panoramë të qartë të sektorit të Kulturës si në prioritetet që janë shkruar edhe në rezultatet e pritshme, nuk mund të japim votën pro për buxhetin që na paraqitet ng MK. Deputetët e opozitës sygjerojnë që Ministrinë e linjës t'i kenë në konsideratë verejtjet e tyre konstruktive në draftin përfundimtar të Buxhetit, sa kohë ato janë për përmirësimin e punës së institucioneve, si edhe pse përmirësimin e jetës së shqiptarëve.

Nga mazhoranca propozohen shtesa buxhetore për institucionet e pavarura për përmirësimin e performances së tyre sic është përcaktuar me sipër.

Në mbështetje të projektligjit “Për Buxhetin e Vitit 2023”, me shumicë votash ishin nëtë (9) deputet të mazhorancës ndërsa ishin kundër projektligjit “Për Buxhetin e Vitit 2023” gjashtë (6) deputet të opozites.

V. PËRFUNDIM.

Në përfundim, Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, duke vlerësuar projektligjin “Për Buxhetin e Vitit 2023” në tërë komponentët e tij, me shumicë votash miratoi nën për nën dhe në tërësi projektligjin dhe i paraqet Raportin e tij Komisionit për Ekonominë dhe Financat.

RELATORE

Dasantila Tahiraj

Enslemvera Zake

Merita Bakiu

KRYETAR

Flutura Aça